



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 NËNTOR DHE 1 DHJETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. NOVEMBRA I 01. DECEMBRA 2016. GODINE**

**NËNTOR/DHJETOR - NOVEMBAR/DECEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rrethit të tij,
14. Shqyrtimi i raportit vjetor i Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015,
16. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015,
17. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017,
18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, të kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit, të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a.,
19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit për Trashëgimi Kulturore,
20. Zgjedhja e 2 (dy) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Razmatranje N/zakona o ratifikaciji Finansijskog sporazuma za IPA-e 2015 godine između Kosova i EZ-e
5. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakonika o krivičnom postupku, (Funkcionalna komisija za zakonodavstvo je predložila odstupanje od Poslovnika, da se prvo i drugo razmatranje izvrše istoga dana na dve plenarne sednice),
6. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o izvršnom postupku,
7. Prvo razmatranje N/zakona o unutrašnjoj kontroli javnih finansija,
8. Prvo razmatranje o zdravstvenom inspektoratu,
9. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o verskoj slobodi na Kosovu,
10. Prvo razmatranje N/zakona o trgovini naftnim proizvodima i obnovljivim gorivima na Kosovu,
11. Drugo razmatranje N/zakona o energetske performanciji u zgradama,
12. Drugo razmatranje N/zakona o akreditaciji,
13. Drugo razmatranje N/zakona o ugroženoj zoni životne sredine Obilića i okoline,
14. Razmatranje godišnjeg izveštaja Nacionalne kancelarije za reviziju za 2015. godinu,
15. Razmatranje godišnjeg izveštaja Kancelarije generalnog revizora za 2015. godinu,
16. Razmatranje izveštaja o stanju sredine na Kosovu za 2015. godinu,
17. Razmatranje preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi zahteva Fonda penzijske štednje Kosova za usvajanje godišnjih taksi za 2017 godinu,
18. Razmatranje predloga-odluke Komisije za budžet i finansije za određivanje plate predsedavajućeg i članova Borda direktora, predsedavajućeg i članova Komisije za reviziju operatora sistema, transmisije i tržišta KOSTT-a, a. d.
19. Razmatranje predloga-odluke Komisije za budžet i finansije za određivanje nadoknada za predsednika, potpredsednike i članove Kosovskog saveta za kulturno nasleđe, i
20. Izbor dva člana Borda Radiotelevizije Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 17 nëntor 2016.

Ndërkohë Zenun Pajaziti ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Meqenëse seanca sot është e ngarkuar me shumë pika dhe meqenëse po e kemi vështirë t'i trajtojmë të gjitha në raste të tilla, kërkoj që pika e trembëdhjetë: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rrethit të tij të jetë e para, pra të fillojë para të gjitha pikave që ka sot rendi i ditës për këtë seancë.

Kërkoj edhe mirëkuptimin e deputetëve për shkak të rëndësisë që e ka ky projektligj.

KRYETARI: Atëherë, kemi një propozim konkret, në qoftë se kolegët deputetë pajtohen, duhet një ngritje formale dore. Jemi 72-73 deputetë, atëherë mundemi ta vëmë pikë të parë të rendit të ditës dhe pastaj të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës të cilat i kemi.

Kolegë deputetë, a jeni ta vendosim pikë të parë të rendit të ditës Projektligjin për Obiliqin.

Administrata, ju lutem! Po shihet që është shumica, po sido që të jetë, të mos kemi problem. Kush është kundër? Abstenim nuk ka. Atëherë është pikë e parë e rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rrethit të tij

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetaren e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zonjën Duda Bale, që ta paraqesë dhe ta arsyetoj raportin me rekomandime.

Të nderuar kolegë, do të vazhdojmë me të gjitha pikat e rendit të ditës.

Unë e vura në votim, të kisha lutur, Glauk, e ke fjalën pas kësaj pike, janë të gjitha pikat e rendit të ditës.

Zonja Emilija, fjala është për ju. Zonja Duda Balje.

Ju e votuat, s'e votova unë, pastaj vazhdojmë të gjitha me pikat e rendit të ditës, ta kryejmë këtë, është me rëndësi nacionale në të njëjtën kohë dhe vazhdojmë të gjitha çka kemi për t'i diskutuar, asnjë pike s'do t'i ikim, ta keni parasysh. Urdhëro, zonja Duda Balje.

DUDA BALJE: Komisija za poljoprivredu je razmotrila ovaj Zakon jako dugo, dosta smo raspravljao, ovo je drugo čitanje Zakon se dobili na vreme. Ja molim poslanike da se izglase, jer Zakon od vrlo velike važnosti i mislim da bi bilo red da se ovim ljudima izade u susret na ovaj način. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj nga Komisioni FunkSIONAL janë propozuar 13 amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL. Para çdo votimi konstatohet prania e deputetëve. Votojmë të gjitha amendamentet bashkë, në qoftë se jemi të pajtimit.

A është dikush kundër që t'i votojmë bashkë? Janë trembëdhjetë amendamente. Nuk ka.

Atëherë, amendamenti një deri në trembëdhjetë, a ka dikush kundër? A ka abstenim? Kalojnë trembëdhjetë amendamente. Janë 73 deputetë në sallë.

Atëherë votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim në mënyrë elektronike. 83 deputetë, prezenca fizike është. Deputetët i lus të votojnë për ligjin më të rëndësishëm për qytetarët e Obiliqit. Votojmë tash. Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

69 deputetë kanë votuar, 69 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike dhe dy me dorë, gjithsej 71 kanë votuar për. Urime qytetarëve të komunës së Obiliqit. Kuvendi e miratoi Ligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij. E përgëzojmë kryetarin e Komunës së Obiliqit, zotin Xhafer Gashi. Kanë votuar 72, sepse edhe zonja deputete është duke ardhur dhe ua urojmë ligjin e ri, urime, kryetar, urime të gjithë qytetarëve të Obiliqit.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Glauk, po qysh ia keni nisur ju që ta merrni me stupc krejt shtetin, ulu Glauk, prit, bisedojmë, pas pikave të rendit të ditës.

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjatin deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

GLAUK KONJUFCA: ...nuk është e para, ia dhatë fjalën Zenun Pajazitit, është i PDK-së, pse veç PDK-së po ia jep fjalën?

KRYETARI: Urdhëro, fol! Glauk Konjufca e ka fjalën. Më zuri ngushtë, tha veç të PDK-së ua jep fjalën, Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Sot janë bërë 25 ditë nga vdekja e Astrit Deharit, 25 ditë që prej vdekjes së tij dhe deri tash përgjegjësia dhe llogaridhënia nuk është askund.

Astrit Dehari vdiq në Burgun e Prizrenit. Burgjet janë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Shërbimi Korrektues është në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë, e ministrja e Drejtësisë e ka kryeshef kryeministrin e Kosovës.

Në Kosovë është krijuar praktika e renditjes së hetimeve dhe rezultateve të hetimeve para dhënies së përgjegjësisë dhe të llogarisë. Kurse, në shtetet demokratike është pikërisht e kundërta.

Kur ndodh një ngjarje si kjo, që është vdekja e një të burgosuri politik që ishte në duar të shtetit, përgjegjësia jepet e para, e hetimet mund të zgjasin me vite të tëra. Nuk jepet përgjegjësia pas hetimeve, se hetimet në raste të caktuara mund të zgjasin shumë, marrin shumë kohë. Po një herë jepet përgjegjësia, e hetimet zgjasin aq sa zgjasin.

Ka humbur jetën një aktivist politik, ai vdiq në burg, nuk kthehet më, familja e ka humbur më të dashurin, por është e paprecedent në botë që kjo të ndodhë dhe deri tash asnjë njeri, i çfarëdo rangu qoftë ai, të mos ndjejë aq përgjegjësi sa të japë dorëheqje. Asnjë dorëheqje në Republikën e Kosovës nuk e kemi pasur kurse një i burgosur politik e ka humbur jetën, kjo edhe në vendet më autoritare, më totalitare, nuk ndodh, kjo ndodh veç në Kosovë.

Në anën tjetër, hetimet që po ndodhin janë komprometuar plotësisht. Segmentet e kapura të policisë nga klani "Pronto" i kanë kontaminuar provat. Gjërat personale të Astritit, në të cilat nuk mund të kishte qasje as nëna Xhemile, as baca Avni, sepse kanë qenë në posedim të hetuesisë, janë shpërndarë nëpër media nga segmentet e kapura të këtij shteti.

Kryeprokurori Hoxha e shpalli vdekjen e Astritit si vetëvrasje, ndërkohë që më pas thanë: “Hetimet po vazhdojnë”. Domethënë edhe e shpall vetëvrasje, edhe fjalë e dytë thotë “hetimet po vazhdojnë”. Ai po bën njëjtë sikur Nexhmi Krasniqi që u ngut ta shpallte vdekjen e Astritit si vetëvrasje, duke thënë që ka pirë medikamente.

Të gjitha këto sjellje tregojnë për një urgjencë që një vdekje shumë të dyshimtë ta mbyllim sa më shpejt si vetëvrasje. Kjo i shton edhe më shumë dyshimet se vdekja e dhunshme e Astritit mund të ketë shkakuar që lidhen pikërisht me këta që pa hetime dhe pa kurrfarë faktesh po duan që me çdo kusht ta shpallin Astritin të vetëvrasur.

Nga ana tjetër, po këto forca të errëta që e kanë ngufatur Kosovën ishin ato që u mobilizuan si kurrë më parë për të mos e lejuar organizimin e një seance të jashtëzakonshme në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës që do t’i kushtohet Astrit Deharit.

Ne dy herë radhazi i mbledhëm mbi 40 nënshkrime dhe pikërisht në momentin kur mbledheshin nënshkrimet, fillonte trysnia dhe tërhiqej ndonjë deputet i dëgjueshëm i këtij koalicioni qeveritar. Unë nuk pajtohem me ata që mendojnë se nuk duhet të flitet në këtë Kuvend për Astrit Deharin, sepse kështu kjo do të ishte ndikim në drejtësi.

Një aktivist opozitar është arrestuar në mënyrë spektakulare, është akuzuar për terrorizëm pa fakte kredibile, është mbajtur 68 ditë në burg pa aktakuzë, është mbajtur 68 ditë në burg pa e marrë në pyetje fare, ka gjetur vdekjen në institucione shtetërore si dhe i është kthyer familjes në arkivol.

Kjo është çështje politike, deshëm s’deshëm, krejt ato pesë arsye që i shpjegova më herët, kjo është çështje politike. Natyrisht që është edhe punë e drejtësisë, drejtësia është e ndarë, e bën punën e vet, po natyrisht që është edhe çështje politike.

Kuvendi është institucioni më i lartë ligjvënës dhe i demokracisë në vend. Çdo institucion në Republikën e Kosovës që punon me ligje, e me ligje punon edhe Ministria e Drejtësisë, me ligje punon edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës, për shkak vetë të këtij fakti, pra që punojnë me ligje, automatikisht e bën pjesë e diskutimit dhe debatit parlamentar për sa kohë që vazhdimisht mund të ketë shkarje prej ligjeve, apo prej përgjegjësisë institucionale.

Ju i ndalët me presion dhe me shantazh deputetët tuaj që të mos i qesin nënshkrimet për të diskutuar për Astrit Deharin, por popullin dhe shoqërinë nuk po mund ta ndalni, për gjashtë ditë janë mbledhur mbi 23 mijë nënshkrime të qytetarëve për një seancë parlamentare.

Prandaj, ne kërkojmë që sot ky Kuvend të vendosë për seancën e jashtëzakonshme për Astritin, lejen e qytetarëve e keni marrë me petition, me nënshkrime, kështu që mos hezitoni dhe mos u

frikësoni për të mbajtur një seancë të jashtëzakonshme për Astritin në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës.

Ky ishte propozimi im që ka të bëjë me rendin e ditës.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni t'ju drejtohem, asnjë procedurë parlamentare nuk është ndjekur, për arsye se as Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk ka kërkuar seancë të jashtëzakonshme. Po të njëjtën kohë më lejoni të theksoj çështjen e petitionit, i cili iu ka drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Kryesisë së Kuvendit.

Përfaqësuesit e petitionit janë zonja Besa Luzha, Florina Duli dhe Rudinë Jakupi.

Janë mbledhur 23 774 nënshkrime, po as ky petition në asnjë moment nuk i drejtohet drejtpërdrejt Kryesisë së Kuvendit, të keni parasysh, e lexoj, e citoj:

“Qytetarët e nënshkruar në këtë petition kërkojnë nga kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione të thërrasë mbledhjen e Komisionit më herët se dy javë, siç është e paraparë me Shtojcën për fushëveprime dhe përgjegjësi të komisioneve parlamentare...

Pra, mbledhja e komisionit të mbahet jo më vonë se më 2 dhjetor 2016, në pajtim me paragrafin 4, neni 62, lidhur me nenin 84 për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit. Kjo është një situatë, e cila është shumë procedurale. Megjithatë, ne të gjithë jemi qenie njerëzore dhe vendimmarrjen, pavarësisht se asnjë procedurë nuk e lejon këtë pjesë, unë e bart te ju, si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sido që të jetë, tentativa me çdo kusht për të imponuar me grushte, tentativa me çdo kusht për ta imponuar fjalën e lirë, unë them se është e vërtetë se ka vdekur një djalë i ri në Kosovë. Një djalë i një familjeje, i cili ka dhënë shumë. Duhet të flitet në këtë Kuvend momentin e caktuar. Tash po flas edhe nga pozicioni im politik, në momentin e caktuar kur nuk ka manipulime, të cilat po tentohen të barten, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do t'i japë nënshkrimet. Ky moment është brenda muajit dhjetor. Duhet të flitet për shkaktarët e vërtetë që e kanë shtyrë një djalë të ri t'ia marrë jetën vetvetes, duhet të flitet për ata që kanë zi, duhet të flitet për një sistem të drejtësisë, që duke e ditur se e ka pasur një vëlla të vetëvrarë, e ka lënë pak një situatë, derisa për të njëjtën aktakuzë tre të tjerë, i ka lënë jashtë. Njëra prej tyre është vetëm pse ka qenë mbesa e Visar Ymerit, ajo ka mbetur jashtë, e djali tjetër i cili ka qenë vëllai i është vrarë një vit përpara, s'e kanë marrë parasysh.

Ky është sistemi jonë i brishtë i drejtësisë. Do të flitet në këtë Kuvend, po jua jap fjalën edhe do të hapen të gjitha letrat. Duhet të marrim përgjegjësinë kush e ka nxitur dhe kush e ka shkaktuar vrasjen, apo vetëvrasjen e tij. Faleminderit!

Proceduralisht, a dëshironi ta votoni? Të nderuar kryetarë të grupeve parlamentare, deklarojuni publikisht doni seancë të jashtëzakonshme? Zenun Pajaziti, deklaroj! Unë e marr përgjegjësinë e shkeljes së Rregullores. A doni ta futni në votim?

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Prej seancës kur është kërkuar një gjë e tillë mendoj që asnjë prej arsyeve nuk janë plotësuar. Nuk mendoj që është koha tash, është koha për drejtësinë.

Të gjithë ata që kërkojnë drejtësi të vërtetë për Astrit Deharin, mendoj që duhet këtë punë t'ia lënë drejtësisë, aq më tepër kur në këtë kohë edhe publikisht është thënë që ka hetime intensive, janë zgjeruar hetimet. Unë kërkoj, edhe pse ka, ose mund të ketë dyshime, ashtu siç u tha për institucionet e drejtësisë, janë ato institucione që i kemi zgjedhur ne në këtë Kuvend. Ne duhet të flasim në një moment tjetër edhe për reformat në institucionet, edhe në sistemin e drejtësisë, por assesi në këtë fazë të ndërhyjmë, sidomos tani kur familja ka edhe mërzë, kur edhe po abuzohet me fjalimet tona për rastin kaq tragjik, siç është rasti i Astritit.

Kërkoj që t'u lihet organeve të drejtësisë dhe ne ta vazhdojmë punën tonë pa e mohuar, duke shpresuar që së shpejti do të jemi me rezultate tjera. Pas institucioneve të drejtësisë do të kemi mundësi dhe rast të flasim të gjithë këtu në Kuvend për këtë rast dhe për rastet e tjera dhe për të gjithë ata që, jo vetëm rasti i Astritit që është rast shumë i ndjeshëm, por kemi edhe raste të tjera të vdekjes së njerëzve nëpër burgje të Kosovës, duhet të ketë përgjegjësi më të madhe dhe t'i shtrojmë të gjitha këto çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Vendimmarrja është juaja dhe pastaj vazhdojmë në pikat e rendit të ditës, në qoftë se nuk ka qëndrim për të vazhduar.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Realisht prej seancës më herët kur është kërkuar nuk ka ndonjë ndryshim. Ne edhe si deputetë, edhe si qytetarë, jemi jetësisht të interesuar që të dalin rezultatet përfundimtare dhe absolutisht nuk gjen deputetë apo qytetarë besoj të Republikës së Kosovës që s'është i interesuar ta dijë rezultatit, të përfundojnë hetimet dhe kam thënë edhe një herë, në emër të grupit, edhe herën e kaluar, pas këtyre rezultateve të hetimeve absolutisht ne do të jemi të gatshëm edhe me nënshkrime, edhe të marrim pjesë në seancë, por mbi bazën e një dokumentacioni dhe të një rezultati hetimor.

Çdo gjë më herët nuk i kontribuon hetimit të pavarur. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, Fillimisht dua që t’i qartësoj disa shpifje që u bënë këtu nga Kadri Veseli për rastin e Astrit Deharit, edhe në përgjithësi për rastin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” të arrestuar nga Policia e Kosovës, duke i akuzuar në një rast të montuar kryekëput për terrorizëm.

Së pari, Kadri Veseli tha është vetëvrarë Astriti. Kjo gjë nuk po dihet. Pra, është e qartë që Astriti ka vdekur në burg, e nuk ka kurrfarë hetimi kredibil për këtë punë, edhe konstatimit të Sylë Hoxhës, i cili është konstatim sharlatan, të cilin nuk i beson askush, dhe i cili natyrisht që është i nxitur nga organet e caktuara, tash Kadri Veseli na tregoi që në fakt ky është nxitësi, se ky e paska pranuar. Pra, ky po flet sikur Sylë Hoxha në këtë rast, edhe sikur Nexhmi Krasniqi, në rastin e parë.

E dyta, tha edhe vëllai i është vetëvrarë. Që dy vjet e gjysmë ka hetime për rastin e Arbënor Deharit. Asnjëherë nuk është konstatuar se si e ka humbur jetën Arbënor Dehari. Pra, ka pasur hetues të ndryshëm, ju e keni dëgjuar edhe familjen e Astritit dhe Arbënorit që ka treguar për këtë punë, edhe hetimet nuk kanë përfunduar. Janë ndryshuar hetuesit, por hetimet nuk kanë përfunduar, e tash Kadri Veseli po na thotë që edhe Arbënor qenka vetëvra. Por, ky po e di pa përfunduar hetimet.

Ky Kadri Veseli, i cili këtu në seancë, na pati thënë ‘kujdes mos u vetëvritni’, ‘kujdes se po e vritni veten’ dhe pastaj, natyrisht tash konstaton që paska vetëvrasje. Pa u ditur kjo punë, pa u konstatuar kjo punë nga organet përgjegjëse!

Prandaj, hetimi i pavarur do të na tregonte nëse ka lidhshmëri ndërmjet fjalisë së Kadri Veselit për vetëvrasje dhe vetëvrasjeve të konstatuara për aktivistët tanë. Këtë duam ta dimë ne, por këtë nuk po e lejon Kadri Veseli të flitet, sepse ky e kontrollon shtetin. Edhe tash del e shpif këtu, thotë ‘jo po pse e lanë jashtë mbesën e Visar Ymerit, e pse këtë e futën brenda?’. Pse, pra? Edhe ne po pyesim: Pse janë arrestuar aktivistët tanë? Pse u montohen raste aktivistëve tanë dhe pse bëhen këso dallimesh? Edhe pse vdes një i ri në burgun e Kosovës? Këtë po duam ta zbulojmë ne, që po e pengon ti.

Prandaj, edhe një herë: Kjo çështje duhet të diskutohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky mosfunksionim i sistemit të drejtësisë duhet të diskutohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Këto raste të montuara duhet të diskutohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne kemi përgjegjësi para qytetarëve që të sigurojmë që shteti funksionon si duhet, që shteti ofron drejtësi të barabartë për të gjithë. E qartë, ky shtet nuk po ofron drejtësi të barabartë për të gjithë, sepse ky shtet është i kapur dhe është i kapur nga Kadri Veseli dhe shokët e tij, të cilët po e kontrollojnë secilin proces edhe secilin situatë, ashtu siç po e kap këtë Kuvend.

Ne i kemi dorëzuar nënshkrimet për seancë të jashtëzakonshme. Ndërhyrja e Kadri Veselit e ka penguar seancën e jashtëzakonshme, drejtpërdrejt. Pra, ky njeri merret edhe me këtë çështje, me deputetët individualisht, për t'ua ndryshuar atyre mendjen. E ne e dimë qysh u ndryshohet mendja deputetëve individual, e kemi parë këtë në raste të caktuara, në rastet më të rëndësishme. Prandaj, të gjithë ata deputetë që kanë nënshkruar për seancë të jashtëzakonshme dhe të cilët nuk e kanë tërhequr këtë nënshkrim, i falënderoj edhe njëkohësisht i përgëzoj për guximin, sepse e di vërtet që në këtë situatë të shtetit të kapur është vështirë të kërkoj drejtësinë, por drejtësia është e domosdoshme, drejtësia për Astritin është drejtësi për Kosovën.

Ju që s'po doni drejtësi për Astritin, ju që po e pengoni mbajtjen e kësaj seance, ju që i keni tërhequr nënshkrimet, ju që nuk i keni dhënë kurrë nënshkrimet, ju po e pengoni funksionalizimin e drejtësisë në Kosovë. Kjo le të dihet qartë. Prandaj, edhe një herë, ne kemi kërkesë shumë të qartë, që në këtë seancë të futet si pikë e rendit të ditës diskutimi për rastin e Astrit Deharit dhe kjo duhet që të hidhet në votim, sepse është propozim i një grupi parlamentar. Le të votojnë deputetët si të duan, por duhet të hidhet në votim.

KRYETARI: Faleminderit! Do ta jap edhe unë përgjigjen pak më vonë, por i ftoj grupet parlamentare. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar,
Kryeministër,
Të nderuar kolegë,

Është për të ardhur keq që në Kuvendin e Kosovës nuk debatohet për një rast që është shumë i ndjeshëm dhe duke mos e paragjykuar as rastin, as drejtësinë, mirëpo këtu është vendi të diskutohet qetë, pa emocione, sepse besoj që ky vend e meriton, e meritojnë qytetarët, por së pari e meriton familja, duke mos e përcaktuar përkatësinë partiake.

Dhe ne si grup parlamentar në këtë drejtim kemi nënshkruar dhe jemi të vendosur që të mbahet një seancë e jashtëzakonshme për Astrit Deharin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar "Nisma", urdhëro zonja Bajrami.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Sinqerisht është për çudi se si reagojnë grupet e mazhorancës kur kërkohet një seancë e jashtëzakonshme me pretekstin se po ndërhyhet në drejtësi.

Përderisa pikërisht mazhoranca ka qenë po ashtu ajo që ka ndërhyrë në drejtësi me thirrjen e seancave të jashtëzakonshme për burgosjen e ish-luftëtarëve tanë. Prandaj, është hipokrizi të ketë justifikime, por besoj që këta e justifikojnë edhe më tutje veten. Prandaj "Nisma" në këtë rast e përkrah kërkesën e "Vetëvendosjes".

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë “6+”, zonja Myfera fjala është për ju.

MÛFERA SERBICA-ŞINIK: : Teşekkür ederim Sayın Başkan. 6 + Parlamenter Gurubu elbette ki adaletten yanadır. Ancak bu durumda hukuki sürecinin bitmesini beklememizde fayda olduğunu düşünüyoruz, aynı zamanda halkın temsilcisi olan milletvekillerinden oluşan Kosova Meclisinin çoğunluğunun kararına tabiyiz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! I kemi qëndrimet e grupeve parlamentare, do të shkojmë në votim, është më mirë.

Keni parasysh, përgatitemi me votim në mënyrë elektronike, apo dëshironi me dorë? Me dorë do të votojmë për arsye se duhet t’u shohin të gjithë qytetarët. Njëjtë si elektronike.

Kush është për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme ditën e sotme për Astrit Deharin? Ngrini duart, ju lutem! Mbani duart, ju lutem! Njëjtë është, çka ka nevojë të mos e shikojnë të gjithë publikisht. Faleminderit! Sa veta janë? 26 për, abstenim, kundër...

Atëherë, sot nuk mund të mbahet seanca. Më lejoni, ta përfundoj këtë pjesë, për të vazhduar me seancën.

Dikush po frikësohet nga e vërteta. Edhe më 14 dhjetor, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do të kërkojë seancë të jashtëzakonshme në qoftë se bëhen 40 nënshkrime. Do të vazhdojmë të ketë seancë të jashtëzakonshme. Në rend të parë të dihet e vërteta, cilado që të jetë, pa paragjykim. Në të njëjtën kohë të kërkohet, të dihet pse sistemi i brishtë i drejtësisë e mban një djalë veprimtar të familjes në burg, veç pse ka qenë me prejardhje nga Kumanova, e në të njëjtën kohë i mban jashtë tre për të njëjtën aktakuzë. Duhet të japë përgjegjësi dikush në sistemin e drejtësisë. Në të njëjtën kohë duhet të japë përgjegjësi pse në qoftë se akuzohet dikush për terrorizëm, çfarë dhe cilat kanë qenë masat mbrojtëse, cilat kanë qenë masat për ata të akuzuar dhe në të njëjtën kohë do të kërkohet që kudo nëpër botë, ku të ketë komision, me financimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës t’i shkohet deri në fund dhe të vihet verdikti përfundimtar, në mënyrë që manipuluesit të mos manipulojnë dhe ata që shtynë njerëz vetëm për ta dëmtuar Kosovën. Faleminderit!

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të Grupit Parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

E ftoj Bekim Haxhiun, nga Partia Demokratike e Kosovës. Ju lutem të shpreheni, a jeni në emër të grupit, apo tuajin personal?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Shqetësimi im ka të bëjë me ngecjen e investimeve në infrastrukturën sportive, në veçanti me një prolongim, i cili është bërë me projektbuxhetin e paraparë për vitin 2017 dhe me një neglizhencë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në këto investime.

Sigurisht që me projektbuxhetin, rishikimin e buxhetit të vitit 2016 ne i ndamë mbi 1 milion euro për investime në stadiumin “Adem Jashari” dhe institucionet përkatëse lejuan që investimet të bëhen me procedurë të përshpejtuar. Por, përkundër kësaj, ne nuk patëm asnjë hap nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për këto investime.

Tani, kur ne kemi pritur që shuma për renovimin e stadiumit “Adem Jashari” dhe përfundimet e punimeve në stadiumin e Prishtinës të intensifikohen pas pranimi të Federatës së Futbollit të Kosovës në FIFA dhe UEFA, kemi një ngecje dhe neglizhencë të institucionit përkatës të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ajo çka është shumë shqetësuese është fakti që investimet janë prolonguar për vitin 2019. Do të thotë, pasi t’i kemi përfunduar të gjitha kualifikimet për Kampionatin Evropian dhe Botëror, kjo ministri tek atëherë mendon që të bëjë apo të përfundojë pjesë të investimeve në stadione.

Deri atëherë gjasat janë që qytetarëve tanë, simpatizuesve dhe sportdashësve t’u pamundësohet shikimi i përfaqësueses së tyre në Kosovë. Ata, sikur në ndeshjen e fundit në Shkodër, do të udhëtojnë o në Shkodër, o në Shkup, për ta parë kombëtaren e tyre dhe të shpenzojnë shuma marramendëse të mjeteve për këtë qëllim.

Gjithashtu është një vërejtje, të cilën unë në dy vjetët e fundit ia kam tërhequr ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, se do të jemi në një moment të tillë kur ne nuk do të kemi mundësi ta shohim kombëtaren tonë në Kosovë dhe kjo do të ndodhë jashtë.

Gjithashtu, shqetësues është edhe një fakt tjetër, që këtu në këtë seancë, në rishikimin e buxhetit i kemi ndarë mjetet për konservimin dhe restaurimin e shtëpive-muze në Lagjen Jasharaj. Pas një diskutimi të përbashkët dhe ndërhyrjes edhe të vetë kryeministrit dhe ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i kemi ndarë mjetet fillestare për fillimin e konservimit dhe restaurimit të shtëpive-muze. Është shqetësuese se përse Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka zhvendosur këtë projekt dhe e ka hequr nga agjenda e investimeve.

Ne e dimë saktë që në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ekziston Instituti i Trashëgimisë Kulturore, i cili ka për obligim dhe detyrë edhe hartimin e projektit, edhe mbikëqyrjen e tij dhe përfundimin e projektit për konservimin dhe restaurimin e shtëpive-muze. Ministri dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e kanë për obligim t'ua japin qytetarëve një sqarim për këto ngecje në këto projekte, e në veçanti për ngecjen e projekteve që po lidhen me emrin e Adem Jasharit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupit, fjalën e ka zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,

Kryeministër,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Kemi shumë tema për qytetarët e Kosovës, me të cilat do të duhej të merreshim, por kjo çfarë do të them këtu po na imponohet, sepse janë rizgjuar hienat e Serbisë e të Rusisë me disa bashkëpunëtorë të Kosovës dhe po tentojnë që nëpërmjet trillimeve ta njollosin personalitetin e një udhëheqësi politik në Kosovë, të një komandanti të shquar të luftës për liri. Pra, po vazhdojnë të shpifin ende për zotin Ramush Haradinaj.

Qeveria e Kosovës duhet t'i mbrojë njerëzit e Kosovës edhe nga këto shpifje, sepse armiqtë zakonisht tentojnë të godasin aty ku dhemb më së fortë. Ramushi deri më sot ka marrë goditje nga të gjithë ata që kanë qenë kundër vlerave perëndimore të Kosovës, e pro ekstremizmit, të cilin edhe e kanë financuar. E kush janë ata, tash dihet botërisht, bashkë me tendencat që nëpërmjet luftërave dhe organizatave që janë jashtë Kosovës ta zbehin vlerën evropiane të Kosovës.

Ramush Haradinaj ka qenë çdoherë në ballë të proceseve për t'i penguar konceptet që Serbia i mishëron dhe të njëjtat ka dëshirë t'i shtrijë në Kosovë e rajon për destabilizim. Traumat e suksesit tonë gjatë luftës, siç duket, janë të pakapërcyeshme në Serbi. Historinë e armëve Kosova e ka kryer më 11 qershor bashkë me aleatin NATO, kur në të njëjtën ditë Serbia bashkë me aleatët e vet u detyruan ta pranojnë kapitullimin në Kosovë.

Nëse dikush mendon se me shpifje të tilla e zbehin fuqinë e Ramushit në Kosovë, e kanë shumë gabim. Zoti Haradinaj çdoherë e ka pasur mbështetjen e popullit. Serbia nuk po di të shërohet mendërisht nga humbja e luftës frontale në Kosovë, e që nuk e ka arritur as luftën ligjore përballë zotit Haradinaj. Prandaj, duhet t'i bëhet me dije se çka është mjaft, është mjaft. E këto trillime duhet të ndalen.

Zoti Haradinaj është me Kosovën, në përpjekje për ta ndërtuar shtetin ligjor, ku qytetarët do të trajtohen barabar. Ky është prioriteti i angazhimit të tij edhe sot. E ka thënë dhjetëra herë, bashkë

me ne, se rruga jonë evropiane është e pandalshme dhe askush nuk mund të ndërhyjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë sot do ta prek një segment të rëndësishëm, që është aktual në Kosovë, por për fatin e keq ka mbetur nën hije të politikave, gjoja të mëdha, që po bëhen në vend. Fjala është për sigurinë në Kosovë, që vazhdon të jetë shumë shqetësuese kohëve të fundit. Hajdutë me maska vazhdojnë të bëjnë kërdi në pasurinë private të qytetarëve, kur përveç shtëpive, edhe bizneset e tyre janë cak i hajdutëve.

Hajdutë me maska, të cilët për fatin e keq të qytetarëve nuk luftohen sa duhet nga hajdutët pa maska në institucione, të cilët për vetë faktin që nuk i luftojnë këto fenomene, atëherë me të drejtë dyshojmë në bashkëpunimin e hajdutëve me maska dhe atyre pa maska.

Futja e hajdutëve me maska nëpër shtëpitë e qytetarëve, përveç dëmtimit të pronës së tyre, ka për pasojë të rëndë edhe traumat e fëmijëve dhe personave të rritur. Vjedhja në shtëpinë e kryeprokurorit të shtetit është tregues i qartë se deri ku ka degraduar çështja e sigurisë në Kosovë. Prizreni vazhdon të jetë njëri nga qytetet më të atakuar nga pasiguria prej hajdutëve me maska, ku qytetarët nuk janë më të sigurt as në shtëpitë e tyre. Dhe, si rezultat i këtyre njerëzve me maska, kemi qindra shtëpi dhe biznese që çdo natë vidhen, deri edhe shtëpitë e deputetëve, kolegëve tanë që janë këtu, kur familjarët e tyre kanë përfunduar nëpër spitale.

Argjendarët në këtë qytet detyrohen të punojnë me orar të shkurtuar për shkak të pasigurisë dhe Policia dhe organet e shtetit nuk bëjnë kurrfarë veprimi në drejtim të sigurisë së tyre. Qytetarët janë të pasigurt kudo në Kosovë, nëpër shkolla për çdo ditë kemi therje, rrahje dhe lëndime të nxënësve, megjithatë që disa shkolla me kërkesat e prindërve të nxënësve bëjnë sigurimin privat, por kjo nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu, në punë jemi të pasigurt. Rasti më konkret është ditëve të fundit, me një punëtor i KEDS-it. Nëpër spitale jemi të pasigurt. Isha dëshmitar para disa ditësh në spitalin regjional, ku qytetarët e sëmurë bridhnin korridoreve në mungesë edhe të barnave, edhe të aparaturës së shkatërruar, me gjasë me qëllim. Nëpër burgje, që janë nën kontrollin e shtetit, e kemi rastin konkret të zotit Dehari, ku gjithashtu edhe në duart e institucioneve të shtetit jemi të pasigurt.

Unë mendoj se kjo gjendje e rëndë vjen si rezultat i keqqeverisjes në vend dhe kjo pasiguri e krijuar është rezultat i ngecjes së zhvillimit ekonomik të vendit.

Çështje tjetër, tepër shqetësuese në Kosovë, është konsumimi nga qytetarët i produkteve me afate të skaduara, nga të cilat vihet në pikëpyetje shëndeti i qytetarëve të vendit, të cilët nga ushqimet jokualitative dhe me afat të skaduar, që kanë vërshuar edhe shumë sëmundje, në mesin e tyre edhe sëmundje kancerogjene, që vijnë si rezultat, e në tregun tonë kanë vërshuar shumë produkte ushqimore, domethënë jocalësore.

Do të jua kujtoj disa nga titujt e medieve, që kohët e fundit kanë shkruar për këtë fenomen:

1. Gjatë një kontrolli të Policisë dhe inspektorëve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, para tri javësh, në rrjetin e marketeve të ETC-së dhe Fabrikës së Përpunimit të Mishit ELKOS janë gjetur 6 tonë mish pa afat, të cilit nuk i dihet prejardhja
2. 20 tonë mish gjedhi i dedikuar për Kosovë është bllokuar në pikën kufitare në Vërmicë, pasi i njëjti është tentuar të futet në tregun me dokumente të falsifikuara
3. 20 tonë mish pule me afat të skaduar ndalohen të hyjë në treg.
4. Zbulohet depo në Fushë-Kosovë, ku u ndërrohet afati produkteve të mishit...

Të gjitha këto janë një tregues i qartë se sa është i rrezikuar shëndeti i qytetarëve të Kosovës, shëndeti i cili, përpos që dëmton...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Nga ky vend prej nga është themeluar vetë shteti ynë i përbashkët, si deputetë të Grupit “6+”, e dënojmë edhe një herë, në mënyrën më të ashpër, sulmin vandal dhe barbar të kryer në një datë, për të cilën kam respekt, pra sulmin më 28 nëntor 2016 kundër Konsullatës së Turqisë në Prizren.

E dënojmë heqjen e flamurit turk nga qendrat e ndryshme në këtë qytet, i cili krahas flamujve të shteteve tjera nuk do të duhej t’ia zinte rrugën askujt. Sulmi ndaj një misioni të një shteti që qëndron lart në listën e shteteve që i janë gjendur çdoherë dhe në çdo rast Kosovës, është sulm absolutisht i papranueshëm, një turp i madh dhe një pabesi më vete. Dua të shpreh besimin se

vendi ynë do të nxjerrë para drejtësisë sa më shpejt që të jetë e mundur aktorët e këtij akti të shëmtuar, që ndër të tjera kanë çuar dorë edhe në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike, zotimet e së cilës obligohet t'i përmbushë edhe shteti ynë.

Në këtë drejtim, kërkoj që Prokuroria të qaset dhe ta hulumtojë rastin me seriozitetin më të madh.

Të nderuar deputetë,

Nuk duhet të harrohet asnjëherë se Kosova është shtet multi-etnik. Kosova nuk është shtet vetëm i një komuniteti, por shtet i të gjithëve që jetojnë në të. Dhe Republika e Turqisë është një prej shteteve që ka dhënë kontributin më të madh në rrugëtimin e Kosovës drejt shtetësisë. Flamuri turk i valëvitur në Kosovë nuk simbolizon vetëm flamurin e Republikës së Turqisë, por edhe komunitetin turk të këtij vendi.

Heqja e flamujve në rrugët e Prizrenit është dhunë e ushtruar ndaj komunitetit turk të Kosovës. Komuniteti ynë bie në dyshim dhe dëshpërim të madh nga ky sulm i pabesë dhe, po përsëris, pret dënimin meritor ndaj kryesit të aktit.

Domethënia që flamuri shqiptar bart për shqiptarët në këtë vend është i barasvlershëm me domethënien që flamuri turk bart për komunitetin turk.

Në ditën kur ne marrim flamurin shqiptar dhe e varim nëpër dyqanet tona, duke ndarë së bashku me shqiptarët gëzimin tonë, nuk do të duhej të prisnim nëpërkëmbjen e flamurit tonë.

Me këtë rast, po ashtu, dua të theksoj dëshpërimin dhe ndjenjën e pakënaqësisë që komuniteti turk ndien ndaj disa mediave dhe individëve gazetarë, të cilët pa kurrfarë etike dhe, mbi të gjitha, pa kurrfarë lidhjesh me realitetin kosovar janë duke i fryrë një frymë antiturke në vend, kjo nëpërmes lajmeve të rreme, të pabazuara dhe shpifëse.

E ftoj nga kjo foltore edhe një herë Prokurorinë që me përgjegjësi ta kryejë punën e vet në lidhje me këto lajme dhe komunikatat që janë nxitëse të urrejtjes. Kjo, sepse thirrjet tona të mëhershme ose nuk i dëgjuan, ose u bënë veshshurdhër ndaj tyre.

Shpresoj se dënimi i gjuhës shpifëse dhe urrejtjenxitëse nga drejtësia nuk është duke pritur ndonjë viktimë turke në vend.

Të nderuar kolegë,

Po ju pyes: a nuk jemi ne ata të cilët në takime ndërkombëtare potencojmë me krenari qenien e Kosovës si shtet multi-etnik dhe me të drejta të barabarta për të gjitha komunitetet?

Tani si do të shpjegojmë rastin e ngjarë? Si do të heqim këtë njollë të keqe të Prizrenit dhe rrjedhimisht të vetë Kosovës?

Mos harroni se këto sulme, këto shpifje, këto presione nuk janë duke e dëmtuar vetëm konsideratën e Kosovës në relacionin e saj me Turqinë, por edhe vëllazërinë në mes të komuniteteve, themelet ekzistenciale të shtetit të Kosovës dhe respektit ndërkombëtar të shtetit.

Për fund, ju ftoj që jo vetëm në nivel deklaratash, por në nivel veprimesh të punojmë së bashku për një Kosovë që ofron ndjenjën e përbashkësisë, bashkëjetesës dhe multikulturalizmit, kjo para se të bëhet vonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem!

Želim da za ovom govornicom u ime Bošnjačke zajednice oštro osudim napad na Turski konzulat u Prizrenu, uz nadu da se ovakav čin više nikada ne ponovi u multietničkom gradu Prizrenu kao obeležju raznih naroda i vera, koji vekovima zajedno u solidarnosti žive, poštujući vrednost i različitost svih zajednica, kao i da se počinio kazne od strane pravosudnih organa.

Poštovani predsedavajući,

Uvaženi premijeru,

Predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Moj današnji govor posvećen je Restelici, odnosno aktuelnoj problematici i stanju stanovništva koje vekovima unazad gore živi.

Velika udaljenost sela Restelice od samog centra Policijske stanice u Opštini Dragaš godinama unazad predstavlja bezbedonosni problem i pored toga što Policijska podstanica u selu Kruševo funkcioniše, ali poput neke dekoracije jer ne zadovoljava opšte potrebe lokalnog stanovništva, niti ima dovoljan broj zaposlenih policajaca koji bi mogli obavljati i vršiti svoju dužnost.

Zato apelujem na Ministarstvo unutrašnjih poslova, na ministra Skendera Hysenija da utiče na regionalnu, odnosno lokalnu policiju u opštini Dragaš i da hitno otvori istureno odeljenje Policijske službe u Restelici i zaposli veći broj naših ljudi iz samog sela Restelice, što sam i u prošlom sazivu Parlamenta javno zahtevala kao preventivnu meru u suzbijanju problema, ali nisam naišla na razumevanje od strane Vlade, i zaustavi redovne pljačke i krađe koje zastrašuju građane i ugrožavaju bezbednost i sigurnost meštana godinama unazad.

Poštovani kolege poslanici,

Zamislite samo podatak koga posedujem. Samo u Restelici od 2005 godine pa sve do dan danas oštećeno više od 100 privatnih kuća i nijedan počinio do sada nije pronađen niti uhapšen, niti su slučajeve i procesuirani dalje. To je prosto neverovatno šta se gore događa.

Poštovani predsedavajući,

Ovo sam govorila na inicijativu velikog broja meštana sela Restelice, koji su zahtevali da kosovska javnost bude informisana o svemu što se u ovom selu događa unazad nekoliko godina, u cilju pronalaska osoba koje su nanele tešku materijalnu štetu lokalnom stanovništvu ali i cilju jače instituionalne zaštite od strane...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Kolegë të nderuar deputetë!

Nuk mbaj mend që në këtë Parlament, gjatë këtij mandati, kemi qenë të zotët që së paku një herë ta zhvillojmë një debat parimor pa personalizime dhe etiketime.

Dhe, një gjë të tillë ua kemi borxh qytetarëve, atyre që na kanë votuar.

Duke i mohuar faktet, sigurisht se nuk zgjidhim asgjë. Dhe, fakte shpesh kemi parë, janë të pamohueshme dhe ato po mundohemi ose t'i minimizojmë, ose të mos i pranojmë fare.

Fakt është se në Republikën e Kosovës, që është vend demokratike e pluralist, ku thuhet se respektohen të drejtat e njeriut, edhe mendimi i lirë, edhe përcaktimi politik, ekzistojnë të arrestuar dhe të burgosur politikë, gjë që nuk ishte dashur të ndodhë në një shtet siç është Kosova.

Fakt është se në burgjet e Kosovës ka vdekur Astrit Dehari, që ishte një aktivist politik dhe që do të duhej të na shqetësonte të gjithëve, sepse secili që është këtu, dhe shumë të tjerë, janë aktivistë ose janë njerëz që merren me politikë dhe me këtë logjikë do t'u rrezikohet edhe atyre një ditë jeta.

Këto fakte dhe shumë fakte të tjera që janë shqetësuese për këtë vend, shpesh po mundohemi t'i tejkalojmë duke mos qenë të gatshëm që këtu, në këtë tempull të debatit, të hapim debate edhe për çështjet për të cilat personalisht mund të mos pajtohemi, por nuk guxojmë të jemi pengesë e hapjeve të debateve.

Pengesa e debateve nuk zgjidh problem. Ajo vetëm sa i komplikon problemet që ne i kemi për çdo ditë në shoqërinë tonë, prandaj do të duhej ta ndërrojmë këtë çështje, të hapim debate për të

gjitha çështjet, të cilat kërkohen nga cilido grup parlamentar, edhe nga qytetarët sidomos, edhe nëse kërkon një gjë të tillë vetëm një deputet, sepse vetëm ashtu mund t'i zgjidhim problemet dhe gradualisht t'i kthehemi një jete sa më normale.

Prandaj, unë edhe një herë këtu apeloj te ju, që edhe për rastin e Astriti, edhe për raste të tjera t'i hapim debatet këtu, t'i diskutojmë dhe në fund të marrim vendime bazuar në bindjet tona të thella dhe të sqarta, pa u bazuar se kush po e propozon, por duke parë se çka propozohet. Unë shpesh nënshkruaj dhe pothuaj që asnjëherë nuk e kam refuzuar nënshkrimin për debate, pavarësisht sa jam pajtuar ose nuk jam pajtuar me ato debate.

Pra, Kuvendi është për të debatuar dhe të debatojmë. Rasti i Astrit Deharit nuk guxon të jetë përjashtim. Për të do të diskutojmë një ditë patjetër dhe nëse do të duhej të diskutojmë, nuk duhet as të hezitojmë dhe as ta zvarrisim këtë punë. Dhe urdhëroni, jepni kontributin tuaj që të dalim nga këto situata, që vetë po i krijojmë dhe të cilat janë pengesë për punën tonë të mëtutjeshme, sepse kemi shumë çështje të tjera, të cilat duhet t'i çojmë përpara, por pengesat që po krijohen për shkak të lidhshmërisë së madhe me shefat po na kushton shumë dhe po dëshmohet se nuk jemi përherë në nivelin e duhur dhe të denjë për t'i përfaqësuar interesat e popullit këtu.

Kërkesa ime është që të gjithë, sa më parë, të kontribuojmë që të hapim debatin, të cilin po e kërkojnë 24 000 qytetarë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" dhe familja Dehari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Respekt për pankartën e vendosur nga kolegët e mi deputetë. Më lejoni që unë sot të merrem me një çështje, të cilën ma kanë kërkuar shumë banorë të komunës së Vushtrrisë për një çështje lokale.

Zakonisht kur flasim për tema të sferës së energjisë elektrike, kemi mendimin të faturat e fryra që i shohim secili në familjet tona dhe posaçërisht tani në periudhën e tarifave dimërore.

Por, pos këtij fakti, sot do të detyrohem të shpreh reagimin tim edhe një herë për gjendjen me furnizim të energjisë elektrike në komunën e Vushtrrisë, ku veçanërisht në 2 muajt e fundit ka pasur ndërprerje prej 2 deri 8 orë dhe më së shumti me këtë gjendje janë përballur fshatrat e kësaj komune dhe disa lagje të qytetit që kanë mijëra banorë.

Ky shqetësim menduam se i takonte të së kaluarës, por u përsërit edhe një herë pas 10 vjetësh. Ndërprerjet e shpeshta të furnizimit me energji elektrike bënë që edhe ankesat e qytetarëve të jenë të mëdha në dy javët e kaluara.

Më të vështirë e kishin gjendjen për të operuar edhe bizneset në këto komuna, të cilat paguajnë detyrime shtesë që të kenë linje të sigurta furnizimi, por nuk u kursyen as këto nga ndërprerjet e shpeshta.

Reagimet që bënë banorët ndikuan në një reflektim të mbikëqyrjes së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, i cili më në fund doli të ndikojë sadopak që ky vendim të ketë ndikim dhe të fillojë të stabilizohet.

Mirëpo, më lejoni që krahas kësaj të shpreh edhe shqetësimin tjetër, ku banorët e komunës së Vushtrisë kanë problem në shumë fshatra edhe me shtyllat elektrike, për të cilat, si duket, KEDS po heziton të ndërhyjë lidhur me këtë. Për këtë unë kam edhe fotografi, të cilat m'i dërgojnë, fotografi ku shtyllat mbahen përmes drurëve dhe mureve. Këto të dhëna sigurisht se duhet t'i kenë edhe mediat, dhe kërkesat i kanë dërguar disa herë te organet e komunës, por si duket, duhet ndonjë vendim apo dikush që të ndërhyjë edhe më shumë për të pasur një reflektim sa më të shpejtë që banorët e komunës së Vushtrisë njëherë e përgjithmonë të mos kenë probleme në furnizimin me energji elektrike dhe shtyllat t'i përmirësojnë, sepse e rrezikojnë jetën e fëmijëve dhe në përgjithësi të qytetarëve.

Pra, organet e pavarura t'i respektojmë, por sigurisht që organet e pavarura duhet të ndërhyjnë që punën ta kryejnë si duhet, po edhe KEDS, sepse nëse arrijnë të ndërpresin rrymën elektrike për 3 euro, atëherë sigurisht se duhet të kenë parasysh edhe përgjegjësinë që kanë për ta kryer këtë shërbim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Rasti Dehari përfaqëson edhe një herë momentumin e përgjithshëm, në të cilin gjendet pushteti aktual si dhe mundësitë e tij lidhur me obligimin qytetar.

Për vite me radhë ky pushtet ka zhvilluar në tërësi politika të cilat kanë shkuar në shpërputhje me vullnetin nacional.

Tashmë kur mendohet se Astrit Dehari ishte një qytetar dhe i cili përmes angazhimit të tij arriti të përmbushë misionin e tij kundër kësaj qeverisje, u akuzua pa të drejtë për sulm ndaj Kuvendit dhe rrjedhimisht iu përcaktua masa e paraburgimit pa fakte konkrete.

Vdekja e Astritit, e ndodhur brenda institucioneve shtetërore dhe dezinformimi i publikut prej deklarimeve të përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm paraqet edhe një herë nivelin e

mosseriozitetit, në të cilin operon ky pushtet, i cili përveç se është i papërgjegjshëm, është edhe inskenues i “fakteve” që dëshmon saktësinë mbi metodat që i përdor ky regjim.

Ky rast përbën nivelin më të ulët të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe të institucionit korrektues, i cili duke operuar në këtë frymë po krijon perceptimin qytetar lidhur me fytyrën e vërtetë të këtij pushteti hakmarrës ndaj qytetarëve të vet.

Tanimë besimi qytetar në raport me organet shtetërore është tejte i zbehur. Nga agjendat që i përdor pushteti, pothuaj se çdo qytetar ndihet i rrezikuar.

Rinia kosovare, duke parë mjetet që i përdor regjimi aktual, ka të pamundshme të përmbyllë obligimin e tyre. Ata po ndihen të nëpërkëmbur, të përndjekur e pa perspektivë.

Rasti Dehari nxori në dritë zyrtarisht neglizhencën e tërësishme të institucionit të quajtur shtet, i cili, përpos që nuk tregoi gatishmëri për një hetim të mirëfilltë dhe të pavarur, duke i marrë për bazë të gjitha materialet e mundshme për provë, vazhdoi të heshtë dhe të mos ndëshkojë asnjë njeri, madje duke mos qenë në gjendje as të debatojë për këtë çështje në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A mund të imagjiloni se si ndihen prindërit e një djali që vdes në burg dhe që shteti i tij sillet sikur nuk ka ndodhur asgjë me të.

Si do të ndihet një prind që për rastin e tij flet ministri anglez dhe atë në Parlamentin e Kosovës, flitet në Parlamentin Evropian, ndërsa Parlamenti i shtetit të vetë nuk dëshiron të flasë për këtë çështje.

Si do të ndihej që një rast i tillë të ishin të përfshirë fëmijët e zyrtarëve të Qeverisë? Apo më mirë thënë, si do të ndihej kryeministri Mustafa sikur kjo t’i ndodhte djalit të tij, zotit Hashim Thaçi, apo zotit Kadri Veseli, t’u ndodhte me fëmijët e tyre, si do të ndiheshin këta dhe si do të reagonin këta?

Kështu duhet të mendoni. Fëmijët janë fëmijë dhe prindërit janë prindër, të gjithë janë njësoj dhe dhimbja është njësoj.

Prandaj, reflektoni, prekeni pak...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Atëherë konsideroj që është shteruar pika e rendit të ditës për çështje të ndryshme.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, i dini rregullat. E ftoj deputeten Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sinqerisht jemi bërë bajat duke bërë pyetje dhe asnjëherë nuk po mund të marrim përgjigje nga ministrat. Besoj që ky trend duhet të përfundojë një herë e përgjithmonë, sepse unë tashmë i kam tri pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, ngase e mbuloj fushën nga Komisioni për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë të Kosovës.

Nuk e di a duhet t'i lexoj, apo thjesht t'i lë dhe të presin edhe më tutje, edhe pse besoj se me sot përfundon gjithçka, sepse nuk kemi të drejtë t'i sjellim gjithherë në çdo seancë, por meqenëse nuk do të mund të marr përgjigje, unë prapëseprapë do të rezervohem dhe nuk do t'i bëj pyetjet, sepse dëshiroj që kur të pyes të marrë përgjigje.

Uroj nga kryeministri që t'ua tërheqë vërejtjen ministrave të cilët nuk na përgjigjen në këto seanca parlamentare që të jenë më të përgjegjshëm ndaj pyetjeve të deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe pyetja e dytë është juaja, është i njëjti qëndrim besoj. Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin Hyseni. Zafiri nuk është.

Zonja Dërguti, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit!

Unë sot nuk do ta bëj pyetjen, sot kërkojmë drejtësi për Astritin.

KRYESUESI: Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Rasti i vdekjes në burg i aktivistit Astrit Dehari, përbën shkelje të rëndë të pesë parimeve themelore të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Këtë konventë të jetësuar me vendimet e Gjykatës së Strasburgut sipas kuptimit të nenit 53, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, institucionet tona janë të detyruara ta zbatojnë pikë për pikë.

Duke marrë parasysh që kanë dështuar në zbatimin e ligjit, vendorët dhe ndërkombëtarët, dhe duke marrë parasysh që jeni përgjegjës direkt sipas ligjit vendor dhe ndërkombëtar për mohimin e së drejtës në jetë të Astrit Deharit, pyetja ime është: Kur do ta dorëzoni dorëheqjen tuaj?

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që rregullat në demokraci janë të përshkruara, gjithkush mund të bëjë kërkesë, sidoqoftë kryeministri e ka shumicën absolute në Kuvend dhe s'ka nevojë të paraqesë dorëheqje pse dikush e kërkon. Sidoqoftë, nëse doni, zoti kryeministër e keni fjalën. Nuk e do fjalën!

Deputeti Bislim Zogaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

BISLIM ZOGAJ: Zoti kryeministër,

Që nga 1 korriku, Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statutit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e ka ndërprerë punën. A mund ta dimë arsyen pse e ka ndërprerë punën ky komision, tashmë kur dihet se u është pranuar statusi i disave nga këto kategori. Ndërsa pensionet ende nuk kanë filluar t'i marrin.

A mund të na informoni se kur do ta fillojë punën ky komision dhe kur do t'i marrin pensionet përfituesit e të drejtave të këtyre kategorive?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti deputet!

KRYESUESI: Ju kisha lutur që të mos e teproni, besoj që nuk është fer të ngrihet ajo farë banderole e t'i zihet dikujt fryma. Ne të gjithë e kemi parasysh situatën dhe të gjithë jemi dakord që procesi të zhvillohet deri në fund, qysh duhet sipas ligjeve dhe sipas rregullit.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Ne kemi marrë vendim në maj të këtij viti për përfundimin e punës së Komisionit qeveritar. Është vlerësuar se Komisioni e ka përfunduar punën tërësisht dhe se vazhdimi i punës së mëtejshme të këtij Komisioni është i panevojshëm. Me përfundimin e punës të komisionit, e ka përfunduar punën edhe Sekretariati i Komisionit, sepse Sekretariati si i tillë ka qenë i angazhuar me kontratë për veprën vetëm për atë punë që ka punuar për komisionin.

Qeveria nuk konsideron se duhet më tutje ta vazhdojë punën ky komision, sepse konsiderojmë se është përmbyllur çështja e komisionit sa u përket veteranëve.

Sot në Qeveri e kemi marrë një vendim që ta autorizojmë këtë komision që të punojë deri më 23 dhjetor për t'i trajtuar disa kërkesa që kanë qenë për dëshmorët, sepse kanë mbetur si të tilla, në mënyrë që ai proces të përmbyllet dhe ai është bërë me kërkesë të presidentit të vendit.

Prandaj, përgjigjja është se ne si Qeveri nuk do ta vazhdojmë më tutje punën e këtij komisioni, sepse konsiderojmë që e ka përmbyllur punën dhe se vazhdimi i më tutjeshëm i punës do të krijonte vetëm riciklim të rasteve të tilla për të cilat ne nuk kemi nevojë ta bëjmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Pyetje shtesë, deputet?

BISLIM ZOGAJ: Zoti kryeministër!

Edhe në pyetje kam thënë se disave u është pranuar statusi i dëshmorit, por edhe i invalidit dhe kur mund të llogaritim që këta do të mund t'i marrin ato pensione, sepse kemi disa familje që e kanë lënë vetëm bashkëshorten apo prindërit që mund ta gëzojnë atë të drejtë, e në një të ardhme jo të largët mund edhe të mos jenë. A mos po presim derisa ata të vdesin për të mos pasur kush ta marrë atë pension, apo kur do të fillojnë t'i marrin këto pensione ata që u është pranuar statusi?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, urdhëro! Apo ministri...

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër i nderuar,

Kabinet qeveritarë, deputetë,

Faleminderit shumë për pyetjen!

Jemi duke punuar në disa procese. Te procesi i verifikimit të dëshmorëve të UÇK-së, sot është hapur procesi në Qeveri dhe mendojmë që deri në fund të dhjetorit të përmbyllet, pasi komisioni do të punojë për verifikimin e atyre dhe deri në fund të dhjetorit do t'i kemi edhe listat e dëshmorëve dhe pastaj ata futen në proces të pagesës.

Tek invalidët e UÇK-së është proces ndaras, por jemi duke punuar në pako të përgjithshme edhe me veteranët.

Është iniciuar domethënë para dy javësh në Qeveri propozim-ndryshimi ose dokumenti për plotësim-ndryshimin e Ligjit të vlerave të UÇK-së. Ne po mendojmë që në kuadër të kësaj pakete të fillojmë dhe ta bëjmë verifikimin, njohjen dhe hapjen e procesit për invalidët e UÇK-së.

Ne këtë fundjavë e kemi edhe hapjen e procesit, domethënë shkon një grup punues nga të gjithë përfaqësuesit dhe e hapim procesin me këtë.

Besoj që në afat rekord do t'i sjellim edhe plotësim-ndryshimet në Qeveri, në mënyrë që ta hapim procesin diku kah fundi i vitit, ose në fillim të janarit.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zoti Kurteshi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Unë edhe një herë po e shfrytëzoj rastin që të kërkoj që sa më parë të mbahet seanca, në të cilën kërkuam debat për Astrit Deharin dhe liri për të burgosurit politikë, kurse pyetjet e mia parlamentare i bart për seancën tjetër.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, nëse doni, urdhëroni!

Kryeministri mund të kërkojë seancë të jashtëzakonshme edhe si kryeministër për ndonjë çështje, por s'është kompetent për t'i thirrur seancat në Kuvend. Domethënë, edhe në bazë të vullnetit të kryetarit që deklaroi, por edhe në bazë të peticionit dhe kërkesës së nënshkruesve, unë besoj që do të procedojmë dhe organet e drejtësisë do të veprojnë, pavarësisht nga diskutimet tona, për ta thënë të vërtetën.

E keni një pyetje për ministrin e Brendshëm, zotin Hyseni, dëshironi ta bëni zoti Kurteshi, apo dëshironi ta prisni zotin Hyseni? Nuk dëshironi!

Zonja Shukrije Bytyqi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse ministri nuk është këtu, unë pyetjen do ta bëj, se zakonisht nuk janë këtu.

Pyetja ime ka të bëjë me konkursin e fundit që e ka pasur Ministria e Shëndetësisë. Ne për çdo ditë e shohim se shëndetësia degradohet dhe kjo është dëshmuar edhe në bazë të konkursit të fundit të Ministrisë së Shëndetësisë për pranimin e kandidatëve për specializantë të rinj.

Ky konkurs është përcjellë me shumë parregullsi e nepotizëm gjatë intervistave. Pyetjet janë përsëritur dhe nuk kanë qenë adekuate, kandidatët nuk janë vlerësuar në bazë të poenëve që u takojnë si familjarë të dëshmorëve, pyetjet nuk kanë qenë aspak në harmoni me lëndët që ata janë profilizuar.

Prandaj, pyetja ime për ministrin e Shëndetësisë është se si është e mundur që nota mesatare 10,00 dhe koha e pritjes nga data e licencimit tre vjet të vlerësohet me 21,73%, kurse paraqitja para komisionit me një pyetje është bërë me 78,27% të vlerësimit?

Fatkeqësisht që ministri nuk është këtu, e kanë qenë shumë parregullsi. Tani e kemi të hapur edhe një konkurs tjetër, kështu që kjo është përgjegjshmëri e institucioneve tona.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shukrije Bytyqi, prapë pyetje për ministrin Rrahmani. Nuk është ministri, dëshironi ta lexoni pyetjen?

SHUKRIJE BYTYQI: Pyetja tjetër është vazhdimësi e pyetjes që një vit e më tepër, ka të bëjë me studentët e drejtimit të Departamentit të Biologjisë, drejtimi Biokimiko-Fiziologjik, që edhe sot e kësaj dite ata ende nuk kanë marrë përgjigje, e kjo dëshmon që institucionet tona kreditohen për persona, e jo për studentë dhe ata studentë bredhin. Unë pyetjen do ta tërheq për seancën tjetër, kur të jetë ministri.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftija, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Ministri nuk është këtu, dëshironi ta bëni pyetjen?

BESA BAFTIJA: Të nderuar kolegë deputetë,

Unë këtu para juve po e paraqes, jo vetëm kërkesën time, por kërkesën e grupit tim parlamentar për një seancë të jashtëzakonshme dhe të kërkohet drejtësi për Astritin dhe lirimin e të burgosurve politikë. Pra, kjo është një kërkesë e mira qytetarëve siç e dini, janë mbajtur marshe protestuese anekënd Kosovës, të cilët kanë kërkuar që të mbahet seancë të jashtëzakonshme, të kërkohet drejtësi për Astritin dhe të kërkohet llogari nga ata të cilët janë përgjegjës, të cilët e burgosën Astrit Deharin dhe aktivistët e tjerë.

Pyetja ime është konkrete për ministrin e Shëndetësisë, meqë edhe ai është përgjegjës, prandaj nga ai kërkoj llogari, përveç nga dy ministrat, ai i Drejtësisë dhe ministri i Punëve të Brendshme. Nga ministri i Drejtësisë kërkoj që të japë sqarime, të japë llogari dhe dorëheqje lidhur me atë çka ka ndodhur në Burgun e Prizrenit, sepse e kemi një raport zyrtar të Qendrës së Paraburgimit në Prizren ku nga Organizata për Mbrojtjen e të Mbijetuarve nga Dhuna ka dalë një qëndrim zyrtarë publik, në të cilin thuhet se Astrit Dehari në momentin kur është gjetur në dhomën e vetë ka pas puls dhe frymëmarrje normale.

Po ashtu, nga kjo qendër është kërkuar që të hetohet, të ketë një hetim të pavarur lidhur me atë se çfarë shërbimi shëndetësor, çfarë shërbimi i ndihmës së parë i është afruar Astrit Deharit prej momentit të gjetur në dhomën e paraburgimit deri te emergjenca.

Siç e dimë, nëse Astrit Dehari ka pasur puls dhe frymëmarrje normale, si është e mundur që të vdesë në burg, apo si është e mundur që të mos rikthehet në jetë. Prandaj, përgjegjësia bie edhe mbi ministrin e Shëndetësisë, duke e ditur se shërbimet shëndetësore të departamenteve të burgjeve prej vitit 2013 janë edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! I keni dy pyetje për ministrin. Dëshironi ta bëni pyetjen tjetër?

BESA BAFTIJA: Po e vazhdoj pyetjen, aty ku e lashë.

Pyetja ime është për ministrin e Shëndetësisë: Çka ka ndërmarrë ai lidhur me rastin Dehari, duke e ditur se edhe ne kemi qenë dëshmitarë që nuk i është afruar ndihma e parë, sepse si komision ne e kemi vizituar këtë qendër dhe e kemi parë se nuk i kanë as mjetet elementare për reanimim, nuk kanë ambumasë, nuk kanë laringoskop, nuk kanë tubus, si është e mundur që këtij t'i afrohet ndihma e parë në mënyrë profesionale?

Prandaj, kërkoj nga ai si ministër që të japë dorëheqje dhe të japë llogari për atë çfarë ka ndodhë me rastin Dehari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

I ka kaluar aktualiteti, meqë ajo është bërë para një muaj e gjysmë dhe unë e tërheq pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit! E keni edhe një pyetje për zonjën Tahiri. Ministrja nuk është këtu.

BLERTA DELIU-KODRA: Do ta parashtroj në seancën e radhës, meqë ministrja nuk është këtu.

KRYESUESI: Në rregull! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

VISAR YMERY: Është e domosdoshme që në këtë Kuvend për qytetarët e Republikës të jepen përgjigjet ose të ngrihen çështjet sa i përket trajtimit që qytetarët e caktuar të Republikës së Kosovës, aktivistë politikë, i kanë nga organet shtetërore.

Ky trajtim ka prodhuar deri më tash qindra arrestime, ka prodhuar burgje politike, raste të montuara, e tash së fundi vdekjen në burg të Astrit Deharit.

Dhe, një sistem i tillë, i cili i trajton qytetarët e Republikës në këtë mënyrë, i cili ua cenon atyre lirinë me raste të montuara dhe pastaj në burg nuk ua siguron as minimumin e sigurisë është një sistem, i cili mund të jetë çka do tjetër, përveçse republikë e qytetarëve, dhe në këtë drejtim konsideroj që nuk ka asgjë më të rëndësishme sot në Kosovë sesa se si Kuvend ta diskutojmë këtë çështje, ta shohim funksionalizimin e sistemit të drejtësisë, të organeve shtetërore në përgjithësi dhe t'u japim përgjigje qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke u treguar nëse ata janë të sigurt nga ky pushtet dhe deri në ç'masë mund të ndihen të sigurt nga ky pushtet.

Pra, marshet që janë organizuar gjithandej nëpër Kosovë e që kërkojnë drejtësi për Astritin, peticioni i cili po ashtu kërkon drejtësi për Astritin, shumë marshe që janë organizuar edhe në Prishtinë, e që kërkojnë drejtësi për Astritin, janë kërkesa të qytetarëve të Republikës së Kosovës, që ky Kuvend duhet t'i diskutojë.

Mosdiskutimi i këtyre kërkesave në Kuvend nënkupton që edhe Kuvendi po bëhet më shumë institucion i shtetit të kapur të klanit “Pronto” se sa institucion që i përfaqëson dhe i mbrohet interesat dhe vullnetin e qytetarëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Meqenëse kryesisht deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk po koncentrohen në tetë pyetjet që i kanë bërë, atëherë unë ia jap të drejtën vetes që të flas, pa marrë pyetje.

Unë dje jam përpjekur që të mësoj më shumë për lëndën dhe hetimet që janë duke u zhvilluar dhe për atë sa ka mundësi familja e Astritit të marrë vesh, përafërsisht edhe unë kam marrë vesh. Ka pasur të meta, por hetimet janë duke u kryer dhe duke u zhvilluar me intensitetin më të madh nga institucionet e specializuara të Kosovës dhe unë besoj që nuk ka arsye askush për ta fshehur të vërtetën. Është e vështirë për ne që të diskutojmë tani nga pozitat partiake ose grupet politike, por e vërteta është kjo dhe kësaj vërtete duhet t’i besoj. Duhet t’i besoj dhe unë kemi qenë bashkë edhe në Strasburg, por edhe këtu po them që nuk e besoj që ka deputetë në Kuvendin e Kosovës, pa marrë parasysh në cilën parti është, që nuk është për atë që e vërteta të zbardhet.

Meqenëse janë duke punuar, se di a mund ta ndihmojmë ne hetuesin si Parlament apo jo? Megjithatë, ju kisha lutur që të konsideroheni tek pyetjet, ose e kalojmë dhe e përmbylлим, edhe ashtu gati ka ardhur koha, dhe kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Zoti Salih Salihu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nëse nuk e bëni pyetjen tuaj, jua marr fjalën.

SALIH SALIHU: Jo, pyetjen e shtyj për seancën e ardhshme, ndërkaq kërkoj drejtësi për Astritin, kërkoj liri për aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” që janë në burg.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Monopoli është e drejta që e ka vetëm dikush për të prodhuar diçka, për të tregtuar një mall ose për të përdorur, ose për të shfrytëzuar diçka.

Një rast të tillë e kemi në homologimin e veturave që regjistrohen për herë të parë në Kosovë.

Në vitin 2009, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Kompanisë “Euro-Lab” është nënshkruar kontrata dhe dhënia e autorizimit për homologia, pa përfillur dhe pa i shpallur procedurat e

tenderimit, e në të njëjtën kohë duke shmangur në këtë formë edhe konkurrencën, duke i dhënë qasje ekskluzive vetëm një kompanie.

Në një analizë dhe hulumtim të institutit GAP shihet qartë se kemi një varg shkeljesh ligjore dhe këtu kemi monopol të pastër, që në formën tjetër i dëmton qytetarët se nuk kanë zgjidhje tjetër, e po ashtu nuk kemi liberalizim të tregut në këtë segment.

Më 12 gusht të vitit 2015, Qeveria, në pajtim me nenin 119, paragrafi 3 i Kushtetutës dhe dispozitave të Ligjit 03/ L-229 për mbrojtjen e konkurrencës e aprovoi Vendimin nr. 17/44, me të cilin fillohen procedurat për eliminimin e të gjitha veprimeve që kufizojnë konkurrencën e lirë, përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, si dhe ato të cilat krijojnë detyrime për qytetarët, të cilët nuk janë paraparë me ligjet në fuqi.

Pyetja ime për ministrin është: një vendim i tillë ju obligon edhe juve dhe ministrinë të cilin e drejtoni. Më intereson të di se cilat hapa i keni ndërmarrë ju për të eliminuar dukurinë e monopolit në fushën e homologimit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk është këtu, vazhdojmë me pyetjen e Albulena Haxhiut për ministren Dhurata Hoxha. Dhurata nuk është këtu, as Albulena s'qenka.

Deputeti Rustem Berisha, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Çështja që unë dua ta ngre këtu ka të bëjë me Komisionin Qeveritar për Verifikimin e Statusit të Veteranëve, Invalidëve dhe Dëshmorëve.

Që nga data 20 maj 2016 faktikisht këtij komisioni i ka skaduar afati, edhe sekretaria ka qenë pjesë e këtij komisioni dhe realisht që nga ajo datë kjo sekretari e ka pezulluar punën e vet, edhe pse kanë mbetur edhe shumë punë pa u kryer, certifikimi i listave përfundimtare, certifikimi i invalidëve, familjeve të dëshmorëve, edhe në kuadër të saj sigurisht edhe formimi i Komisionit për përcaktimin e shkallës invalidore të invalidëve, pyetja ime për kryeministrin është kur do të fillojë punën sekretaria e këtij komisioni?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar deputet!

KRYESUESI: Donikë, ju lutem mos na shtyni që të veprojmë ndryshe. E keni, mbajeni, në rregull është. Largoju prej foltores!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Mirë, unë po e jap përgjigjen...

KRYESUESI: S'ka kuptim, se në qoftë se arrini diçka pse ia zini pamjen, unë nuk e kuptoj pse. S'është ajo kurrgjë hiq, nuk e besoj as opinionin që ju jep mbështetjen në këtë veprim.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Atëherë, në qoftë se pajtohesh, jap përgjigjen javën tjetër, kur të kemi kushte më normale. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Konstatoj që për shkak të pengesave që po i bëhen kryeministrit i lëmë për mbledhjen e ardhshme dhe të gjitha pyetjet që kanë ngelur prapë përsëriten në seancën e ardhshme.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 27, 28 tetor dhe më 17 nëntor?

Keni vërejtje? Jo! Si? Po, unë nuk mund të shoh çka po bëjnë këta, ku ta qes unë tash atë, veç t' i them hajde këtu te unë Isës, jo bre, s'ka kuptim!

Zonja Kadriu e ka kërkuar fjalën.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Kryesues, nëse bën veç një sqarim, në seancën e fundit në mungesë kuorumi nuk patëm mundësi t'i qesim në votim rekomandimet për debatin për arbitrazh ndërkombëtar.

A do ta hedhim në votim, apo jo? Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, unë sot po mendoj që disa votime t'i kryejmë në orën 5 (17), ose nesër në orën 10:00. Edhe ajo që ka ngelur, por edhe kjo për IPA 2015, që është e domosdoshme të votohet.

Sa i përket procesverbalit, a keni vërejtje? S'keni vërejtje. Konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 27, 28 tetor dhe 17 nëntor 2016.

Në qoftë se grupet tuaja parlamentare janë të interesuara më shumë që të bëjnë zhurmë se sa të miratojmë një projektligj që i sjell Kosovës 80 milionë, shkoni e pushoni.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Komisioni për Integritet Evropian dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Kuvendit i kanë rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Nën udhëheqjen e Ministrisë së Integritet Evropian marrëveshja financiare për instrumentin e paraanëtarësimit 2015 është përgatitur, dhe paraprakisht pajtuar ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe atyre të BE-së, me qëllim të financimit të 16 projekteve në vlerë prej 78 milionë eurosh nga ana e BE-së dhe një bashkëfinancim prej 3 milionë eurosh nga ana e Kosovës.

Programi për herë të parë është bazuar në qasjen e re të përkrahjes për sektorë në kuadër të IPA 2, dhe me këtë rast është fokusuar në tre sektorë kryesorë: sundimi i ligjit, energjia, bujqësia dhe zhvillimi rural. Përveç këtyre sektorëve, do të mbështetet edhe procesi i integritet evropian dhe përafrimi ligjor me BE-në, si dhe nevojat për financim që rezultojnë nga dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Pas përfundimit të negociimit të përmbajtjes së programit IPA 2015 për Kosovën dhe hartimin e tekstit final të marrëveshjes nga ana e Komisionit Evropian, në emër të BE-së dhe Ministrisë së Integritet Evropian, në emër të Kosovës, kanë përfunduar të gjithë hapat proceduralë të paraparë për miratimin e marrëveshjes financiare.

Projektligji ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit në Qeveri dhe në Kuvend. Është me rëndësi që për shkak të afateve kontraktuale të Zyrës së BE-së, projektligji të hyjë në fuqi para datës 31 dhjetor 2016, prandaj ju ftoj që të miratoni projektligjin dhe të procedojmë me hapat finalë që do të lejojnë fillimin e zbatimit të asistencës financiare të BE-së në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetaren e Komisionit për Integritet Evropian, zonjën Njomza Emini, për arsyetimin e raportit të komisionit.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të pranishëm,

Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjen e përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa të mbajtur më 15. 11. 2016 e shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L- 124 për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e cila marrëveshje definon asistencën e dhënë nga BE-ja për Kosovën në kuadër të IPA-s.

Marrëveshja financiare për IPA 2015 është program me qëllim të financimit të 16 projekteve me vlerë prej 78 milionë euro, financim ky që jepet drejtpërdrejt nga BE-ja, ndërsa Republika e Kosovës merr pjesë në formë të bashkëfinancimit prej 3 milionë eurosh. Me këtë marrëveshje do të financohen tre sektorë kryesorë, siç janë: sundimi i ligjit, sektori i energjisë, si dhe sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Përveç këtyre sektorëve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare ka përkrahje dhe mbështetje edhe për procesin e integritetit evropian, për përafrimin ligjor me BE-në, si dhe nevojat për financimin për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Andaj, bazuar në këtë komisioni vlerësoi se asistenca e BE-së në kuadër të IPA-s në formë të projekteve të përshkruara në këtë marrëveshje paraqet një kontribut të veçantë për të fuqizuar procesin e integritetit evropian të Republikës së Kosovës.

Posaçërisht duke ndihmuar në arritjen e obligimeve të dala nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, andaj i rekomandojmë Kuvendit ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I ftoj kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e ka fjalën Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje për deputetët,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah dhe i rekomandon Kuvendit që të aprovojë këtë marrëveshje, e cila është shumë e rëndësishme dhe ka ndikime të drejtpërdrejta në projekte, në energjetikë, në ujëra e të tjera. Kështu që e përkrah marrëveshjen dhe ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë, por njëkohësisht kisha lutur kryesuesin që votimin ta shtyjë për një kohë, sot apo nesër, kur të jetë numri adekuat i deputetëve për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, njëjtë sikur edhe komisionet funksionale e kanë shqyrtuar dhe e kanë vlerësuar se asistenca e mbështetur nga BE-ja lidhur me programet e IPA-s

është e domosdoshme dhe është e mirëpritur për institucionet e Kosovës dhe ne e përkrahim njëzëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, nuk është paraqitur askush.

Grupi Parlamentar i AAK-së, nuk është paraqitur askush. Lista serbe nuk është paraqitur askush.

Grupi Parlamentar “Nisma”, nuk është paraqitur askush. “6+”, zoti Çerim Bajrami.

ÇERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Parlamentarna Grupa “6+” smatra da je ovaj zakon ratifikacije sporazuma za IPA projekta jako važno za našu državu i mi čemo ga svakako podržati. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gëzim Kelmendi e ka kërkuar fjalën. Nuk është. Zonja Melihate Tërmkollli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, unë kërkoj falje, por nuk isha këtu, nuk e di pse me procedurë kaq të shpejtuar e filluat Ligjin për Obilinqin, hiq nuk e kam të qartë, por duke e shpejtuar kështu, jeni duke e thyer kokën, edhe duke e thyer kokën për çështje për të cilat po mendoni se po rregullohen.

Ligji për Obilinqin, qysh është miratuar, nuk është ligj për zonat e rrezikuara, është ligj për fushatë zgjedhore. Kush është duke bërë fushatë zgjedhore me të nuk e di, por është ligj veç për fushatë zgjedhore, jo për zonat e rrezikuara. Jo, jo, më falni, kam plot argumente.

Nuk keni rregulluar kurrgjë, po keni çrregulluar. Do të dështojë si dhe plot ligje të tjera, fatkeqësisht, dhe po kërkoj falje, zoti kryesues, zoti sekretar që jeni këtu. Këtu më deputetë e më ministra është administrata sesa vetë deputetët. Ti kot bisedon me ta, kot i kryen punët, kot kërkon, administrata i merr vendimet për shumë çështje, edhe kam kërkuar që të punoj në këtë ligj, nuk më kanë ftuar, le të shohim si do të shkojë më tutje. Ndërsa, ju të “Vetëvendosjes” këtu, mirë që shkuat, po lëreni drejtësinë, kërkojeni të vërtetën, jo ju, po Kosova. Kosova le ta kërkojë të vërtetën, jo veç për Astrit Deharin, por për krejt rastet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nejse, s’po komentoj askënd. Nuk ka të tjerë të paraqitur, ju njoftoj që nesër në orën 10:00 bëhet votimi sa i përket ligjit. Debati konsiderohet i përfunduar.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka propozuar që shqyrtimi dhe miratimi i këtij projektligji të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, përkatësisht shqyrtimi i raportit të parë dhe të dytë të bëhet në të njëjtën ditë, në dy seanca plenare.

Në seancën e sotme do të bëhet shqyrtimi i parë dhe nuk ka nevojë për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, ndërsa shqyrtimi i dytë do të bëhet pas shqyrtimit nga komisionet parlamentare.

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratimin, në parim. E ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Paraqes para jush për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 4/L-123 të Procedurës Penale. Përmes këtij projektligji, me të cilin do të ndryshohet dhe plotësohet Kodi i Procedurës Penale, ka të bëjë me mundësinë e zgjerimit të afatit për zhvillim të hetimeve për kategori të caktuara të veprave penale. Një zgjerim i tillë i afatit për zhvillim të hetimeve do të bëhet për veprat penale, ndjekja e të cilave nuk parashkruhet.

Pra, veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë gjenocidin, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, si dhe vrasjet e rënda. Për këto kategori të veprave penale afati për hetime do të jetë deri në 5 vjet. Po ashtu, si përjashtim nga ky afat do të jetë edhe mundësia që në rastet kur hetimet janë të ndërlikuara, në rastet e ndihmës juridike ndërkombëtare, apo edhe në rrethana të jashtëzakonshme gjyqtari i procedurës paraprake të ketë mundësi të autorizojë vazhdimin e hetimeve. Hartimi dhe finalizimi i këtij projektligji që ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 159 të Kodit të Procedurës Penale është bërë në koordinim dhe bashkëpunim me aktorët relevantë, para se gjithash me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, të cilët edhe e kanë kërkuar këtë.

Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e avancimit të legjislacionit ekzistues, në mënyrë që institucioneve që merren me zbatimin e ligjit t'u mundësohet të kenë infrastrukturë adekuate ligjore për punë sa më efektive, e gjithë kjo në funksion të ndërtimit të një shteti të së drejtës, ju propozoj miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit nr. 4/ L-123 të Procedurës Penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, pas prezantimit të projektligjit hapi debatin për diskutim në parim, në emër të Komisionit Funkcional fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritet për Kabinetin qeveritar,

Në fakt, Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale sipas kërkesës së Qeverisë që kjo të shqyrtohet me procedurë të përsëritur.

Meqenëse e ka humbur pjesën e parë që duhet të shkojë me procedurë të përsëritur, ministrja kërkoj që të shkojë në procedurë të rregullt dhe komisioni e ka aprovuar në parim që projektligji të aprovohet në procedurë të rregullt dhe të shkojë në leximin e dytë. Nëse më lejohej, kisha për ta dhënë një mendim timin si deputete, domethënë komisioni i ka dhënë “pro”, tash flas si deputete.

Unë si deputete shpreh shqetësimin me kërkesat e institucioneve të drejtësisë që përmes ministrisë, gjegjësisht Qeverisë, të vijë ky plotësim-ndryshim me të vetmen një amendament ose një nen që duhet të shtohet si paragraf i ri për një fakt.

E para, është duke u rishikuar komplet legjislacioni i sistemit të drejtësisë dhe nuk e di kujt, apo cilit institucion i kërkohet që të shtohet një paragraf i ri te neni 159.

E dyta, ajo çka është propozuar është që një institucion konkret i sistemit të drejtësisë të dembelohet, të mund të marrë me afat të pacaktuar hetimin e rasteve konkrete. Veprat, të cilat nuk parashkruhen është krejt në rregull, por të jepet mundësia që të vazhdojnë në afat të pacaktuar për 2-3 arsye që janë të parapara në propozim për plotësimin e këtij kodi, për mua si juriste është e papranueshme.

Institucionet e drejtësisë, organet kompetente janë dhe kanë në dispozicion afatet relevante, afatet parimore për të hetuar një person për çfarëdo veprë qoftë ajo dhe nuk e di çfarë rrethanash duhet të krijohen, nuk e di çka paragjykohet dhe çka fshihet prapa kësaj që duhet të lejohej që në afat të pacaktuar të vazhdohej e drejta për të hetuar një person apo një grup personash. Po që se institucionet e drejtësisë janë mirë të dakorduara, bashkëpunojnë mirë me njëra-tjetrën, të gjitha hetimet e kanë afatin e paraparë sipas procedurës që për dy vjet të përfundojnë hetimet qofshin në ngritje të aktakuzës, qofshin të mbyllen si raste. Nuk e di pse duhet të parashihen afate shtesë, është i paraparë pesë vjet, plus mundësia e vazhdimin në afat të pacaktuar me 2-3 arsye që për mua janë të paqëndrueshme.

Andaj, personalisht shpreh shqetësimin tim me këtë propozim për plotësim- ndryshimin e këtij kodi me një nen të vetëm dhe personalisht mendoj se meqenëse është duke u rishikuar komplet infrastruktura ligjore, Ministria e Drejtësisë, së bashku me aktorët e tjerë, të përsëritojë

procesin e rishikimit të infrastrukturës ligjore të sistemit të drejtësisë dhe atëherë të bëhet plotësim-ndryshimi i kodeve dhe ligjeve të kësaj fushe si tërësi, e jo me një paragraf në kuadër të një neni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që ne e kemi shqyrtuar në procedurë të shpejtë këtë projektligj me të vetmin nen të kërkuar për plotësim-ndryshim. U potencua edhe këtu nga vetë fjala e ministres, por edhe koleges time deputete që ne jemi në procedurë të rishqyrtimit të pakos ligjore që ka të bëjë me sistemin e drejtësisë dhe besoj që edhe këtu duhet të pajtohemi që të jemi të kujdesshëm në ndryshimet individuale të neneve të caktuara.

Ne e kemi marrë në shqyrtim në parim, për shkak të procedurave kemi dhënë përkrahje si komision, besoj që këtu duhet ta analizojmë edhe si grup parlamentar, sepse ka një çështje e cila është pak sensitive, duke marrë parasysh praktikën, të cilat kanë ndodhur në Republikën e Kosovës apo edhe praktikën e sistemeve të avancuara, të cilat i kanë sistemet më demokratike që merrem me sundimin e rendit dhe të ligjit.

Kështu që edhe arsyetimi i dhënë që në sferën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar kërkohet ndonjëherë kohë shtesë për zgjatjen e hetimeve, unë mendoj që duhet të jemi të kujdesshëm, ta sanksionojmë në mënyrë konkrete brenda këtij neni të propozuar dhe të mos lejojmë zbrazëti apo të mos lejojmë mundësi për keqpërdorime nga kushdo qoftë.

Kështu që pjesë e analizës sonë të përgjithshme mendoj që është një amendament i propozuar, është i ndjeshëm, duke marrë parasysh dhe përsëris shembujt e këqij që kanë ndodhur me kërkesat për hetime, vazhdimin e hetimeve apo edhe elementet e tjera të caktuara të ndikimeve nga jashtë. Sido që të jetë, ne japim përkrahje në parim në këtë fazë, pasi është kërkesë e harmonizuar edhe me institucionet e bashkësisë ndërkombëtare dhe si kërkesë e tyre për shkak të disa specifikave të tjera, por duhet t'i sanksionojmë në mënyrë shumë konkrete.

Ministria duhet ta sqarojë në mënyrë të detajuar se çfarë dëshiron të arrijë me këtë amendament të caktuar dhe tek atëherë ne t'i japim përkrahje të plotë ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Anëtarë të Qeverisë,

Deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në parim e mbështet plotësim-ndryshimin e Kodit Penal të Procedurës Penale. Jemi të vetëdijshëm për nevojën që e ka shtyrë Qeverinë ta sjellë këtu edhe në bashkëpunim me institucionet mbështetëse ndërkombëtare. Por, gjithashtu, më lejoni që këtë përkrahje të grupit parlamentar ta plotësoj edhe me ato që u thanë nga zonja Halimi dhe nga zoti Zemaj.

Pra, kërkojmë që në fazën vijuese komisioni të jetë i vëmendshëm, që t'i marrë parasysh këto vërejtje, këto shqetësime, që janë serioze, në mënyrë që ky amendament të jetë në përputhje të plotë me atë synimin kryesor që e ka ministria dhe, po ashtu, me shqetësimet që i ngrehën deputetët.

Kërkoj po ashtu që edhe vetë ministrja gjatë punës së komisionit me kabinetin, me stafin, të jenë të pranishëm, në mënyrë që sa më mirë dhe sa më shpejt ta finalizojmë plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë kam veç pyetje sqaruese. E para, unë e kam shumë të paqartë nëse është urgjent, a nuk është urgjent? Përdërisa në rend dite është çështje urgjente, Kuvendit nuk po i shpjegohet se cila është urgjenca.

E dyta, parimi bazë i cili cenohet këtu është parimi i drejtësisë së shpejtë dhe fer. Nëse ju lejoni procedurë me afat të gjatë, që njerëzit me vite të mos marrin drejtësi, cili është arsyetimi madhor që duhet të na japë propozuesi, në këtë rast ministrja e Drejtësisë, në mënyrë që ta bindë Kuvendit që t'i lërë njerëzit nëpër burgje, a procedura hetimore ose gjykime me vite të tëra, sepse ne po ndikojmë që kjo të ndodhë, po kërkohet të zgjaten afatet. Nëse kërkohet të zgjaten afatet e hetimit apo gjykimin, atëherë Kuvendi duhet të bindet përse duhet të ndodhë kjo punë. Përndryshe, cila është logjika, pyetja e fundit - cila është logjika që të ndërrojë vetëm një nen, ose cili është arsyetimi madhor të ndërrohet vetëm një nen, kur është në rishikim sistemi i drejtësisë penale? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për Kabinetin!

Mua më intereson që ky paragraf që ka ardhur, ky nen në Kodin Penal mund të them që është një nga pikat më të ndjeshme që ka ardhur sot në Kuvendin e Kosovës. Vazhdimi i hetimeve, po ashtu, me një parashtrës tjetër, tregon se në Kodin Penal po kërkohet që njerëzit të jenë të

hetueshëm në vazhdimësi edhe pas atyre procedurave. Me atë që tha Arbeni pajtohem plotësisht. Unë mendoj se ky paragraf, ose ky nen, duhet të ndërpritet deri te “hetimi përfundon brenda 5 vjetësh”.

Kjo do të thotë që ne po kërkojmë t’ia zgjasim edhe pesë vjet tjera, kur gjykatësi e sheh të arsyeshme, dhe kjo tregon që po hyjmë në një rrugë që do ta dëmtojmë krejt sistemin e drejtësisë.

Mendoj se tjetra çështje është, atë që e tha “urgjenca”, kjo tregon se ne kemi hyrë në fazën, në Kodin Penal dhe me urgjencë. Kodi Penal brenda ditës të miratohet dhe shefi i grupit tim thotë: “Ministrja ta thërrasë kabinetin dhe ta trajtojë këtë çështje”. Nëse është paradite edhe pas dite, s’ka mundësi as ta thërrasë kabinetin, as askënd, as s’ka mundësi ta shqyrtojë. Po, është mirë të na thuhet që ky paragraf, ose ky nen, ka ardhur nga misioni ndërkombëtar dhe kërkojnë nga ne një si eksperiment, atëherë po pajtohem.

Nëse jemi pjesë e eksperimenteve, atëherë po pajtohem në këtë formë siç ka ardhur ky nen. Përndryshe, ky nen nuk meriton të miratohet, ky duhet të kthehet, duhet të lihet siç ka qenë kodi, ose ta gjejë një hapësirë tjetër. Përndryshe, nëse e miratojmë këtë, ne kemi për ta dënuar veten dhe të ardhmen e njerëzve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

U thanë shumë vërejtje lidhur me këtë propozim-ndryshim. Kodi i Procedurës Penale me të vërtetë është kod yni, që është trajtuar dhe hartuar falë edhe ndihmës dhe ekspertizave të ekspertëve edhe ndërkombëtarë, por edhe vendorë.

Faktikisht, në qoftë se për pesë vjet hetimi nuk mblidhen fakte, prova dhe evidenca për ta dëshmuar fajësinë e dikujt, besoj se në çdo rrethanë të re, kur të gjenden fakte të reja, mund të iniciohet një hetim i ri. Edhe ai hetim i ri mund të vazhdojë pastaj për pesë vjetët e ardhshme, në qoftë se ndodh. Por, në qoftë se veç domosdo duhet të shtohet apo vazhdohet afati për një hetim, atëherë është mirë ta limitojmë atë afat, le të jetë 1/5-ta e asaj kohe, 1/3-ta e asaj kohe..., një vit, dy vjet, por dikujt në vazhdimësi i jepet mundësia që për dhjetë a pesëmbëdhjetë vjet të jetë nën hetime, dhe faktikisht në njëfarë mënyre është cenim i lirisë së tij dhe të drejtës për lëvizje, e të tjera.

Kështu që unë kisha propozuar që të limitohet afati kohor i vazhdimi të hetimeve. Le të jetë një vit apo dy vjet, siç e ka edhe në Kodin e Procedurës Penale te afatet tjera, kur vazhdohet me vendim të gjyqtarit edhe për gjashtë muaj, se tash është dy vjet, plus gjashtë muaj. Domethënë, le

të jetë kjo pesë vjet plus një vit dhe besoj është e mjaftueshme, eventualisht dy vjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Edhe pika pesë e rendit të ditës mbetet të votohet nesër, në orën 10:00.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

E ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti,

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta paraqes para jush për miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 4/L-139 për procedurën përmbartimore.

Ky projektligj është i paraparë në programin legjislativ të vitit 2016 dhe është rezultat i punës dhe përkushtimit të Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të kompletimit dhe reformimit të infrastrukturës ligjore, si dhe adresimit të sfidave dhe vështirësive, që janë hasur gjatë zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Nëpërmjet këtij projektligji synojmë t'i avancojmë dispozitat e ligjit në fuqi, që kanë të bëjnë me çështjet, si në vijim:

- tarifatat e përmbartuesve privatë, ku nëpërmjet ndryshimit të dispozitave që u referohen çështjes së tarifave, veçmas tarifës së efikasitetit, do të krijohet një mjedis konkurrues ndërmjet përmbartuesve privatë;

- vendosja e afatit për gjykatën lidhur me vendosjen për prapësim,

- zvogëlimi i numrit të ankandëve për sende të paluajtshme nga tri ankande në dy dhe për dende të luajtshme nga dy ankande në një;

- themelimi i njësisë së përhershme për mbikëqyrjen e përmbaruesve privatë, si dhe rregullimi i regjistrit të llogarive bankare në BQK, nëpërmjet të cilit organet përmbarimore komunikojnë me bankat për përmbarimin nëpërmjet llogarive bankare.

Projektligji është hartuar dhe finalizuar në bashkëpunim me ekspertët vendorë dhe dispozitat e këtij projektligji janë në harmoni me dispozitat e legjislacionit të BE-së. Po ashtu, hartimi dhe finalizimi i projektligjit është bërë në harmoni të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ndërlidhet me Marrëveshjen stand by arrangement, që Republika e Kosovës pritet ta nënshkruajë me FMN-në.

Nëpërmjet miratimit të këtij projektligji do të avancohet procedura përmbarimore dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë dhe nevojën për ndryshim dhe plotësim të Ligjit në fuqi për procedurën përmbarimore, ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit Funkcional, e ftoj zonjën Selvije Halimi që ta marrë fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të procedurës përmbarimore dhe jep pëlqimin që ky projektligj të procedohet më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për procedurën përmbarimore, sepse është një projektligj, i cili e ka ndjesinë e vet për shkak të proceseve. Proceset përmbarimore përfshijnë shtresa të shumta të qytetarëve, e në mënyrë të veçantë shtresën sociale e të tillë, për fat të keq, ka shumë në Kosovë.

Prandaj, në mes këtij shqetësimi dhe shqetësimeve të palëve të tjera, ne duhet ta trajtojmë shumë kujdesshëm, në mënyrë që ky projektligj të jetë në interes të të gjitha palëve, e në veçanti ndaj qytetarëve debitorë.

Në këtë frymë, gjatë fazave të amendamentimit do ta japim kontributin tonë, andaj ne sot në parim do ta mbështetim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Agim Ademaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje të nderuar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore, i cili është në fuqi si ligj bazik nga viti 2013. Ky ligj kërkohet të ndryshohet dhe plotësohet, për shkak se gjatë zbatimit të tij, ministria ka vërejtur se ka hasur në disa vështirësi dhe në ato pjesë sigurisht se do të pësojë ndryshime.

Duhet thënë se deklaratat financiare thonë se ligji nuk do të ketë implikime financiare, ndërsa te memorandumit shpjegues i ministrisë, pika 7, thuhet se ky projektligj ka implikime financiare, prandaj duhet të harmonizohet.

Gjithashtu, kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë si propozues i këtij projektligji, që të përgatisë sqarime të nevojshme sa i përket nenit 4 të Projektligjit, e i cili ndryshon në nenin 13 të ligjit bazik, sepse këtu kemi një reagim të fortë të Odës së Përmbaruesve Privatë, që janë paraqitur me shkrim dhe se sigurisht se të dyja palët, edhe Ministria, edhe përmbaruesit privatë, do ta kenë mundësinë që në komision t'i paraqesin qëndrimet e tyre sa i përket nenit 13 të ligjit bazik, ose nenit 4 të projektligjit.

Gjithashtu, kemi edhe reagimin e Shoqatës së Bankave të Kosovës, por sido që të jetë ndërmjet dy leximeve, edhe komisioni, edhe të interesuarit me amendamentet e tyre do ta përmirësojnë këtë projektligj. Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah projektligjin dhe ju fton që ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Hoti, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Hoti, e keni fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Ky projektligj e rregullon kontrollin e brendshëm të financave publike nëpërmjet fuqizimit të këtij kontrolli në subjektet e sektorit publik në Republikën e Kosovës.

Projektligji buron nga Strategjia e kontrollit të brendshëm të financave publike 2015-2019, të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar në prill 2015. Strategjia i përcakton objektivat dhe veprimet për zhvillim të mëtutjeshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike. Ky kontroll përbëhet nga menaxhimi financiar e kontrolli dhe auditimi i brendshëm.

Korniza ligjore ekzistuese për kontrollin e brendshëm të financave publike, ndonëse përmban parime të përgjithshme dhe u referohet standardeve të pranura ndërkombëtare, duhet të adaptohet akoma sipas ndryshimeve në menaxhimin e financave publike dhe auditimin e brendshëm me standardet ndërkombëtare.

Në kontekstin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, fusha e rregullimit të këtij projektligji lidhet me Kapitullin 32 të ‘acquis communautaire’, që ka të bëjë me kontrollin e brendshëm të financave publike, auditimin e jashtëm dhe mbrojtjen e interesave financiare. Ky projektligj përbëhet nga 6 kapituj dhe ka gjithsej 36 nene.

Në kapitullin e parë janë rregulluar: qëllimi, fushëveprimi dhe përkufizimet e përdorura në këtë projektligj.

Në kapitullin e dytë është rregulluar menaxhimi financiar dhe kontrolli. Këtu, në veçanti, rregullohet llogaridhënia menaxheriale e udhëheqësit të subjektit publik, të zyrtarit kryesor administrativ, zyrtarit kryesor financiar, drejtuesve të niveleve vartëse dhe zyrtarëve tjerë publikë. Po ashtu, ky kapitull rregullon raportimin për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kapitulli i tretë rregullon auditimin e brendshëm, në veçanti themelimin, funksionimin, parimet e auditimit të brendshëm, si dhe komitetin e auditimit. Ky kapitull rregullon edhe pavarësinë funksionale të njësive të auditimit të brendshëm, përbërjen dhe rekrutimin e stafit, përgjegjësinë e udhëheqësit të subjektit publik për këtë njësi, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me funksionimin e kësaj njësie.

Në kapitullin e katërt trajtohet përgjegjësia e Ministrisë së Financave, Këshillit të Kontrollit të Brendshëm të financave publike dhe njësisë qendrore harmonizuese për menaxhimin financiar, kontroll dhe auditim të brendshëm.

Në kapitullin e pestë përcaktohen hapat për raportimin e parregullsive, ndërsa kapitulli i fundit i trajton dispozitat përfundimtare dhe ato transitore.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për kontrollin e brendshëm të financave publike është në përputhshmëri të plotë me obligimet që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Ky projektligj avancohet më tej

bashkëpunimin e njësisë qendrore harmonizuese për auditim të brendshëm me Auditorin e Përgjithshëm.

Ministria e Financave i ka analizuar detajet e implikimit financiar të këtij projektligji dhe projektligji nuk përbën kosto shtesë financiare. Burimet që nevojiten për zbatimin e këtij projektligji janë të planifikuara në kuadër të subjekteve publike. Gjithashtu, zbatimi i projektligjit mund të shpjerë në zvogëlimin, në fakt, të shpenzimeve aktuale nëpër organizata buxhetore. Po ashtu, projektligji nuk do të krijojë struktura të reja organizative, që kërkojnë kosto të reja financiare.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani e hap debatin në parim. Fjalën e ka kërkuar zoti Naim Fetahu, në emër të komisionit, apo në emër të...? Zoti Fetahu e ka fjalën.

NAIM FETAHU: Kryetar, e kam fjalën në emër të komisionit, meqë ky komision e ka pasur fatin e keq që për më shumë se një vit i ka munguar kryetari. Sot këtu i kemi edhe dy nënkryetarë, por sido që të jetë po flas në emër të komisionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2016, e shqyrtoi dhe miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-122 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-122 për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Arsyetimin e rekomandimit e paraqes në emër të komisionit.

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional para shqyrtimit të parë të Projektligjit, në mbledhjen plenare e shqyrtoi projektligjin dhe Kuvendit ia paraqes raportin me rekomandime.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit që të procedohet për shqyrtim të parë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Naim...

NAIM FETAHU: Unë desha të vazhdoj, gjithashtu edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e mbështetim këtë projektligj dhe e votojmë njëzëri. Gjithashtu, kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve, veçanërisht do të ndalemi te çështja e stimulimit të auditorëve, që është një çështje e ndjeshme. Besoj se bashkërisht me institucionet përkatëse do ta japim kontributin tonë në amendamentim dhe i ftojme të gjithë që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina, urdhëro!

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike. Është një ligj shumë me rëndësi dhe besoj se edhe deputetët tanë dhe komisioni ynë do ta japë kontributin gjatë leximit të dytë. I ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Edhe ky projektligj votohet nesër, në orën 10:00.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Rrahmani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministri e ka dërguar zëvendësuesin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës është një nga prioritetet kryesore strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Inspektorati Shëndetësor si instrument i Ministrisë së Shëndetësisë, nëpërmjet së cilës monitorohet situata në terren, përkatësisht bëhet inspektimi i institucioneve shëndetësore për respektim të dispozitave juridike, standardeve dhe normave etike profesionale relevante, në funksion të ngritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore.

Fuqizimi i Inspektoratit Shëndetësor është në interes të shoqërisë dhe kjo reflektohet edhe nga politikat prioritare të Qeverisë së Kosovës, ku në periudhën afatmesme 2014-2016, si dhe në programin e Qeverisë 2015-2018, në kuadër të riorganizimit të Ministrisë së shëndetësisë theksohet fuqizimi i rolit monitorues.

Arsyet për iniciimin e plotësim-ndryshimit për Inspektoratin Shëndetësor me nr. 03/L-019, ndër të tjera, përfshijnë:

- mangësitë në formën dhe procedurën e përcaktuar për hartimin e akteve juridike (nuk janë përcaktuar parimet, fushëveprimi dhe subjektet e inspektimit),
- përcaktimi jo i qartë i kompetencave të Inspektoratit,
- vështirësitë në ekzekutimin e dënimeve, që kanë ndikuar në zvogëlimin e të ardhurave buxhetore në të kaluarën,

Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore është drejtpërdrejt i lidhur me krijimin e kushteve më të favorshme për monitorim dhe inspektim të institucioneve shëndetësore.

Andaj, Ministria e Shëndetësisë propozon miratimin në parim të Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor, i cili, ndër të tjera, do të reflektojë në përcaktimin dhe zgjerimin e subjekteve të inspektimit, rregullimin e procedurës së monitorimit dhe inspektimit, ngritjen e cilësisë së sigurisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, rregullimin e ekzekutimit të gjobës, ndikimin në sektorin financiar duke rritur të hyrat buxhetore dhe përcjelljen e formatit të kërkuar për hartimin e ligjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit FunkSIONAL, fjalën e ka zonja Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar në parim projektligjin dhe vlerëson se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit që të miratohet.

Komisioni ka diskutuar gjerësisht për këtë projektligj dhe ka pasur mjaft vërejtje, sepse ky është një instrument, siç e tha edhe përfaqësuesi në emër të ministrit të Shëndetësisë, është një instrument i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm për zbatimin e ligjit për shëndetësi.

Vërejtjet tona sidomos kanë të bëjnë me statusin e punëtorëve të Inspektoratit Shëndetësor, që janë kryesisht mjekë, dhe një sërë çështjesh tjera.

Komisioni me dy vota abstenime dhe të tjerat për vlerëson se mund të shkojë më tutje, duke amendamentuar këtë ligj dhe duke shpresuar se mund ta bëjmë më funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar, fjalën e ka zonja Mustafa, ose Fadil Beka... Të dytë jeni paraqitur, merreni cili të doni!

NEHAT BAFTIU: Faleminderit, zoti nënkryetar,
Përshëndetje për ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe duke ditur rëndësinë që e ka ky projektligj për sistemin e shëndetësisë në Kosovë, ne në parim do ta mbështesim dhe kontributin do ta japim në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor dhe ka vlerësuar se është një projektligj me rëndësi të veçantë për vendin, respektivisht për sektorin e shëndetësisë, pasi që përmes avancimit të bazës ligjore synohet fuqizimi i Inspektoratit Shëndetësor, i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në ngritjen e kualitetit të shërbimeve të ofruara shëndetësore dhe do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të pacientëve.

Pra, edhe Grupi Parlamentar i LDK-së do t'i japë përkrahje të plotë në parim këtij projektligji, kurse gjatë dy leximeve, si grup parlamentar do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!
“6+” Parlamentar Gurubu Sağlık Müfettişlik Yasasını incelediğini ve Sağlık Bakanlığı ve Sağlık sektörü açısından son derece önemli olan bu Yasanın bir an önce komisyondan geçmesi için elimizden gelen çabayı göstereceğimizi bildirmek isterim. Elbette ki eksiklikler bu Yasada bu iki okunuş arasında tamamlanacağına umut ediyorum. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për Inspektoratin Shëndetësor është projektligj i rëndësisë së veçantë dhe konsideroj që duhet të jemi shumë të vëmendshëm gjatë fazës së amendamentimit të këtij projektligji.

Në këtë projektligj që e kemi sot këtu për diskutim në lexim të parë kam vërejtur disa mangësi, si për shembull: neni 4, te emërtimi, ku thuhet “Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës është organ i pavarur i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë”.

Në bazë të kompetencave që i ka Inspektorati Shëndetësor do të duhej të ishte: “Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës është organ i pavarur ekzekutiv i Ministrisë së Shëndetësisë”.

Neni 7 i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor është në kundërshtim me Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës.

Në nenin 4, të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës përcaktohen kategoritë e punonjësve publikë, të cilët nuk janë pjesë të Shërbimit Civil të Kosovës, e në këtë kategori janë edhe stafi mjekësor i sistemit shëndetësor.

Gjithashtu neni 18, te Të drejtat e personelit të Inspektoratit Shëndetësor, në projektligj thuhet: “Paga dhe përbërësit e pagës e të gjithë nëpunësve të Inspektoratit rregullohen në bazë të Ligjit të pagave të nëpunësve civilë”.

Pasi që punonjësit e Inspektoratit Shëndetësor nuk mund të jenë nëpunës civilë, edhe ky nen duhet të ndryshohet dhe të jetë:

“Paga bazë e personelit të Inspektoratit Shëndetësor të jetë sa paga bazë e profesionistëve shëndetësorë”.

Gjatë fazës së amendamentimit besoj se këto vërejtje do të merren parasysh dhe unë personalisht do të angazhohem në Komisionin për Shëndetësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nehat Baftiu e ka fjalën.

NEHAT BAFTIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë,

Qytetarë të nderuar,

Projektligji mbi Inspektoratin Shëndetësor ka paraparë ndryshime, të cilat thellësisht dëmtojnë të punësuarit në këtë institucion, inspektorët shëndetësorë degradohen në aspektin profesional dhe material.

Në nenin 4 të këtij projektligji theksohet: “Inspektorati Shëndetësor është organ i pavarur ekzekutiv i Administratës Shtetërore, në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë”, e të tjera.

Vërejtje: Ligji për Shëndetësi, në nenin 47, paragrafi 1, Inspektoratin Shëndetësor e trajton si organ administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili bën mbikëqyrjen e jashtme të institucioneve shëndetësore, ku ndryshimi i propozuar në projektligj përbën shkelje të Ligjit për shëndetësi dhe gjithashtu trajtimi i Inspektoratit si organ i pavarur përbën një rrethanë të re juridike në institucionet tona shëndetësore.

Neni 7 i këtij projektligji i ka përcaktuar kushtet dhe përgatitjen profesionale të inspektorëve shëndetësorë, ku shkruhet: “Funksionin e inspektorit shëndetësor e ushtron personi i cili i përmbush të gjitha kriteret sipas Ligjit për Shërbyesit Civilë, si dhe këto kriteret shtesë: “Të jetë profesionist apo bashkëpunëtor shëndetësor i licencuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë”.

Vërejtje: Ministria e Shëndetësisë në Ligjin për shëndetësi në mënyrë taksative ka rregulluar procesin e licencimit të profesionistëve shëndetësorë, i cili përcaktohet me Ligjin mbi odat e mjekëve, profesionistëve shëndetësorë dhe meqë deri më tani nuk janë funksionalizuar odat, në fuqi është Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë 10/2011, i cili përcakton se cilat profesione duhet të licencohen.

Prandaj, unë nuk e kam të qartë këtu këtë “bashkëpunëtorin shëndetësor”. Me çfarë përgatitjesh shkollore është ai dhe si do të licencohet, sepse në ligjet tona për shëndetësi nuk ka titull të tillë.

Neni 11 i këtij projektligji, në paragrafin 2 thekson se “kryeinspektori shëndetësor emërohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil”. Duhet të ndërrohet “shërbimi civil”, sepse kryeinspektori duhet të jetë mjek, profesionist shëndetësor, prandaj me legjislacionin që e kemi në fuqi, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, kjo duhet të jetë “nëpunës publik”.

Neni 18 i këtij projektligji për të drejtat e personelit të Inspektoratit Shëndetësor ka përcaktuar që pagesa e tyre të bëhet konform pagave të nëpunësve civilë.

Duke marrë parasysh se inspektorët shëndetësorë janë profesionistë shëndetësorë, të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në këtë institucion dhe si të tillë duhet të trajtohen, prandaj edhe propozoj që pagesa e inspektorëve të punësuar në Inspektoratin Shëndetësor duhet të jetë në nivel të pagës së profesionistëve shëndetësorë, të punësuar në institucionet shëndetësore.

Unë kam informatën se në Inspektoratin Shëndetësor janë 7 profesionistë shëndetësorë, mjekë të profesioneve të ndryshme, dhe nuk mund të marr me mend se si mund të degradohet rroga e tyre përgjysmë.

Te neni 18.2 - profesionisti dhe bashkëpunëtori shëndetësor, prapë po bie ndesh me atë, sepse në shëndetësi nuk ka bashkëpunëtorë shëndetësorë. Te ne nëpër spitale bashkëpunëtorë shëndetësorë i kemi personat që bartin pacientët dhe janë pa përgatitje shkollore. Unë nuk e kuptoj këtë “bashkëpunëtorin shëndetësor”.

Në bazë të këtyre vërejtjeve të lartcekura, kërkoj nga ana juaj, deputetë të nderuar, që të trajtoni me seriozitet përmirësimet e këtij ligji, sidomos nenin 4, nenin 7, nenin 11 dhe nenin 18 që të jenë të zbatueshëm në praktikë para se të miratohen në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Votimin do ta bëjmë për këtë pikë nesër, në orën 10:00.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në këtë seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës do të paraqes para jush, në emër të Zyrës së Kryeministrit, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Qeveria e Kosovës më datë 30. 9. 2016 me Vendimin nr. 02/110 e ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në eliminimin e zbrazësive ligjore, të cilat janë evidentuar në ligjin aktual.

Me këtë projektligj synohet të rregullohet statusi juridik i bashkësive fetare, sepse një grup fetar pa statusin e personit juridik nuk mund të zotërojë ose të shtrojë të drejtat e tij që lidhen me statusin juridik të një entiteti.

Në ligjin në fuqi njihen 5 bashkësi fetare në Kosovë, të cilat përbëjnë edhe trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit.

Si bashkësi që përbëjnë trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit në projektligj është shtuar edhe Bashkësia e Tarikateve të Kosovës dhe kjo duhet të evidentohet.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë rregullon mënyrën dhe kushtet e regjistrimit të bashkësive të reja fetare në Kosovë.

Shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin dhe çregjistrimin e bashkësive fetare në Republikën e Kosovës e kryen Komisioni për Regjistrimin e Bashkësive të Reja Fetare.

Komisioni do të përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen ad hoc, duke e respektuar përbërjen etnike dhe gjinore në Kosovë.

Bashkësitë fetare nuk janë të detyruara të regjistrohen dhe të pranojnë statusin e personit juridik kundër vullnetit të tyre.

Me këtë ligj kryeministri cakton zyrën përkatëse për bashkësitë fetare në kuadër të Zyrës së tij, e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë ka qenë në konsultime publike, e gjithashtu janë organizuar tryeza diskutimi, në të cilat kanë marrë pjesë të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë edhe të gjitha bashkësitë fetare, ndërsa komentet janë të përfshira në Memorandumin shpjegues të projektligjit.

Për projektligjin ka dhënë opinionin Komisioni Evropian për Demokraci përmes ligjit, pra Komisioni i Venedikut, Opinionin nr. 743/2013 i miratuar në sesionin e 98-të plenar.

Zyra ligjore e kryeministrit gjatë hartimit të këtij projektligji ka marrë parasysh dhe ka inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e marra nga ky komision dhe nga palët e tjera të interesuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Komisionit FunkSIONAL. Fjalën e ka zonja Lirije Kajtazi. Liria s'qenka këtu dhe në mungesë të saj, fjalën e merr Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 56.2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës, në mbledhjen e mbajtur më 26.10.2016 e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë.

Arsyetim: Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Me këtë rast po e paraqes edhe qëndrimin e grupit parlamentar.

Pra, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për liritë fetare në Kosovë dhe i japim mbështetje në parim, duke u angazhuar në fazën kur amendamentohet për të qenë i zbatueshëm ky projektligj në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë dhe ne i japim mbështetje në parim dhe i ftojmë të gjithë deputetët që ta miratojnë në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë nuk ka të paraqitur. Fjalën e ka zoti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përshëndetje për ministrat,

Kolegë deputetë,

Projektligji për liritë fetare që ka ardhur sot këtu në Kuvendin e Kosovës është pothuaj se i njëjti me atë që ka ardhur para disa muajve këtu në Kuvendin e Kosovës, dhe nuk ka kaluar, që do të thotë se Qeveria e ka bërë të njëjtin veprim, nuk e ka bërë korrigjimin e tij dhe ky projektligj për dy arsye nuk duhet të kalojë.

E para është se është një projektligj, i cili synon të rregullojë legjislacionin dhe organizimin e bashkësive fetare në Kosovë, ndërsa në anën tjetër, e ka anashkaluar vullnetin dhe pëlqimin e bashkësisë fetare, konkretisht bashkësisë fetare më të madhe, Bashkësisë Islame.

Ne e dimë qëndrimin e tyre publik, edhe në medie, edhe zyrtarisht, se ata nuk pajtohen me këtë projektligj, do të thotë që nëse ky projektligj është në kundërshtim me vullnetin dhe pëlqimin e bashkësisë më të madhe në Kosovë, atëherë për kë po e bëjmë këtë projektligj.

Dhe, e dyta, pse nuk duhet të kalojë ky projektligj, nga se është i njëjti problem që ka qenë dhe e përsërita më herët kur është refuzuar nga Kuvendi, sepse hap një derë shumë të rrezikshme, e hap një derë që rrezikon tolerancën ndërfetare në Kosovë dhe ajo derë është se me këtë projektligj mundësohet që çdo komunitet apo bashkësi fetare me 50 anëtarë të themelohet si bashkësi fetare në Kosovë. Imagjinoni ju, në të ardhmen çdo komunitet të synojë të themelojë bashkësi të re fetare në Kosovë.

Prandaj, ky projektligj të njëjtin problem e ka që e kam përmendur edhe herën e fundit kur është refuzuar nga Kuvendi, sepse rrezikon tolerancën ndërfetare, të cilën vendi ynë e gëzon dhe duhet ta ruajë.

Kur jemi te toleranca ndërfetare ne e dimë edhe aktin që ndodhi me rastin e festës së flamurit, më 28 Nëntor, kur u sulmua Konsullata e Republikës së Turqisë, një akt i cili rrezikon të rrënojë raportet ndërshtetërore dhe tolerancën ndërfetare e ndëretnike në Kosovë. Prandaj, Republika e Kosovës duhet të jetë shumë e fuqishme në këtë punë, edhe në aspektin legjislativ, por edhe në aspektin ekzekutiv: të mos lejojë askënd për çfarëdo lloj interesi të rrezikojë tolerancën ndërfetare e ndëretnike në Kosovë.

Është për keqardhje se si institucionet kosovare dhe ato qeverisëse të drejtësisë e cilësojnë aktin në Konsullatën turke si akt vandal të personave të papërgjegjshëm, përderisa ai është një akt i pastër terrorist nga persona me qëllime terroriste e kriminale.

Kujtojmë se sulmi ndaj Kuvendit të Kosovës ka qenë i njëjtë me molotov sikur ndaj Konsullatës turke, por sulmi ndaj Kuvendit të Kosovës është cilësuar si akt terrorist, ndërsa ndaj Konsullatës nuk cilësohet i tillë. Pra, imagjinoni, sikur të sulmohet ndonjë objekt tjetër, objekt shtetëror, rast konkret i ndonjë komuniteti serb, ne sot do të ishim në Këshillin e Sigurimit të ftuar me kërkesë nga Qeveria e Serbisë për akte të tilla. Prandaj qeveria e Kosovës duhet të marrë të gjitha masat për t'i parandaluar këto sulme me hapa konkretë, duke u dhënë dënimin e merituar personave të tillë që e kanë kryer këtë akt terrorist a kriminel, por në anën tjetër edhe duhet të ketë kujdes kur jemi te legjislacioni të mos na sjellë këso ligjesh që rrezikojnë dhe dëmtojnë tolerancën ndërfetare dhe ndëretnike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nënkryetari, zoti Sabri Hamiti e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit! Së pari, ky ligj sot formalisht ka ardhur dhe ne duhet t'i themi dy-tri fjalë, meqë u hap diskutimi unë do t'i them dy-tri fjalë. Përndryshe, që tash dihet se ky ligj

s'do të votohet, sepse kërkohet mënyra e votimit të dyfishtë dhe njerëzit s'janë të pranishëm e s'mund të votojmë.

Prandaj është mirë që nganjëherë të mos e luajmë njeriun që s'i di punët. Ky është ligj që duhet ta votojmë edhe 2/3 ose 11 deputetë të komuniteteve minoritare, apo s'di si t'i themi tash, përfaqësuesve dhe pa ta ne bisedojmë kot.

Pra, meqë u hap diskutimi, unë dua t'i them dy-tri vlerime.

Nën një. Jo gati, por është ligj i ngjashëm dhe jo as gati i ngjashëm, por është i njëjti me të gjitha formulimet që para një viti, e jo disa muajsh, por vitin e kaluar e kemi diskutuar dhe s'e kemi votuar në këtë Kuvend.

Pra, është i njëjti ligj, i njëjti tekst. Nuk ka asnjë ndryshim, është rikthyer i pandryshuar dhe ne jemi të njëjtit. E tash, të shohim kush çka ndryshon? Domethënë, është e njëjta përbërje e Parlamentit, është i njëjti ligj dhe të njëjtat materie dhe atëherë le ta provojë këtë punë Kuvendi.

Unë, meqë është i njëjti, po të flitja do ta përsëritsha me pikë e me presë atë që kam folur herën tjetër. Kështu që mund ta marr, nëse vazhdojmë bisedimet, dhe ta lexoj edhe një herë, sepse s'kam ndërruar mendim, por s'ka ndërruar as projektligji.

Mirë është me legjislacion të krijohen të drejtat e besimeve fetare në Kosovë, sigurisht, veç duke pasur parasysh se kjo është një Republikë laike, e këto janë dy elemente. Nëse nuk kihen parasysh totalisht në normime këto të dyja, mund të ketë pastaj probleme që ligji mund të kodifikojë ose të mos kodifikojë.

Unë më tutje nuk po flas, zoti kryesues, por edhe një herë po sjell në vëmendje sepse unë e di, të gjithë deputetët njësoj edhe s'i lexojnë ligjet. Shumica mund të mendojnë se ky tash është rishikuar. Kurrë s'ka ndërruar! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqaj e ka fjalën.

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Përhëndetje për deputetët, për ministrat dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës!

Ne, realisht e kemi shqyrtuar edhe më herët këtë ligj, por ka qenë problemi i njëjtë. Propozimi im sot do të ishte të hiqet nga rendi i ditës, të shtyhet deri kur të krijohen kushtet, për arsye se projektimi i këtij projektligji në seancë plenare duhet të bëhet në përputhje me nenin 81 dhe amendamentin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku duhet të jenë 11 anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga komunitetet joshumicë.

Unë si deputet, mund të them edhe si subjekt politik, e në këtë rast si Parti Demokratike, e përkrahim si të tillë, dhe nuk desha të ndalem e të flas, për arsye se po them duhet të tërhiqet e të shtyhet për një mbledhje tjetër kjo pikë, pika e nëntë e rendit të ditës.

Megjithatë, u tha këtu se me këtë ligj nuk pajtohen bashkësitë e tjera fetare dhe unë mendoj që nuk është me rëndësi dhe nuk është relevante sa pajtohen apo nuk pajtohen bashkësitë e tjera fetare.

Dhe krejt e re, këtu që u tha nga përfaqësuesi i Qeverisë, ministri, shtohet “bashkësia e tarikateve”. Realisht kjo bashkësi e tarikateve, edhe ata janë islamë, funksionojnë në Kosovë, janë historikisht që funksionojnë e ekzistojnë në Kosovë dhe kanë vepruar në Kosovë e në Shqipëri nga rilindësit edhe më herët, ndoshta, mund të them, të cilët kanë dhënë kontribut gjatë gjithë historisë për shtetformimin, kanë dhënë heronj, kanë dhënë dëshmorë nga radhët e tyre dhe kanë derdhur gjak që sot të jemi ku jemi.

Andaj, unë kisha thënë se kjo përkundrazi e rrit tolerancën fetare dhe ne jemi shtet laik me Kushtetutë dhe mendoj se nuk ka kurrgjë të keqe ta përkrahim këtë bashkësi. Përkundrazi, unë ndoshta në konsultim me bashkësinë e tarikateve kisha kërkuar prej tyre që t’i shtohet edhe një term dhe në fund të jetë: Bashkësia e Tarikateve Islame.

Nuk ka të keqe që të ekzistojë edhe Bashkësia Islame e edhe Bashkësia e Tarikateve Islame. Pra, edhe nëse bëhet, u tha nga dikush, janë 50 deri 100 anëtarë, por edhe nëse bëhet 5 000 anëtarë e 10 000 anëtarë, edhe 50 000 anëtarë, mund t’i mbledhin nënshkrimet për t’u regjistruar.

Kështu propozimi ishte që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës dhe ishte një sqarim i shkurtër. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

U tha edhe nga parafolësit e mi se ky projektligj ka qenë këtu, e kemi biseduar dhe kemi dhënë sugjerimet tona herën e parë dhe mendoj që Qeveria është dashur t’i marrë ato rekomandime që kanë dalë nga diskutimi para se ta delegojë këtë ligj në Kuvend.

Nuk po e kuptoj pse i njëjti ligj shkronjë për shkronjë duhet të vijë, ashtu sikur që e tha profesor Hamiti, kur i njëjti tashmë e ka marrë një vlerësim dhe ne jemi po të njëjtit njerëz, nuk kemi legjislaturë tjetër.

Unë mendoj se ky ligj nuk është mirë të kalojë. Është mirë që Qeveria ta tërheqë dhe t'i marrë të gjitha ato refleksime, nga kushdo qofshin ato dhe të gjejë një bashkëdyzim të vullnetit të bashkësive fetare.

Në këtë ligj janë dy komponentë që janë në kundërthënie njëri me tjetrin. E para, në Kosovë dihet se tradicionalisht kanë qenë 3 bashkësi fetare dhe nëse ka diçka që u ka qëndruar stuhive të kohës në Kosovë, një vlerë shumë e madhe, ka qenë toleranca ndërfaqetare. Dhe nuk e di çfarë na duhet neve tash të prekim aty që të çrregullojmë apo të lëmë vakume, sepse u tha që mbyll disa vakume, e unë mendoj që s'mbyll vakume, por po hap vakume.

Pra, përcakton tash jo 3, por 5 apo 6 dhe, në anën tjetër, e vë një kriter që merret numri i anëtarësisë.

Nëse e marrim fjalën apo termin "fe", nënkupton se ai duhet të jetë një komunitet bukur i gjerë. Por, nëse e themi termin, ia shtojmë edhe bashkësitë fetare, atëherë kuptohet se ai ka një anëtarësi shumë më të madhe. Në anën tjetër, në ligj i figuron 50 anëtarë.

Unë mendoj se këto dyja janë në kundërshtim njëra me tjetrën dhe, edhe po të mos jenë në kundërshtim njëra me tjetrën, në 50 anëtarë mund të formojnë jo një fe, por njëqind fe. Dhe ne e dimë që edhe pa ekzistimin e kësaj, disa të tilla pas luftës na janë hedhur, sikur rasti i xhamisë në Drenas dhe xhamisë në Prishtinë, në objektin e autoservisit "Boshko Çakiq", atje që është i uzurpuar, dy xhami që kanë operuar jashtë Bashkësisë Islame dhe prej këtyre kanë dalë elemente radikale që sot Kosova në një mënyrë po turpërohet nga veprimet e njerëzve të tillë.

Prandaj, një ventil i tillë të hapet, nuk e shoh bash dashamirës dhe propozimi im është konkret që Qeveria ta tërheqë dhe të reflektojë në këto sugjerime, qoftë të Bashkësisë Islame apo bashkësive të tjera dhe të opinionit në përgjithësi, në mënyrë që të nxjerrim një ligj, i cili vërtet është i dinjitetshëm dhe respekton vullnetin e njerëzve fetarë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Ky projektligj për liritë fetare në Kosovë... Ne e kemi një ligj të 2006-ës dhe ndoshta është mjaft i mirë ai, por megjithatë me plotësim-ndryshimet që janë kërkuar edhe me këtë... Ne kemi pasur një rrethanë në pakon e Ahtisarit dhe e kemi shpallur pavarësinë, ka qenë pikërisht çështja e kishës dhe Kishës Ortodokse Serbe.

Për ne, nëse e themi Kisha Ortodokse Serbe, kemi përkufizuar të gjitha kishat ortodokse që janë të Serbisë. Përkundrazi që ne në Kosovë kemi edhe kisha ortodokse shqiptare, prandaj ky projektligj nuk e sheh Kishën Ortodokse Shqiptare, ose duhet t'i hiqet prapashtesa serbe dhe të

mbetet Kisha Ortodokse e Kosovës, atëherë kemi një kuptim të plotë se të gjitha kishat janë të gjithë qytetarëve. Feja nuk është e një bashkësie, feja nuk është e një etnie, as e një partie, as e një kombi. Do të thotë, feja është një nocion më i gjerë se sa një bashkësi, apo një nocion i një kombi, prandaj edhe duhet të jetë Kisha Ortodokse e Kosovës ose Kisha Ortodokse Shqiptare. Ta kemi pra edhe Kishën Ortodokse Shqiptare, sepse veç në Prizren e kemi Kishën Ortodokse të Gogëve që është ngjitas me Kishën Ortodokse Serbe. E tash ajo kisha shqiptare aty është asimiluar dhe është kthyer në kishë ortodokse serbe.

Në anën tjetër, e kemi edhe Bashkësinë e Tarikateve, e cila historikun e ka mjaft të lashtë, i kemi veprat e Naim Frashërit që na ka shkruar mjaft shumë për bektashinjtë e për tarikatat. Ne kemi mësuar edhe për të gjitha ato përpjekjet e tyre. Të vetmin vend që e kemi në shqiptarët në botë e kemi Kryegjyshitën e bektashinjve, prandaj edhe kjo është një historik i tyre.

Por, në anën tjetër, e kemi historikun po ashtu shumë të madh të tarikateve, ku lufta e tyre për shtet ka qenë mjaft e madhe. E kemi procesin e Prizrenit me sheh Hasanin të burgosur dhe të dënuar me vdekje. Janë po ashtu si bashkësi, kanë ekzistuar dhe ekzistojnë, kanë mjaft mëhyp, i thonë ata, anëtarë apo simpatizantë të tyre nëpër gjithë territorin e Kosovës dhe kjo nuk bën të mohohet apo të hiqet.

Në anën tjetër, e kemi te neni 7b: Regjistrimi i bashkësive fetare. Është e palogjikshme të lejohet e të regjistrohet me 50 anëtarë një bashkësi fetare. Ajo do të thotë, vetëm celulat e organizimit terrorist janë në këtë formë. Nëse lejohet një bashkësi të krijohet me 50 anëtarë, ne ua kemi dhënë mundësinë të gjitha grupeve të organizatave joqeveritare që i kemi e që janë të financuara nga jashtë, nga të huajt, që nuk u dihet ku i kanë burimet e tyre, të krijojnë mundësi të bashkësive dhe ajo të jetë një mundësi që ne të kemi elemente të dhunës nesër a pasnesër në Kosovë.

Prandaj, njohja e Kishës Ortodokse, si në nenin 4a, të bashkësive fetare: Kisha ortodokse e Kosovës ose Kisha ortodokse shqiptare, atje si pikë edhe të regjistrimit, po ashtu të jetë numri 5 000 e më tepër që të kemi mundësinë edhe të kontrollit financiar, sepse të gjitha këto bashkësi financohen nga dikush, nga i marrin ato të hyra?

Unë po ashtu pajtohem edhe me vërejtjet e kolegëve që i dhanë, prandaj neve na duhen edhe 2/3 edhe të komunitetit pakicë për ta kaluar këtë projektligj, por ky projektligj është vështirë të kalojë në këtë rrethanë, prandaj ne i japim vërejtjet sikur herën e kaluar, që e tha profesori, por megjithatë mbesim në vendnumërim. Por, megjithatë ne po e themi tonën se ky ligj do të ketë një vlerë dhe t'i mbrojmë ato vlera të traditës dhe kjo e jep një mundësi të tolerancës fetare në Kosovë.

KRYESUESI: Nuk dua të interferoj në ligjin, por unë mendoj se ligji pikërisht ka për detyrë të mos lejojë paralelizma të kundërligjshëm. Dhe, nëse e miratojmë një ligj për këtë çështje, unë

besoj se këto paralelizma të dyfishtë dhe për veprime kundërligjore dhe terroriste, do të pamundësohen të veprojnë, sepse do të bien ndesh edhe me ligjin.

Sidoqoftë, unë kam parasysh atë, por proceduralisht unë s'pata s'i ta heq, meqë s'kemi edhe kuorum për t'i propozuar ose për t'i vënë në votim propozimet tuaja. Pra, ne e kemi shterur debatin dhe në momentin që Kryesia, respektivisht kryesuesi i seancës konstaton se në sallë janë votat e domosdoshme, me siguri se do ta nxjerr në votim, nëse s'ka tjetër qëndrim nga Qeveria.

Mendoj se është koha e drekës dhe do të kemi pauzë deri në orën 15:00, e pastaj do të vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës sipas radhës, është pika e dhjetë e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë

Shqyrtimi i parë i këtij projektligji ka qenë i radhitur në rend të ditës në seancën plenare më 10 mars 2016, mirëpo ministri Abrashi, në emër të Qeverisë së Kosovës, e ka tërhequr nga rendi i ditës.

Ndërkohë Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që këtë projektligj ta radhisë për shqyrtim në seancë plenare.

Mbështetur në nenin 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministren e Tregtisë, nuk është këtu, atëherë ministri i Financave, zoti Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë shkurtimisht të paraqes qëllimin e rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë.

Qëllimet e këtij projektligji janë: përmirësimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë, transpozimi dhe implementimi i direktivës evropiane për sigurimin e furnizimit me karburante të naftës, direktivës për promovimin e përdorimit të biokarburanteve në transport, thjeshtësimin e procedurave për licencimin e subjekteve që merren me tregti të produkteve të naftës, rritjen e efikasitetit të institucioneve të administratës publike në mbrojtjen e ambientit të konsumatorit dhe sigurimin e cilësisë së produkteve të naftës.

Projektligji përmban dispozita të reja, të cilat i përmirësojnë të mëparshmet që kanë pasur mangësi, sidomos sa i përket rregullimit dhe mbikëqyrjes së cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës.

Ky projektligj do të kontribuojë edhe në luftimin e informalitetit brenda këtij sektori, pos që përmes deponimeve do të pamundësohet importi i naftës në mënyrë të parregullt.

Me këtë projektligj janë korrigjuar në tërësi definicionet lidhur me produktet e naftës dhe janë shtuar definicione të reja dhe është krijuar baza ligjore për përdorim të biokarburanteve, kërkesë kjo që rrjedh nga direktiva e Bashkimit Evropian 2009/28 të Komisionit Evropian.

Projektligji rregullon më mirë procedurat për sigurimin e cilësisë së naftës, ku përmes dispozitave të reja obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që t'i publikojë në baza mujore listat e subjekteve ekonomike të cilat shkelin legjislacionin e naftës.

Është rregulluar zgjatja e afatit të lejeve për tregti me produkte të naftës nga dy në pesë vjet.

Janë eliminuar kërkesat për dokumentet e tepërta si dhe është bërë harmonizimi me Ligjin për leje dhe licenca dhe ligje të tjera.

Përmes deponive do të krijohen parakushtet për përmbushjen e obligimeve ligjore të Kosovës, të cilat rrjedhin nga legjislacioni i BE-së dhe marrëveshjet, të cilat i ka nënshkruar Kosova.

Këto marrëveshje e obligojnë Kosovën që deri në vitin 2022 të ketë 150 mijë tonë karburant si rezerva shtetërore.

Duhet cekur se kapaciteti aktual i të gjitha deponive që ka Kosova është vetëm 30 mijë tonë karburant.

Gjatë hartimit të projektligjit janë konsultuar të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë Zyrën e kryeministrit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë, të Punëve të Brendshme, Ministrinë e Integritetit Evropianëve, Doganat e Kosovës dhe institucione të tjera.

Përveç institucioneve publike, janë konsultuar edhe grupe të tjera të interesit, siç janë organizatat e biznesit, odat ekonomike, shoqata e natarëve edhe grupet e tjera të interesit.

Ky projektligj është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave dhe opinioni ligjor me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritetit.

Duke pasur parasysh këto ndryshime, konsideroj se me këtë projektligj mundësohet një mjedis shumë i favorshëm dhe më i rregulluar për funksionimin dhe zhvillimin e sektorit të naftës. Ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Radhën e ka përfaqësuesi i Komisionit Funkcional, zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues,

I nderuar ministër,

Duke mos përsëritur përshkrimin e procedurës, të cilën e thatë ju në fillim, kam kënaqësinë të informoj Kuvendin se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i ka propozuar Kuvendit që në parim ta aprovojë këtë projektligj, duke e vlerësuar rëndësinë e tij për rregullimin e tregut dhe cilësisë së naftës dhe produkteve të saj.

Gjatë diskutimit në komision ka mbretëruar mendimi dhe është theksua nevoja që të rishikohet neni 5 lidhur me të drejtën e importimit, duke theksuar nevojën që të ruhet konkurrenca në treg dhe të kemi parasysh karakteristikat e bizneseve në Kosovë që merren me importin dhe shitjen e naftës me shumicë dhe pakicë.

Një çështje tjetër që është debatuar gjerësisht në komision është se patjetër me këtë ligj duhet të precizohen në mënyrë të qartë të gjitha masat dhe të gjitha instrumentet, në mënyrë që të sigurohet kontrolli i cilësisë dhe të sigurohen në tregun e naftës dhe derivateve të naftës standardet e caktuara evropiane.

Lidhur me këtë kemi diskutime të shumta, ligji ka dhënë disa përmirësime, por sigurisht në leximin e dytë do të merremi edhe me këtë çështje. Pra, këto janë dy çështje, të cilat do t'i trajtojmë në leximin e dytë, por komisioni mendon që ky ligj duhet të aprovohet në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar këtë projektligj.

Është një projektligj, i cili është gjatë në pritje. Disa çështje u thanë edhe nga kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Mustafa, për problemet të cilat i ka ky ligj.

Normalisht ne si Grup i Partisë Demokratike të Kosovës kemi qëndrimin tonë sa i përket nenit 5, i cili besoj që duhet të reflektojë realitetin në treg dhe duhet të kemi parasysh të mos na krijohen hapësira për krijimet e monopoleve dhe në tregun tonë dhe që kjo pastaj të rezultojë edhe me shtrenjtimit të çmimeve, të cilat normalisht do të krijojnë një situatë jokorrekte në raport me të gjithë ata që janë pjesë e tregut.

Prandaj, në këtë drejtim ne do të japim kontributin tonë në mes të dy leximeve që këtë nen ta ripërpunojmë.

Qeveria tanimë ka bërë të veten dhe ne do ta shikojmë në mënyrë të detajuar dhe që të shprehim interesin e kompanive, por edhe interesin e qytetarëve në këtë nen.

Çështja e dytë që dëshirojmë të ritheksojmë është cilësia e karburanteve. Besoj që ligji deri diku i ka targëtuar, por çështja mbetet ku duhet të kontrollohen dhe cila do të jetë roli edhe i Doganës në këtë drejtim dhe gjithashtu besojmë që kjo çështje është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ne prapë në mes të dy leximeve do të japim qëndrimet tona sa i përket kësaj.

Një çështje që nuk është prekur fare nga ligji dhe besoj që duhet të trajtohet janë humbjet gjatë transportit dhe deponimeve, të cilat janë evidente dhe që dëmtojnë afarizmin e këtyre ndërmarrjeve, pra edhe ajo çështje të trajtohet konform standardeve dhe normave evropiane, të cilat janë të përcaktuara se çfarë humbjesh duhet të pranohen në momentin e depozitimit apo edhe të transportimit të karburanteve.

Pra, ne në mes të këtyre dy leximeve do të japim kontributin tonë, do ta ndryshojmë nenin 5 dhe normalisht i thërrasim deputetët që ta votojnë dhe në mes të dy leximeve ta ripërpunojmë edhe një herë sipas interesave të qytetarëve, por edhe sipas interesave të kompanive në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Grainca.

BLERIM GRAINCA: Grupi Parlamentar i LDK-së e ka trajtuar me kujdes këtë projektligj, i cili e rregullon funksionimin e një sektori të rëndësishëm dhe ka ndikim jo vetëm në buxhetin e Republikës së Kosovës, por edhe në standardin e qytetarëve, në cilësinë dhe kualitetin e jetës së tyre.

Grupi Parlamentar në vazhdimësi me qëndrimet e tij, edhe nga përbërja e kaluar e Kuvendit në përputhje me programin e LDK-së dhe në përputhje edhe me programin e Qeverisë për liberalizimin e tregut si dhe në përputhje edhe me nenin 10 të Kushtetutës që garanton një ekonomi të lirë dhe të tregut, e ka shqyrtuar sot në Grupin Parlamentar këtë projektligj dhe i ka vërejtjet e caktuara që lidhen me dy pika që kanë të bëjnë me këtë ligj.

Në një, Grupi Parlamentar i LDK-së do të bëjë amendamentimin e nenit 5, i cili në formën si është formuluar nuk ofron konkurrencë të lirë, duke kushtëzuar importin dhe shitjen me shumicë përmes posedimit të deponive, e që mendojmë se është një cenim i konkurrencës, gjegjësisht është krijim i monopoleve.

Dhe, në dy, po ashtu LDK-ja do të bëjë amendamentimin e nenit 10, në mes të dy leximeve përmes deputetëve të saj që ka në Komisionin për Zhvillim, duke kërkuar që cilësia e naftës të matet në kufij dhe jo brenda territorit, sepse vetëm në këtë formë ruhet kualiteti dhe po ashtu kërkojmë që kontrolli i kualitetit të bëhet përmes laboratorëve të licencuar, një e më shumë laboratorëve, do të thotë, të mos jetë vetëm një laborator i licencuar.

Të gjitha këto vërejtje Grupi Parlamentar do t'i shndërrojë në amendamente në mes të dy leximeve, kështu që sot ju ftojme për t'u hapur rrugë procedurave të mëtutjeshme, ta votojmë në parim këtë ligj, në mënyrë që deri në leximin e dytë të bëjmë plotësimet e nevojshme, që ligji të sigurojë një veprim të mirë dhe operim të drejtë të tregut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Raif Qela e ka fjalën.

RAIF QELA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër, ministër,

Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë është shqyrtuar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në janar të këtij viti.

Për shkak se i ka pasur dy probleme të mëdha, të cilat i kanë theksuar po thuajse të gjithë anëtarët e komisionit, ky projektligj u tërhoq nga seanca në mars të këtij viti.

U prezantua përsëri tani me besimin se do të kalojë, edhe për shkak se i rregullon një sërë fushash më mirë se që kanë qenë deri më tani, ky ligj vlen të procedohet më tutje, por me kushtin që të metat që i ka pasur e që janë evidencuar edhe që thanë edhe prej parafolësve, të rregullohen.

Të metat e mëdha të këtij projektligji janë këto:

1. Nuk është trajtuar si duhet cilësia e kontrollit të naftës, sepse ajo duhet të bëhet edhe në kufij, edhe brenda dhe duhet të theksohet përderisa është një çështje mjaft me rëndësi tregtia e naftës, që të rregullohet tregu siç duhet dhe që të mos lejojmë që të bie ndesh me një mori ligjesh të tjera të aplikueshme në Kosovë. Kjo duhet të rregullohet dhe të theksohet që plani i monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës në kufi duhet të jetë pjesë e këtij ligji, në të kundërtën ky ligj do të jetë shumë i mangët.

Çështja tjetër me rëndësi është edhe neni 5, në të cilin kërkohet nga importuesit potencialë të naftës që ta plotësojnë kushtin që të kenë deponi më të mëdha se sa një milion e 300 mijë litra për derivate, që është kufi i papërballueshëm për pjesën më të madhe të bizneseve, është shumë kufizues dhe si i tillë do t'i qesë nga tregu pjesën më të madhe të tregtarëve të naftës.

Mund të mbesin në treg vetëm nga 4 ose 5 eventualisht, më së shumti, me shumë përpjekje deri në 10 apo 12, të gjithë të tjerët do të dalin prej tregut, edhe pse tani janë të licencuar, edhe pse kanë investuar në këtë fushë dhe është krejtësisht e padrejtë, përderisa u kemi hapur rrugën përmes licencimeve që ua kemi bërë dhe tani t'u mbyllet dera edhe t'i qesim prej tregut. Kjo është krejtësisht e padrejtë dhe si e tillë duhet të rregullohet ose kjo dispozitë duhet të hiqet fare ose duhet t'i jepet një afat shtesë prej nga 5 vjetësh dhe pas 5 vjetësh të vijë në shprehje përpjekja që përmes krijimit të depozitave të bëhet përpjekje të krijohen edhe rezerva shtetërore të cilat janë të kërkuara.

Rezervat shtetërore për naftë si dhe kërkesat për cilësi mund të rregullohen shumë më mirë, sikur e ka rregulluar Sllovenia, për shembull. Ata e kanë një fond për cilësi dhe fond për rezerva dhe për çdo litër të karburantit japin një shumë minimale për të dhe bëhet mjaft që në këtë mënyrë të sigurohet ky fond dhe në këtë mënyrë do të sigurohet edhe mundësia që të bëhen depozitat për naftën dhe të sigurohet edhe cilësia e naftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje, zoti kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Zonja e zotërinj, kolegë deputetë,

Ligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme tani po na kthehet sërish në debat parlamentar. Nga tërheqja e deri më sot nga vetë sponsoruesi nuk kemi parë ndonjë ndryshim, pos asaj që po e vazhdon debatin me disa dilema dhe opinione të ndryshe qoftë brenda komisionit, qoftë me sponsoruesin e këtij projektligji.

Ne jemi ata që duhet me përkushtim edhe një herë ta rilexojmë dhe përveç përkrahjes së sotshme në parim, me debatin e mëtutjeshëm i kemi parasysh ato sugjerime, të cilat na i kanë dhënë nga komuniteti i biznesit, por edhe nga vetë përvoja e eksperiencës jonë, e në mënyrë të veçantë nga politika, të cilat ne jemi zotuar se do t'i ndërtojmë si strategji e promovimit të ekonomisë së tregut të lirë.

Kjo nuk është vetëm një detyrim kushtetues yni, si deputetë dhe si qeveri, po ne në asnjë variant nuk guxojmë të lejojmë ato veprime apo propozime, të cilat në një shkallë të caktuar, përmes një ligji të këtillë mund të kufizojnë konkurrencën e lirë, mund të vendosin monopolin edhe mund t'u japin përparësi kompanive të cilat përshkruhen në ligj që mund të jenë të vetmet për importin apo shitjen e derivateve të naftës.

Mendoj që kjo nuk guxon të ndodhë, sepse në këtë mënyrë ligji në formën e sponsoruar mund t'i godasë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të kësaj veprimtarie, e që besoj nuk është politikë e askujt, sepse çdo ekonomist, çdo njeri që merret me jetën ekonomike të këtij vendi e di mirë që në sistemin e ekonomisë së tregut të lirë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë ato që e zhvillojnë vendin, ato që japin kontribut në të hyrat buxhetore të këtij vendi. Prandaj, me asnjë formë, asnjë model ne nuk guxojmë t'i cenojmë këto.

Unë besoj që nuk është synim as i sponsoruesit kjo, por kjo neve na detyron që ta përmirësojmë brenda debatit parlamentar. Kështu që subjektet importuese është normale që detyrohen të garantojnë cilësi, por kontrolli dhe mbikëqyrja e cilësisë duhet të bëhet në kufij, kontrolli dhe cilësia po ashtu nuk duhet të ketë monopol nga një operator i vetëm, por duhet të ketë edhe operatorë të tjerë, të cilët do të bëjnë kontrollimin e derivateve dhe karburanteve të tjera, në mënyrë që realisht me paketën e amendamenteve që do t'i vendosin brenda këtij projektligji ne të garantojmë, pra, edhe kontrollimin e cilësisë me më shumë operatorë, po edhe importi të jetë import i lirë, sepse i përgjigjet tregut të lirë dhe kjo do të mundësojë stimulimin e të gjitha ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat merren me këtë veprimtari që edhe më tutje të vazhdojnë të punohet, t'i mbajnë njerëzit në punë, të mos diktojmë ndonjë, të mos mbajmë ne gabime, për çka besoj që ne nuk do ta lejojmë.

Prandaj, duke e përkrahur në parim këtë projektligj unë besoj që në komision, po edhe të gjithë deputetët do të përkrahin ndryshimet, të cilat janë të dobishme aq më parë edhe një amendament që e kanë propozuar shoqatat dhe odat e biznesit në gjithë Kosovën, për aq sa unë kam marrë pjesë në të gjitha debatet, pra neni 5, pika 6, e cila duhet të ndryshohet e të jetë në pajtim me

propozimin e këtyre shoqatave, të cilën ne duhet ta përkrahim në komision, por edhe si deputet i këtij parlamenti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë pajtohem që ligji të aprovohet në parim, mirëpo me theks të veçantë në disa çështje të cilat i përmendën edhe parafolësit.

Përpos tjerash, isha ndalur edhe te cilësia edhe matja e cilësisë të derivateve të naftës.

Gjithsesi të insistojmë që ajo të bëhet edhe në pikat kufitare, përpos edhe në depo. Kem raste të hidhura në të kaluarën me mosmatjen dhe mospërcaktimin e cilësisë. Duke mos folur për dëmtimin e makinave në mënyrë individuale edhe në mënyrë kolektive, isha ndalur te rikujtimi i rastit të disulfitit të sulfurit atëherë kur patëm problem në vitin 2009 që përpos të gjitha atyre punëve që dolën për policinë, për TMK-në dhe për shumë aktorë, shtetit tonë i kushtoi edhe 150 mijë euro vetë metoda e shkatërrimit të asaj sasi të naftës edhe produkteve të naftës, e cila ishte shumë e dëmshme për shëndetin tonë dhe u detyruam të angazhojmë një kompani, e cila e barti atë sasi për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku atje u shkatërrua ajo sasi e derivateve të naftës dhe e benzinës me sasi shumë të lartë të disulfitit të sulfurit.

Për të mos ardhur në situata të tilla dhe të ngjashme, unë kisha insistuar që të theksohet në nen të veçantë që gjithsesi të bëhet kontrolli i cilësisë së naftës dhe derivateve të saj në pikat kufitare, por edhe në depot për to. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Edhe kjo mbetet për votim.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa

Edhe kjo është për votim, e lëmë për nesër në orën 10:00 në vazhdimësi.

Edhe pika 12 po në këtë variant.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015

Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj auditorin e përgjithshëm, Besnik Osmani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare për vitin 2015.

BESNIK OSMANI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

I nderuar ministër,

Kam kënaqësinë që të paraqes para jush raportin vjetor të auditimit për vitin fiskal 2015, raport të cilën tashmë ju e keni marrë.

Dëshiroj që fillimisht të shpreh falënderimin tim për besimin që më keni dhënë në mars të këtij viti, duke më zgjedhur auditorin e parë të përgjithshëm shtetas të Republikës së Kosovës. Ky fakt rrit edhe më shumë përgjegjësinë time.

Të nderuar deputetë,

Raporti që unë paraqes sot përfshin opinionin, gjetjet kryesore dhe rekomandimet për punën e kryer nga auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit për sezonin e auditimit 2015-2016.

Raporti përmbledh transaksionet në lidhje me të gjitha aktivitetet e institucioneve, me përjashtim të Bankës Qendrore, të Trustit Pensional të Kosovës, të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe të Radiotelevizionit të Kosovës.

Për të përfunduar këtë raport ne paraprakisht kemi audituar dhe publikuar 90 raporte të rregullsisë dhe 8 raporte të performansës.

Gjatë periudhës audituese kemi pasur përkrahjen nga institucionet supreme të auditimit të Britanisë së Madhe, të Suedisë, të Holandës, të cilët na kanë ndihmuar për të rritur sigurinë e procesin tonë të auditimit, në mënyrë që të jemi në pajtueshmëri me standarde ndërkombëtare të auditimit dhe me praktika të mira audituese.

Në bazë të rezultateve nga puna audituese na është mundësuar që të japim rekomandime për të promovuar qeverisjen e mirë dhe për të përmirësuar menaxhimin financiar.

Me këto raporte ne kemi dhënë 91 opinione për pasqyrat financiare, nga të cilat 30 opinione të pakualifikuara, 41 opinione të pakualifikuara, me theksim të çështjes, 6 opinione të kualifikuara me theksim të çështjes, 10 opinionet e kualifikuara dhe 4 opinione të kundërta.

Në këto raporte ne kemi vendosur 1 237 gjetje dhe kemi dhënë 1200 rekomandime për Qeverinë dhe institucionet lokale, nga të cilat 863 me prioritet të lartë të rrezikut.

Të nderuar deputetë,

Fillimisht unë do të dëshiroj të theksoj disa zhvillime të rëndësishme pozitive që janë evidentuar në vitin 2015 në raportimin financiar dhe në menaxhimin e parasë publike krahasuar me një vit paraprak, 2014.

Është evidentuar një performansë më e mirë buxhetore si rezultat i ndryshimeve të politikave fiskale, aplikimit të rritjes së normës së TVSH-së dhe akcizës për disa produkte të caktuara si dhe është evidentuar forcim i kontrollit në menaxhimin e të hyrave.

Po ashtu në raport të vitit 2014 janë rritur të hyrat për 16,6%. Rritja ishte rezultat i inkasimit më të lartë të tatimeve, financimi nga huamarrja dhe mbledhjes së të hyrave vetjake.

Gjatë vitit 2015 organizatat kanë treguar performansë më të mirë buxhetore në realizimin e pagesave, sepse kanë bërë uljen e obligimeve të papaguara në nivelin lokal.

Qeveria, po ashtu, kemi evidentuar se ka ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar regjistrin e pagesave nga palët e treta në sistemin informativ të menaxhimit të financave të Kosovës si dhe ka bërë prezantimin e drejtë të tyre, edhe pse ekzistojnë ende mospërputhje të plota.

Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë opinion të kualifikuar me theksim të çështjes në raportin vjetor financiar të buxhetit për vitin fiskal 2015. Kjo ka ndodhur për këto fakte: Qeveria e Kosovës fillimisht, e më pastaj Kuvendi i Kosovës, duke e miratuar buxhetin për vitin 2015 ka keqklasifikuar në shkallë vendi buxhetin për mallra dhe shërbime, subvencione, transfere në vlerë prej 23 milionë eurosh, duke i trajtuar ato si investime kapitale.

Po ashtu, 2 milionë euro të tjera janë keqklasifikuar nga organizatat buxhetore si pasojë e gabimeve dhe aplikimit jo të drejtë të sistemit kontabël, si dhe gjatë procesit të ekzekutimit buxhetor. Ne po ashtu kemi vendosur theksim të çështjes në raportin vjetor për vitin 2015, për shkak të shpalosjeve jo të plota për vlerat e pasakta të pasurive në regjistrimin mbi 1 mijë euro dhe për mosshpalosje të plotë të llogarive të arkëtueshme. Përveç opinionit të auditimit, ne kemi bërë një vlerësim të pajtueshmërisë së kufirit të deficitit buxhetor. Vlen për t'u theksuar se Qeveria kishte siguruar që deficitin e planifikuar të jetë brenda kufirit të lejuar me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Nga perspektiva audituese ne e nënvizojmë si shumë të rëndësishëm rezultatin që ka pasur Qeveria për ta mbajtur deficitin në shkallë vendi prej 1.3% të bruto produktit vendor për vitin 2015.

Të nderuar deputetë,

Në vijim, unë dëshiroj të prezantoj para jush edhe disa gjetje për fushat kryesore dhe që kërkojnë vëmendjen edhe të Kuvendit, edhe të Qeverisë, që kanë të bëjnë me prokurimin publik, me menaxhimin e burimeve njerëzore, me qeverisjen e mirë, menaxhimin e subvencioneve dhe me performansën në sektorë të caktuar. Por, po e filloj prokurimin.

Raportet individuale të auditimit për vitin 2015 kanë treguar se kemi mangësi të theksuar në menaxhim të prokurimit. Një numër procesesh të aplikuara nga organizatat buxhetore nuk janë në pajtim të plotë me kornizën e Ligjit për prokurimin publik. Në vitin 2015 institucionet publike kanë nënshkruar 11 mijë kontrata të prokurimit në vlerë mbi 400 milionë euro. Kjo vlerë e vë në pah rëndësinë e një kornize të prokurimit për të menaxhuar më mirë dhe për të siguruar maksimizimin e përfituesve nga taksapaguesit.

Çështjet kryesore të pajtueshmërisë që ne kemi hasur te sistemi i prokurimit janë me sa vijon: vërehet mungesë e kontrolleve për të siguruar procedurat e prokurimit të fillojnë me kohë, nuk është monitoruar implementimi i kontratave në baza kohore, nuk është bërë harmonizimi i kërkesave për rrjedhjen e parasë në fondet në dispozicion, janë bërë blerje pa procedura të prokurimit në mjaft raste kur kërkohen që ato të aplikohen. Janë shmangur procedurat e hapura të prokurimit dhe janë aplikuar procedura me kuotim çmimesh apo me vlerë minimale kur ato nuk janë të lejuara.

Qeveria e Kosovës e ka filluar projektin e prokurimit elektronik, i cili ka për qëllim përmirësimin e vendimmarrjes dhe transparencës. Ne kemi vlerësuar si shumë të dobishëm këtë projekt dhe presim që ai të bëhet sa më shpejt plotësisht operacional, përfshirë ngritjen e kapaciteteve menaxheriale, njerëzore, teknike për agjencitë përgjegjëse qeveritare. Ne mendojmë se ky sistem mund të ndihmojë në evitimin e mangësive që unë i cekta më lart. Sa i përket menaxhimit të personelit në nivel të organizatave buxhetore janë disa parregullsi që mund të përmbliken me sa vijon: kemi mbulim të pozitave drejtuese me ushtrues detyre përtej afateve të përcaktuara me kornizë ligjore. Kemi lidhje të kontratave të shumta për shërbimet e veçanta pa procedurë të rekrutimit, pa i siguruar burimet e financimit të qëndrueshëm dhe, në disa raste, pa e ditur qartë qëllimet e rekrutimit për këto pozita.

Ne kemi evidentuar se 1 mijë e 300 të punësuar punojnë në këto kategori dhe që përbën 1.65% nga totaliteti i punësuarve publikë në Republikën e Kosovës, prej 78 mijë e 381 personave, sa kanë qenë të punësuar në vitin 2015. Në fushën e qeverisjes së mirë kemi evidentuar zhvillime pozitive, megjithatë iniciativat që ka ndërmarrë Qeveria ende nuk janë plotësisht efektive. Qeveria ka zhvilluar një sistem vetëvlerësues, i cili përbën bazë për monitorimin e zhvillimeve në qeverisje. Gjetjet tona theksojnë nevojën për një rritje të konsiderueshme të fokusit në disa çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen nga ana e menaxherëve të mesëm të sektorit publik.

Qeveria duhet të vazhdojë me ofrimin e trajnimeve shtesë për këta menaxherë, për përdorimin e pyetësorit dhe vlerësimet për të zhvilluar një proces që rrit potencialin e tyre në zhvillimin e qeverisjes së mirë. Njësitë e auditimit të brendshëm dhe komitetit të auditimit të brendshëm kanë një rol kyç në këtë rast. Megjithatë, rreth 30% të njësive të auditimit të brendshëm në nivel të organizatave në Republikën e Kosovës nuk e kanë numrin e mjaftueshëm të stafit. Në nëntë organizata buxhetore nuk janë themeluar fare njësitë e auditimit të brendshëm.

20% e organizatave buxhetore nuk kanë themeluar komitete të auditimit. 54% të rekomandimeve të auditorëve të brendshëm janë implementuar plotësisht, ndërsa rreth 46% janë në proces apo nuk janë trajtuar fare nga ana e menaxhmentit të organizatave buxhetore.

Menaxhimin e subvencioneve në nivelin qendror, edhe ashtu në nivelin lokal mbetet sfida. Praktika aktuale e vlerësimit, monitorimit, raportimit të subvencioneve nuk ofron siguri të mjaftueshme që këto fonde janë duke u shfrytëzuar për qëllime të dedikuara. Prandaj, ne mirëpresim iniciativën e Qeverisë që të ndërmarrë veprime për përgatitjen dhe aplikimin e një rregulloreje në nivel vendi për menaxhimin e subvencioneve, në mënyrë që të arrijmë një proces më efektiv dhe më transparent.

Përveç auditimeve të rregullsisë, ne si zyrë për çdo vit realizojmë edhe një numër të auditimeve të performansës. Këto auditime kanë për qëllim të vlerësojnë ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektshmërinë me të cilat një institucion i përdor burimet gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet. Megjithatë, ka pasur përpjekje nga institucionet për të vendosur një organizim të strukturuar mbi bazën ligjore. Auditimet tona me gjithë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zgjatja edhe pak derisa ta përfundojë.

BESNIK OSMANI: Mendova që s'po u nënshtrohem rregullave të deputetëve. Megjithatë, unë dëshiroj, pra, që të vendos edhe dy çështje të rëndësishme: përmbushja e zbatimeve nga blerësit e ndërmarrjes shoqërore për investimet brenda periudhës së zotuar ka qenë mbi 70%, derisa zotimet për punësim janë realizuar në 96%. Është vlerësuar mungesë efikasitetit në procesin e planifikimit dhe shpërndarjes së kthimit të teksteve shkollore. Një menaxhim më i mirë i këtyre do të kursente dhe do të krijonte kursime të rëndësishme në buxhetin e Kosovës, duke ofruar të njëjtat libra për nxënësit tonë.

Për të gjitha këto auditime dhe entitete përkatëse të gjitha institucionet kanë pranuar raportet, si dhe udhëzimet për përmirësimet e tyre. Në fund, unë dëshiroj që të falënderoj Komisionin për Mbikëqyrjen Financiare për bashkëpunimin konstruktiv, të gjitha organizatat buxhetore që kanë qenë subjekt i auditimit, në mënyrë të veçantë Ministrinë e Financave, me të cilët kemi relacione

më të gjata të komunikimit dhe krejt në fund, duke falënderuar stafin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Përgjithshëm, të cilët kanë qenë në gjendje që para jush të sjellin këto 98 raporte, të sjellin raportin përfundimtar. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesit të Komisionit Funkcional, zoti Topalli, nuk është këtu. Atëherë, kush e ka fjalën në emër të Komisionit Funkcional, zoti Muhamet Mustafa është paraqitur, zonja Hadërgjonaj. A po vazhdojmë me zonjën Hadërgjonaj, pastaj zoti Mustafa.

Abdyl Ymeri, më fal. S'je paraqitur, o Abdyl, më herët. Shtype!

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti në tërësinë e tij përmban të gjitha elementet thelbësore të auditimit të fondeve publike, si dhe menaxhimin e këtyre fondeve. Të gjitha gjetjet e theksuara dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport nga auditorët e Zyrës Kombëtare për Auditimit kanë për qëllim që organizatat buxhetore të rrisin transparencën, llogaridhënien në shpenzimin e parasë publike, si dhe në përmirësimin e qeverisjes, ngritjen e performansës dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Edhe pse kemi disa zhvillime pozitive në raportimin financiar për vitin 2015, duke përfshirë rritjen e realizimit dhe të hyrave nga tatimet, financimi nga huamarrja e brendshme, si dhe performansat e mira buxhetore në realizimin e pagesave, ende ka hapësirë për t'u përmirësuar raportimi financiar nga organizatat buxhetore në fushat e caktuara, sidomos në klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve si investime kapitale.

Përderisa kemi përmirësime në disa çështje, ende nuk janë arritur objektivat derisa kemi një opinion të kualifikuar me theksim të çështjeve, sepse me 90 auditime të rregullsisë dhe 8 auditime të performansës në raport shihet se kemi keqklasifikim të buxhetit, bartja e mjeteve nga një kod buxhetor në tjetrin është si rezultat i mosplanifikimit të mirë, sepse pothuajse në të gjitha organizatat buxhetore kemi një planifikim dhe realizim të buxhetit në mënyrë jo të kënaqshme.

Po që se shikohet struktura e buxhetit të organizatave buxhetore, se si është planifikuar rrjedhja e parasë dhe realizimi, shihet se kemi një keqklasifikim për shkak të buxhetimit jo të drejtë të shpenzimeve. Vlera prej 25 milionë e 300 e 7 mijë e 551 euro, e keqklasifikuar, është e madhe, prandaj këtu duhet të merren shumë seriozisht opinionet dhe rekomandimet e auditorëve, me qëllim të përmirësimit dhe shpenzimit të drejtë të parasë publike.

Edhe në realizimin e buxhetit për paga dhe mëdijtje, i cili është realizuar 98%, auditorët kanë gjetur një varg gjetjesh, duke filluar nga mbulimi i pozitive me ushtrues detyre, lidhja e kontratave të veçanta 1 mijë e 029, gabimi në kalkulimin e kompensimeve për punë dhe jashtë orari, mospërputhja e titujve të punës në mes të aktemërimeve dhe listës së pagave, po ashtu buxheti për investime kapitale është realizuar 84%. Por, ajo që shihet dhe vërehet në raport, 35% e buxhetit për investime kapitale është realizuar në pjesën e fundit të vitit, domethënë në muajt nëntor dhe dhjetor.

Edhe këtu organizatat buxhetore duhet të shpenzojnë buxhetin sipas dinamikës së paraparë dhe jo në fund të vitit, sepse volumi i lartë i pagesave në fund të vitit rrit rrezikun për realizim të pagesave të parregullta dhe për blerje të panevojshme. Gjithashtu, në raport shihet se pas mbylljes së afatit për pagesa në fund të dhjetorit janë ekzekutuar me vendim të ministrit të Financave 37 milionë e 533 mijë e 272 euro, apo 9% e buxhetit për investime kapitale. Automjetet zyrtare nuk mbajnë shënime për përdorimin e tyre pas orarit zyrtar, nuk ka raportim për sasinë e karburanteve të shpenzuara dhe numrin e kilometrave të kaluara, pastaj servisi dhe mirëmbajtja e automjeteve.

Sa i përket rekomandimeve, po qe se shikohet tabela 8, e cila është për vitin 2014, në të cilin janë 1 mijë e 177 rekomandime, 418 janë pjesërisht të adresuara, 356 plotësisht të adresuara dhe 403 të paadresuara. Duke shikuar numrin e rekomandimeve dhe sa janë implementuar, shihet se 403 rekomandime nuk janë adresuar fare, si dhe 418 të adresuara pjesërisht. Atëherë, kjo çështje duhet të trajtohet me prioritet, me qëllim që organizatat buxhetore të përmbushin rekomandimet e dhëna nga auditorët e përgjithshëm. Sepse, rekomandimet e auditimit të auditorëve janë të fokusuara drejt përmirësimit të kualitetit në raportimin financiar të jashtëm, menaxhimin financiar të shtuar dhe përmirësimin në shërbimet publike.

Mosimplementimi i rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit është një çështje shqetësuese gjithashtu, derisa në vitin e kaluar kishim diku 33% të rekomandimeve të dhëna, ishin adresuar plotësisht, në këtë vit kemi, do të thotë, 30%. Do të thotë kemi një rënie të implementimit të rekomandimeve. Sa i përket prokurimit institucionet publike kanë nënshkruar 10 mijë e 895 kontrata përmes prokurimit në vlerë prej 402 milionë eurosh. Mirëpo, raportet individuale të rregullsisë të auditorëve vënë në pah se zbatimi i kornizës ligjore të prokurimit ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, pasi që janë identifikuar dobësi, duke filluar nga planifikimi i prokurimit, aplikimi i kërkesave të prokurimit deri te menaxhimi i kontratave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministër i Financave,

Të nderuar deputetë,

Menaxhimi i shëndoshë i financave publike do të thotë ruajtja e një pozicioni të qëndrueshëm fiskal, duke bërë shfrytëzimin e burimeve financiare për investime kapitale në mënyrë efikase dhe shpenzimin për mallra dhe shërbime në mënyrë efektive. Shtrohet pyetja: a po ndodh kjo në Kosovë?

Nëse analizojmë me kujdes raportin vjetor të auditorit për vitin 2015 vërejmë se nuk jemi në rrugën e duhur për të rivendosur financat publike të shëndosha dhe të qëndrueshme. Vetë fakti që nga Zyra Kombëtare e Auditimit është dhënë opinion i kualifikuar që do të thotë është dhënë opinion i keq për raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe atë me theksim të çështjes për shkak të moskonsolidimit të pasqyrave individuale financiare dhe mospalosjes adekuate të informatave sa i përket shënimeve shpjeguese, tregon se institucionet po përballen me sfida të mëdha menaxheriale dhe janë ende larg objektivave të vendosura për transparencën dhe llogaridhënien, për mënyrën se si shpenzohen paratë publike dhe se ato shkojnë në interes të qytetarit, si dhe larg arritjes së synimeve për një stabilitet dhe qëndrueshmëri ekonomike.

Është e domosdoshme që Ministria e Financave, institucionet e tjera qendrore dhe lokale, pra ministritë dhe komunat, si dhe institucionet e pavarura të audituara gjatë vitit 2015 të adresojnë rekomandimet nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në mënyrë që të ngritin dhe të konsolidojnë sistemin e menaxhimit financiar, të rrisin përgjegjshmërinë, transparencën dhe qëndrueshmërinë afatgjate të financave publike nëse synojmë integrimin evropian.

Të nderuar deputetë,

Dështimi në planifikim është, në fakt, planifikim i dështimit. E them këtë bazuar në faktin, se bazë për opinion të kualifikuar ishte klasifikimi si investime kapitale i shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe subvencioneve e transfere në vlerë prej 23 milionë e 307 mijë e 551 euro. Si pasojë e buxhetimit jo të drejtë nga Ministria e Financave, si dhe gabimeve dhe aplikimit jo të drejtë të planit kontabël nga organizatat buxhetore.

Raporti i auditorit konstaton se pasqyra e realizimit të buxhetit përmban gabime. Duke bërë nënvlerësimin e të hyrave tatimore, nënvlerësimin e buxhetit nga huamarrja, si dhe nënvlerësimin nga realizimi i pranimeve nga donacionet, depozitat dhe kthimet e huas për ndërmarrjet publike për 141 milionë e 895 mijë euro. Rrjedha dalëse e parasë, buxheti final për donacione është nënvlerësuar për 19 milionë e 870 mijë euro, pagesat nga donacionet dhe kthimi i depozitave janë nënvlerësuar për 16 milionë e 354 mijë euro. Këto nënvlerësime janë shqetësuese të ndodhin në buxhet, kur pretendojmë përgjegjësi dhe llogaridhënie për paratë publike. Ajo që shqetëson në këtë raport është planifikimi i investimeve publike të paqëndrueshme në sektorin publik, shpërndarja jo e mirë e investimeve që mbetet sfida edhe në

të ardhmen sa i përket realizimit të projekteve kapitale të planifikuara përmes të cilave përfitojnë taksapaguesit dhe bizneset nga përmirësimi i infrastrukturës dhe projekteve të tjera që ua lehtësojnë jetën dhe punën qytetarëve dhe bizneseve në vend.

Mungesa e mjeteve për financimin e këtyre projekteve kapitale ka bërë që organizatat buxhetore të hyjnë në obligime. Vonesa e pagesës së obligimeve ka shkaktuar efekte negative në menaxhimin e buxhetit dhe ka shkaktuar pamundësinë e arritjes së objektivave të planifikuara, por edhe ka dëmtuar bizneset si punëkryerës. Obligimet e papaguara të organizatave buxhetore në fund të vitit, sipas raportit, janë 207 milionë e 262 mijë euro. Rritja e këtyre obligimeve krahasuar me vitin 2014 është bërë për 14 milionë e 874 mijë euro.

Prandaj, duhet të kemi kujdes në këtë drejtim. Pagesat e bëra përmes gjykatave punëkryerësit kërkojnë t'u përmbushen obligimet e tyre për punët e përfunduara, e dëmtojnë biznesin, e dëmtojnë buxhetin, ngarkojnë buxhetin për vitin e ardhshëm dhe vështirësojnë realizimin e projekteve kapitale të planifikuara për vitet e tjera, sepse duhet të bëhen shkurtime buxhetore në projekte kapitale, siç ka ndodhur gjatë rishikimit të buxhetit të këtij viti, ku është penguar dukshëm arritja e objektivave të planifikuara, sidomos të investimet kapitale.

Nëse e analizojmë raportin, vërejmë edhe mosrealizimin e projekteve që janë planifikuar të financohen nga huamarrja. Po ndalem vetëm te huamarrja e jashtme, pa e diskutuar huamarrjen e brendshme. Vlera e planifikuar e huamarrjes së jashtme është paraparë 107 milionë euro, ku janë paraparë realizimi i projekteve të rëndësishme që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore, me infrastrukturën hekurudhore, në shëndetësi, në trajtimin e ujërave, e të tjera.

Realizimi i kësaj huaje është bërë vetëm për 45 milionë eurove nga ajo që është planifikuar, por më e keqja është që shpenzimi është bërë vetëm 6 milionë e 750 mijë euro. Ka një ngecje të dukshme në realizimin e projekteve kapitale ku përfitojnë qytetarët dhe e keqja e huamarrjes së tillë është se fillojmë të kthejmë huan pa përfituar qytetarët për projekte në interes të tyre dhe ngarkohen gjeneratat të paguajnë mospunën tonë.

Menaxhimi i keq i prokurimit publik, shkeljet në procedurat e prokurimit, mosmonitorimi i kontratave për investime kapitale, shkelja e procedurave të personelit, shpenzimi joefikas i mjeteve për mallra dhe shërbime, e shumë shkelje të tjera, të cilat i theksoi këtu vetë auditori i përgjithshëm, janë mesazh shumë i qartë për Qeverinë të reflektojë në menaxhimin e financave publike apo të parasë publike.

Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit ka evidentuar edhe shumë shkelje të rregullativës ligjore dhe nga komunat, mosevidentimi i pasurisë nga ana e komunave po përcillet nga viti në vit. Keqklasifikimi i investimeve kapitale, keqmenaxhimi i subvencioneve e shumë çështje të tjera e kanë bërë që opinionin të jetë opinion i kualifikuar për shpenzimet publike. Komunat, sipas

raportit, nuk i kanë të përcaktuara objektivat strategjike, nuk kanë të llogaritura kostot financiare, që kanë të bëjnë me këto strategji dhe janë evidentuar edhe shumë shkelje të tjera.

Mënyra se si Qeveria menaxhon buxhetin sot do të ketë efekte të thella në vitet e ardhshme. Qeveria duhet të rikthejë besimin e qytetarëve në institucionet, të cilat ata i kanë formuar dhe i mbajnë me taksat e tyre. Për të rikthyer besimin duhet domosdoshmërisht të kemi një menaxhim efikas të financave publike, duhet të kemi përgjegjësi dhe llogaridhënie për paratë publike. Ky raport i Zyrës Kombëtare të Auditimit na mbush përgjegjësi që të fillohet me një reformë në sistemin dhe në menaxhimin e financave publike nëse duam të orientojmë vendin tonë drejt Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dëshiroj të falënderoj auditorin e përgjithshëm për një raport shumë cilësor dhe për fjalën e tij këtu para nesh, e cila pasqyroi aktivitetet, të cilat domethënë edhe pas kalimit të Zyrës së Auditorit në menaxhim nga vendorët tregojnë një ngritje cilësore dhe kjo është një çështje që ne duhet ta konstatojmë sot. Aktiviteti i auditorit ka shënuar një ngritje, edhe përkundër ndryshimeve, të cilat janë bërë aty edhe në pikëpamje të prezantimit dhe cilësisë së prezantimit, por edhe në pikëpamje të rekomandimeve dhe konstatimeve, të cilat janë profesionale dhe cilësore.

Unë dëshiroj këtu dy çështje të ndaj me juve, së pari: vazhdimisht kemi problem me prokurimin, edhe pse nuk kemi pasur probleme të dukshme, domethënë në formë të aferave. Unë mendoj se auditori me të drejtë e theksoi një çështje të monitorimit të zbatimit të kontratave të prokurimit. Thashë, kur kemi transparencë lidhur me zgjedhjen e operatorit, i cili ofron çmimin më të volitshëm, është shumë vështirë të bëhen probleme dhe të zgjidhet një operator me çmim më të lartë.

Domethënë, është tejkaluar ajo fazë, tash problemet më të mëdha janë që kur zgjidhet operatori me çmim më të ulët, aty ka problem në zbatim të kontratës, qoftë në sasi, qoftë në cilësi, qoftë në specifikime. Prandaj, për ta rregulluar plotësisht fushën e prokurimeve publike esenciale është që të kontrollohen specifikimet dhe të kontrollohet e të monitorohet zbatimi i kontratave. Nëse këto dy çështje i rregullojmë, unë mendoj që do të bëhet një avancim i dukshëm në përmirësimin e cilësisë së prokurimit publik.

Prandaj, edhe auditori, por edhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, i cili e ka për funksion që të monitorojë zbatimin e kontratave, duhet t'i shtojnë aktivitetet në këtë drejtim të kontrollit të zbatimit të kontratave për prokurim. Kjo është e para.

E dyta, thënë të drejtën, unë u befasova pak nga fakti se në raportet e auditorit nuk është përfshirë RTK-ja. Duke marrë parasysh që RTK-ja shfrytëzon mjetet e buxhetit, pa marrë parasysh që është ndërmarrje publike, çdo agjenci që shfrytëzon mjetet të buxhetit do të duhej të përfshihet në auditimet e auditorit gjeneral, ajo është përgjegjësi e tij. Prandaj, në të ardhmen ne kërkojmë përderisa RTK-ja do të financohet nga buxheti i Kosovës, ne kërkojmë, unë mendoj që duhet të jetë plotësisht e qartë që RTK-ja duhet të auditohet edhe në pikëpamje të rregullsisë, edhe në pikëpamje të performansës. Kjo është esenciale më duket, dhe është kërkesë ligjore, me ligj duhet të bëhet. Unë nuk e di qysh ka ndodhur deri tash të mos bëhen këto kontrolle. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është për t'u përshëndetur dhe respektuar puna e auditorit të përgjithshëm me një raport real për auditimin e performansës, të cilin e ka sjellë në Kuvend dhe ne duhet të debatojmë. Nëse nisemi nga fakti se auditimi ka për qëllim të ndihmojë Kuvendin e Kosovës të kërkojë llogaridhënie nga organizatat buxhetore qeveritare dhe institucionet e pavarura për mënyrën se si shpenzohen paratë publike, të ndihmojnë asamblatë komunale dhe qytetarët që të kërkojnë llogaridhënie nga komunat, se si i shpenzojnë paratë publike. Si dhe, të ndihmojnë organizatat qendrore dhe lokale në përmirësimin e menaxhimit të financave publike të qeverisjes së mirë dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Institucioneve të vendit u mungon një çështje mjaft esenciale që ka të bëjë me memorien institucionale, qoftë atë të përgjithshëm, në nivel institucional, po atë edhe individuale apo sipas organizatës buxhetore.

Kur e them këtë kam parasysh një fakt, se nga çdo projekt që duhet të shkojë sipas ligjit, duhet t'iu nënshtrohet procedurave, qytetarët duhet ta dinë kostefektivitetin e atij projekti dhe përfitimet e tyre direkte nga projekte në fjalë. Qytetarët duhet të dinë se sa po realizohet puna e tyre dhe sa po bëhen pagesat me të vetmin qëllim që të eliminohen tejkalimet e kompetencave në shpërblimin për punën e kryer të organizatave fituese.

Çështja tjetër që unë mendoj që duhet të dalë dhe të ketë vëmendje nga institucionet, po që se diskutohet me menaxherët nëpër institucione, vërehet se mungon komunikimi horizontal dhe vertikal dhe brenda të të njëjtit institucion për projekte madhore, ku kërkohen investime të

mëdha, vetë zyrtarët e institucioneve nuk kanë informacionet e duhura për çështje të caktuara menaxheriale sa i përket menaxhimit financave publike, apo projekteve të caktuara të cilat kryhen nga ana e institucioneve.

Kemi një administratë publike të stërngarkuar, kështu së paku janë të gjitha raportet vendore dhe ndërkombëtare dhe më habit fakti se si 30 organizata buxhetore nuk kanë staf të mjaftueshëm për auditimin e brendshëm. A thua, si ndodh, kemi ngarkim dhe, në anën tjetër, një zyrë për auditim të brendshëm nuk ka staf të mjaftueshëm. Kjo nënkupton se institucionet nuk po bëjnë menaxhimin e duhur dhe angazhimin e duhur sipas kërkesave ligjore të stafit në administratë.

Si është e pranueshme nga institucionet, nga ekzekutivi, që 9 organizata buxhetore janë pa auditorë të brendshëm, kur të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të kenë auditorin e brendshëm dhe numrin e stafit të angazhuar në proporcion me madhësinë e organizatës. Ajo çka më shqetëson më së tepërmi nuk e kemi fillimin e udhëheqjes nëpër institucione, por kemi fituar mjaft përvojë, kemi dije dhe kemi resurse. Pse edhe për vitin 2015 vazhdojmë me të njëjtën vërejtje, pse fillimi i procedurave nuk bëhet me kohë. A kemi probleme ligjore apo kemi probleme menaxheriale? Këto duhet të identifikohen. Për të gjitha këto çështje secila organizatë, mendoj unë, publikisht duhet t'i tregojë arsyet, të mos mbeten këto vetëm organizata me organizatë, institucioni me institucion, në kuptimin e kompetencave mbikëqyrëse. Por, duhet të gjithë ta dimë pse ende, edhe viti 2015 përfundon, e ndoshta do të jetë edhe 2016, vitin e ardhshëm kur ta shqyrtojmë raportin, me vonesa në fillim të procedurave. Çdo vonesë ka pasojat e veta, qoftë në aspektin e menaxhimit të buxhetit, qoftë në aspektin e menaxhimit të projektit për punët e realizuara, qoftë në aspektin e përfitimit të shërbimit qytetar.

Andaj, mendoj se me qëllim që të kemi transparencë të plotë dhe qytetarët të dinë se kah po shkojnë financat e tyre publike, të dinë për secilin projekt se cili është përfitimi i qytetarit, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekt dhe kjo të jetë transparente në ueb-faqet e çdo organizate buxhetore.

Çështja tjetër që më shqetëson janë subvencionet. Subvencionet nuk guxojnë as të ndahen e as të shpenzohen pa pasur një plan transparent dhe paraprakisht të përgatitur, që krahas planit të ndahen edhe mjetet për subvencione. Nuk mund të tolerojmë edhe më tutje të vazhdohet që të kemi mjete bllok pa e ditur për çka, pa pasur adresë se ku do të shfrytëzohen ato.

Për të mos e zgjatur më shumë, unë edhe një herë e falënderoj Zyrën e Auditorit dhe auditorin për një raport të punës shumë real dhe transparent. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Hoti, urdhëroni!

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni fillimisht të përgëzoj auditorin e përgjithshëm për punën që ka bërë në auditimin e buxhetit të Kosovës për vitin 2015 dhe të gjitha organizatave buxhetore. Me kujdes e kemi analizuar raportin vjetor të auditorit dhe i kemi parë konkluzionet dhe rekomandimet që ka nxjerrë dhe vlerësojmë punën që ka bërë.

Nga raporti i auditorit shihet se gjatë vitit 2015 janë kryer 91 auditime dhe janë dhënë 91 opinione të ndryshme për pasqyrat financiare, prej të cilave 30 janë të pamodifikuara, ndërkaq 41 janë të pamodifikuara me theksim të çështjes, që ka praktikisht një rritje nëse i marrim këto dy vlerësime, prej 9,23% krahasuar me vitin 2014. Pra, mund të themi se ka një përmirësim në menaxhimin financiar në nivel vendi, kur merren komplet organizatat buxhetore.

Opinionin e përgjithshëm në raportin vjetor financiar të buxhetit të Kosovës për vitin 2015 është opinion i kualifikuar “me theksim të çështjes”. Ajo që e ka bërë këtë raport “me theksim të çështjes”, siç e theksoi auditori i jashtëm, është klasifikimi joadekuat i disa shpenzimeve kapitale, që kryesisht kanë të bëjnë me blerjen e librave dhe 2-3 shpenzime të tjera, që për mua si ministër i Financave, normalisht duhet të rregullohen në të ardhmen, por që nuk janë shqetësuese në kuptimin e menaxhimit financiar të mjeteve publike.

Unë vlerësoj gjetjet e auditorit të rritja e të hyrave dhe tek disiplina financiare, në veçanti sa i përket deficitit buxhetor, i cili edhe pse ka qenë i paraparë 2%, është përmbyllur viti me 1,3% krahasuar me 2,59%, sa ka qenë në vitin 2014. Në veçanti e vlerësoj qëndrimin e auditorit për efektin e politikave fiskale në vend që janë ndërmarrë gjatë vitit të kaluar.

Ne kemi përgatitur tanimë një plan detal për adresimin e rekomandimeve të auditorit. Unë dëshiroj të përmend disa prej tyre, për shembull, strategjia për kontrollin e brendshëm të financave publike, që është aprovuar në Qeveri dhe ligji që sot kaloi në lexim të parë është në funksion të adresimit të shumë rekomandimeve që ka dhënë auditori i përgjithshëm.

Kemi përgatitur programin kombëtar të kualifikimit të auditorëve të brendshëm dhe tani jemi në proces të finalizimit të certifikimit të grupit të parë të auditorëve të brendshëm për të krijuar kapacitetet, në mënyrë që të gjitha organizatat buxhetore të kenë auditorë të brendshëm, sepse kemi vetëm rreth 60-65 auditorë të brendshëm të licencuar, ndërkohë që nevojat janë shumë më të mëdha.

Kjo do të na mundësojë që organizatat buxhetore brenda dy vjetëve të plotësojnë nevojat sa i përket auditimit të brendshëm. Kemi bërë progres në rishikimin e pyetësorëve vetëvlerësues edhe vitin e kaluar dhe këtë vit dhe unë besoj se në raportin e ardhshëm ne do të kemi mundësi që të

raportojmë më në detaje për proceset brenda organizatave buxhetore, duke involvuar vetë zyrtarët e lartë të këtyre organizatave.

Kemi filluar me përshkrimin e proceseve detale si mostër në katër organizata buxhetore: në Ministri të Financave, në Ministri të Zhvillimit Ekonomik në Fushë-Kosovës dhe në Podujevë dhe tani janë përgatitur librat për procese buxhetore prej A deri në ZH, që u ndihmojnë zyrtarëve kryesorë administrativë dhe financiarë për menaxhimin e të gjitha këtyre proceseve dhe kemi organizuar shumë trajnime për zyrtarë përgjegjës për sa i përket menaxhimit të financave publike.

Është një varg reformash, që besoj se i adresojnë drejtpërdrejt gjetjet e auditorit dhe nuk ka vend për shqetësime, të cilat u prezantuan nga disa prej deputetëve këtu në Kuvend. Për shembull, prokurimi elektronik, që ka filluar të zbatohet nga data 1 shtator për organizatat qendrore dhe nga 1 janari i vitit të ardhshëm për nivelin komunal, e përmbyll komplet dhe maksimizon transparencën të çështja e prokurimit publik. Me Ligjin e ri të prokurimit që është miratuar me amendamentet në fillim të këtij viti kemi hequr mundësinë për kuotim të çmimeve që ka ekzistuar më përpara dhe këto vërejtje të auditorëve, unë besoj se nuk do të kenë vend më tutje në raportet e ardhshme.

Sa i përket disiplinës financiare, mund të keni vërejtje sa të doni, por janë raporte ndërkombëtare që kanë vlerësuar lart disiplinën financiare të kësaj Qeverie në dy vjetët e fundit. Është programi i Fondit Monetar Ndërkombëtar që në mënyrë strikte i parasheh shpenzimet dhe të hyrat se si i menaxhojmë në baza të rregullta. Është raporti i Komisionit Evropian që me gjithë vërejtjet, nxjerr në pah disiplinën financiare dhe është raporti ndërkombëtar i Departamentit të Shtetit që i ka dhënë vlerësim Kosovës sa i përket disiplinës financiare, në nivel global. Ne tani kemi vendosur një praktikë, përfundimisht një praktikë të qartë sa i përket aprovimit të çfarëdo strategjie të ligjit, rregulloreve, udhëzimeve administrative. Asnjë prej këtyre nuk kalon po qe se nuk është e kostuar plotësisht në buxhet, ose e paraparë në tre vjetët e ardhshme në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Dhe, kjo besoj se e parandalon rritjen e borxheve për vitet e ardhshme dhe për gjeneratat e ardhshme.

Sa i përket menaxhimit të borxhit publik dhe të huave, ky është shqetësimi më i vogël që ka kjo Qeveri. Me një borxh publik që nuk kalon, nuk shkon tek 14%, nuk është asnjë barrë për gjeneratat e ardhshme, përkundrazi. Krahasoni vendet e tjera sa janë. Dinamika e rritjes së borxhit publik është më e vogël se sa në Qeverinë e kaluar dhe ne arrijmë një rritje prej 4% të bruto prodhimit vendor dhe rritje vjetore të borxhit publik në më pak se 2% arrijmë që në baza vjetore të mos e rrisim borxhin publik më shumë se 1,5 - 1,7% të GDP-së.

Tek subvencionet, mendoj se ka një keqkuptim këtu, janë subvencionet kryesisht, sepse të gjitha mjetet që janë në Ministrinë e Punës klasifikohen si subvencione. Subvencione janë edhe 50

milione euro në bujqësi dhe janë subvencione nëpër ministri, që janë shuma shumë simbolike. Në bujqësi subvencionet ndahen në bazë të programit vjetor për mbështetje të bujqësisë, rreth 22-23 milionë euro dhe pjesa tjetër janë grande, pjesa tjetër janë tek Ministria e Punës nëpër skema të ndryshme sociale dhe pensionale.

Ne jemi duke punuar tani, me mbështetje edhe të Komisionit Evropian, një rregullore të re për menaxhimin e subvencioneve që i paraqet, i definon kushtet dhe kriteret në bazë të të cilave organizata buxhetore mund të ndajë subvencione sipas diskrecionit që kanë organizatat buxhetore.

Unë falënderoj edhe një herë auditorin e përgjithshëm për raportin dhe për rekomandimet që ka dhënë. Unë shpejt, në cilësinë e ministrit të Financave do të prezantoj në Qeveri një plan detal për adresimin e rekomandimeve, me përgjegjësit respektivë nëpër institucionet përkatëse dhe pastaj besoj që në raportin e ardhshëm nuk do të gjejmë vend edhe këto vërejtje, që më shumë janë të natyrës teknike.

Një gjë dua të theksoj, shqetësuese janë për juve si deputetë dhe për Qeverinë keqpërdorimet materiale, të cilat në këtë raport gati se pothuajse nuk ka fare. Ka nevojë vazhdimisht për avancim të procesit, të cilën gjë jemi duke e bërë. Raporti është për vitin 2015. Në vitin 2015 kanë filluar reformat në disiplinën fiskale, në politikat fiskale, në prokurimin elektronik dhe do të shihni se si do dalë raporti për vitin 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka kërkuar zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë shpreha shqetësimin tim lidhur me huamarrjen, për arsye se buxheti i këtij viti është shtuar në 2 miliardë e më shumë. Ky shtim i buxhetit është bërë në bazë të huamarrjes. Unë nuk e di se si është realizuar huamarrja për vitin 2016, mirëpo huamarrja për vitin 2015 nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit po shihet se është planifikuar 107 milionë, kurse janë realizuar 45 milionë euro nga kjo hua. Dhe, e keqja është që nga këto 45 milionë euro që janë realizuar në projekte kapitale janë shpenzuar vetëm 6 750 000 euro. Domethënë, shpenzimi ka qenë i vogël, çka do të thotë që projektet kapitale nuk janë realizuar ashtu siç janë planifikuar. E keqja është se mosrealizimi i këtyre projekteve kapitale reflekton te mirëqenia e qytetarit. Ne fillojmë të kthejmë borxhet, sepse do të na kalojë ajo “greis periudha”, që e kemi të paraparë me marrëveshjet që i kemi të nënshkruara, fillojmë ta kthejmë borxhin, e në fakt nuk i kemi të realizuara investimet kapitale, ku do të përfitonin qytetarët. Kjo ishte çështja të cilën unë e ngrita dhe të cilën e pashë në raportin e auditorit të përgjithshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Nuk e pata në plan të diskutoj, edhe pse raportin e auditorit e kemi lexuar me vëmendje, por fjala e ministrit të Financave më detyroi, sepse na krijoi përshtypjen se ky është një raport dhe një raportim i auditorit të përgjithshëm për Ministrinë e Financave e jo për deputetët e Kuvendit.

Unë, edhe pse ministri i Financave duket se shkoi, kërkoj nga ai që gjetjet që auditori i ka gjetur t'i eliminojë në të ardhmen, të mos vijë të na mbajë këtu "vajz" për atë që do të bëjë në të ardhmen, por le t'i eliminojë gjetjet e auditorit, sepse ky është një raportim i auditorit të përgjithshëm para deputetëve dhe jo para ministrit të Financave. Ministri i Financave e ka për obligim dhe detyrë ligjore dhe kushtetuese që t'i respektojë vendimet dhe gjetjet e auditorit dhe ato t'i eliminojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për të diskutuar, vlen si për pikat pararendëse.

15. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj zotin Naser Osmani, në cilësinë e kryetarit të Komisionit FunkSIONAL, që ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015 sipas të dhënave të kërkuara. Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhëna për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimin me vitin paraprak.

Buxheti i ndarë për vitin 2015 për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm ka qenë 2 212 516 euro. Pas rishikimit dhe vendimit të Qeverisë, buxheti ka qenë 2 160 305 euro, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë 2 233 913 euro. Buxheti i shpenzuar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është 2 203 052 euro, apo shprehur në përqindje është 99%.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë: për paga dhe mëditje 100%; mallra dhe shërbime 95%; shpenzime komunale 97%.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 8.6.2016 ka shqyrtuar raportin financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 dhe vlerëson se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Me kërkesën e komisionit Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar një raport të ri, ku janë bërë disa përmirësime teknike të të dhënave të prezantuara në formularët standardë, i cili është i bashkëngjitur edhe rekomandimit të komisionit. Prandaj, komisioni i rekomandon Kuvendit që të miratojë raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka analizuar raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që të miratohet ky raport vjetor.

Nga raporti vjetor i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm shohim se buxheti përfundimtar i kësaj zyre është 2 233 919 euro, që është shpenzuar diku 99%, kur kuptohet për mallra dhe shërbime, si çdo institucion i pavarur, shpenzohet 100% buxheti, për mallra e shërbime është shpenzuar 95%, kurse për investime kapitale 97%.

Nga raporti të cilin na e ka ofruar Zyra Kombëtare e Auditorit të Përgjithshëm vërejmë se ka tejkaluar shpenzimet për mëditje dhe akomodim zyrtar brenda vendit dhe shpenzimet e tjera të udhëtimeve zyrtare brenda vendit, që nuk janë shumë shpenzime të arsyeshme që të bëhen, kur është fjala për udhëtime brenda vendit.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka tejkaluar edhe shpenzimet për udhëtime dhe akomodime jashtë vendit. Tejkalim të shpenzimeve nga ajo që është planifikuar Zyra Kombëtare e Auditimit ka pasur edhe te shpenzimet e tjera kontraktuese, që nuk janë shumë të qartësuar, diku për 221%.

Ajo çfarë kam vërejtur nga ky raport i Zyrës Kombëtare të Auditimit është tejkalimi i numrit të të punësuarve. Me buxhet janë planifikuar që të punësohen 146 pozita, kurse janë punësuar 150, është rritur numri i pozitave në 150 të punësuar. Kjo është një lloj shkeljeje ligjore, sepse Ligji për buxhet që parasheh numrin e të punësuarve nuk mund të ndryshohet.

Ajo çfarë kam vërejtur dhe që ka shënuar Zyra e Auditorit këtu, e auditorit të përgjithshëm, është që është paguar pozita e drejtorit të përgjithshëm nga “mallra dhe shërbime”, që po ashtu është shkelje ligjore. Ky drejtor i përgjithshëm është paguar ende pa u miratuar Ligji për Zyrën Kombëtare të Auditimit, çka do të thotë se nuk ka pasur kurrfarë baze ligjore për të ekzistuar ky drejtor i përgjithshëm, pa u miratuar ligji dhe njëkohësisht nuk ka pasur të drejtë të paguhet nga “mallra dhe shërbime”. Është dashur, duke qenë se është një institucion shumë kredibil, i cili analizon çdo shkelje ligjore të institucioneve që shfrytëzojnë buxhetin e Republikës së Kosovës, Zyra e Auditimit të ketë kujdes që të mos bëjë shkelje ligjore vetë.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah këtë raport. Auditori po ashtu i ka paraqitur edhe donacionet që i ka marrë nga institucionet e tjera. Janë të gjitha të evidentuara në raport, prandaj ne do të votojmë për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Besoj se ka mbështetje ky raport. Votojmë! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është, deputeti Ali Sadriu e ka kërkuar fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Raporti është i prezantuar në mënyrën më të mirë dhe po t'i bëjmë një analizë të hollësishme, do të vërejmë shumëçka progres dhe u detyrova ta marr fjalën në vërejtjen e zonjës Hadërgjonaj, kur prezantoi rastin. Ashtu vërtet figuron në raport rreth pagës së drejtorit, por arsyet janë vonesat që kanë shkaktuar në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Zyrës së Auditorit. Dihet deri në këtë moment se Zyrën Kombëtare të Auditimit e ka udhëhequr një i huaj dhe është paguar nga subvencionet e huaja. Nuk ka qenë pjesë e planit financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Në momentin e emërimit, meqë nuk ka pasur formulim për mënyrën se si do të financohet, është paguar nga “mallra dhe shërbime”, sepse në “paga dhe mëditje” diçka e tillë nuk ka qenë e planifikuar. Kjo ka qenë rrjedhim i asaj se nuk është ditur deri në atë moment në do të vazhdojmë edhe më tutje me drejtorin e huaj, kur e kanë financuar të jashtmit dhe nuk ka pasur, po them, në planin financiar pagën në kategorinë për paga të këtij lloji, prandaj një diçka e tillë është paguar nga “mallra dhe shërbime”. Kjo është e tëra. Pra, është bërë një lëshim, por lëshim që rrethanat e kanë kushtëzuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, edhe kjo pikë e rendit të ditës, ose raporti votohet nesër në orën 10:00 bashkë me të tjerët. Kemi një shkelje, që duhet ta bëj unë, po meqenëse... nëse Grupi Parlamentar i LDK-së është kundër, unë... OK!

20. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Komisioni ad hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e dy anëtarëve me votim të fshehtë, nga katër kandidatët e propozuar si në vijim: Afërdita Maliqi; Naile Demiri; Ganimet Klaiqi dhe Hazbije Qeriqi.

Ftoj kryetarin e Komisionit ad hoc, zotin Morina, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit. Zoti Morina, e keni fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19.10.2016, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehtë. Për dy pozita për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar propozohen për votim 4 kandidatë, si në vijim:

1. Afërdita Maliqi,
2. Naile Demiri,
3. Ganimet Klaiqi dhe
4. Hazbije Çeriqi.

Kuvendi bën përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga 4 të propozuar. Anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës emërohen me mandat trevjeçar.

Sa për procedurë, nëse në rundin e parë kalon vetëm një kandidat, në rundin e dytë hyjnë në garë dy kandidatët të cilët kanë më shumë vota. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës...I kemi edhe tri pika, në qoftë se keni durim, po i kryejmë edhe nesër e bëjmë votimin. Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës është:

16. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015

Komisioni Funkcional ka shqyrtuar raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Në emër të Komisionit Funkcional qenka zoti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAIJ: Të nderuar deputetë,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë dhe ia ka përcjellë Kuvendit për miratim.

Raporti i vitit 2015, për dallim nga viti 2014, është një raport më i kompletuar, të cilin e ka përkrahur komisioni, sado që, në fakt, e ka paraqitur gjendjen gati reale, sepse gjendja e mjedisit në Kosovë është, siç dihet, mjaft e keqe.

Raporti përfshin ndotjen e mjedisit, duke përfshirë ajrin, ujin, mbeturinat, ujërat e zeza, automjetet, e tjera, pra, është një raport mjaft gjithëpërfshirës, që pasqyron gjendjen reale, e cila për fat të keq, është shumë e keqe, të mos them se ndoshta është më e keqja në gjithë Evropën.

Raporti është fokusuar kryesisht te gjendja e ajrit, pra ka stacione matëse nëpër pjesë të ndryshme të Kosovës, por që nuk janë të gjitha pajisje apo stacione matëse të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, por një pjesë e këtyre stacioneve janë nën menaxhim të vetë operatorëve që bëjnë ndotjen e ambientit në Kosovë.

Gjendja është shumë e keqe, veçanërisht në ndotjen e ajrit. Pra, unë do të përmend disa raste që janë më të theksuara në Kosovë. Në Obiliq ka tejkalim të normës së lejuar për 257%, në Prishtinë për 211%, në Prishtinë, përsëri, te Rilindja për 188%, në Drenas 174%, në Han të Elezit 128 %, ndërsa një gjendje, të themi, tepër alarmante është në Obiliq te Kosova-B, e cila e tejkalon normën e lejuar të ndotjes për 1857 %. Pra, është një gjendje tepër e keqe, tepër e rëndë dhe duhet të na alarmojë të gjithëve.

Ligji që e kemi aprovuar për mbrojtjen e zonës së rrezikuar të Obiliqit, në fakt, nuk e zgjidh këtë problem, për të cilin po flasim këtu, por merret vetëm me sanimin e pasojave që krijohen nga ndotja.

Në shumë pjesë të Kosovës nuk ka fare stacione matëse. Po e marr shembull regjionin e Ferizajt me Kaçanik, Shtërpçë e të tjera, nuk ka asnjë stacion për matjen e ndotjes. Pra, sado që s'kemi në atë pjesë ndotës të mëdhenj, por kemi ndotës të vegjël, të cilët bëjnë ndotje të mëdha për komunitete të vogla, kryesisht për fshatra. Pra, ka fabrika të cilat nuk i kontrollojnë askush dhe bëjnë ndotjen e ambientit aty përreth.

Kemi një rast të veçantë në një fshat, Dardani, të komunës së Ferizajt, ku një fabrikë që punon ilegalisht, pa asnjë lloj leje, ndot ambientin përreth dhe askush nuk merret me këtë çështje.

Duhet theksuar faktin se të gjithë lumenjtë e Kosovës janë të ndotur, pra pa asnjë përjashtim dhe janë të ndotur nga disa ndotës, përfshirë këtu ujërat e zeza, pastaj kimikalet dhe ujërat që rrjedhin nga fabrika të ndryshme e deri të mbeturinat, që hedhen pamëshirshëm nëpër lumenjtë tanë. Pra, nuk kemi në Kosovë asnjë lumë që nuk është i ndotur.

Po ashtu, problem serioz është mostrajtimi i ujërave të zeza. Pra, siç është e njohur, në Kosovë nuk trajtohen fare ujërat e zeza, me një përjashtim shumë të vogël, i cili nuk ia vlen as të

përmendet. Tash, janë disa projekte që do të financohen nga donatorë të ndryshëm, për që neve do të na duhet një periudhë e gjatë, një vëmendje nga institucionet nga institucionet tona për trajtimin e ujërave të zeza dhe të mbeturinave, në mënyrë që ta sigurojmë deri diku një ambient që mund të jetë i përshtatshëm dhe i pandotur në një masë kaq të madhe, siç është tash.

Një problem i veçantë është çështja e mbetjeve industriale. Ato janë shumë të koncentruara në Obiliq, në Mitrovicë dhe në Drenas dhe nuk kemi asnjë ligj që merret me këtë problematikë. Pra, në Kosovë nuk trajtohet me asnjë ligj çështja e mbetjeve industriale, kurse ato përbëjnë, në fakt, problemin kryesor të ndotjes së ambientit në Kosovë.

Duhet theksuar edhe faktin që ne nuk jemi marrë deri tash me problemin e ndotjes së ajrit nga automjetet, problem i cili është shumë aktual dhe pothuajse i patrajtuar. Automjetet në Kosovë ndotin ambientin, ndotin ajrin për rreth 30 deri 40%. Pra, gati gjysma e ndotjes së ajrit në Kosovë bëhet nga automjetet dhe, siç e dimë, nuk ekziston asnjë kontroll i ndotjes së ajrit nga automjetet.

Pra, ne kemi nevojë edhe ta përmirësojmë legjislacionin, por edhe kontrollin lidhur me këtë problem, i cili është mjaft i madh.

Unë deri tash fola në emër të komisionit. Komisioni i ka propozuar Kuvendit që të miratohet ky raport, por po ashtu është tepër e nevojshme që Qeveria me buxhetin e saj t'i kushtojë vëmendje shumë më të madhe çështjes së mbrojtjes së ambientit në Kosovë.

Po flas pak edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Pra, Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë raport dhe ka qëndrim që ta përkrahë për miratim këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Redžepi e ka kërkuar fjalën.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Zakon o zaštiti životne sredine 03-L/025 gde decidno stoji da je cilj ovog zakona promovisanje i stvaranje zdrave životne sredine za sve stanovnike Kosova, postepeno donoseći standard Evropske unije za zaštitu sredine, a odnosi se na što veće izbegavanje i smanjenje raznih otpadaka, sprečavanje negativnih uticaja štetnih otpadaka na sredinu i čovekovo zdravlje.

Glavni cilj ovog zakona je da osigura trajni razvoj iskorišćavanje vodenih resursa koji su prekopotrební za javno zdravlje, zaštitu životne sredine i društveno-ekonomski razvoj Republike Kosovo, gde bi se izvršilo inspekcijsko nadgledanje i nadzor oko zaštite i smanjenje mogućih opasnosti koji mogu uticati i prouzrokovati teške posledice na čovekovo zdravlje i celokupnu čovekovu okolinu.

Prema tome, zaštita životne sredine i stabilno iskorišćavanje prirodnih resursa, nastavlja da bude jedan od najvećih izazova našeg društva gde svi zajedno moramo učestvovati, kako institucije tako i obični građani, u cilju poboljšanja ekonomskog razvoja naše države, iskorišćavanje prirodnih resursa, razvoj poljoprivrede, investiranja u životnu sredinu, razvoj infrastrukture, ali pre svega paziti na čovekovo zdravlje i zaštitu životne sredine.

Izveštaj o stanju životne sredine opisuje trenutno stanje uslova života u životnoj sredini, uz sve nedostatke koji ima ovaj izveštaj poseduje ipak i nudi stabilnu osnovu za orijentaciju razvoja, planiranja i strateških investiranja u sektore koje imaju uticaje na životnu sredinu, kao što su industrija, energetika, transport i poljoprivreda.

Poslanici Parlamentarne grupe PDK-a su u potpunosti razmotrili izveštaj o aktuelnom stanju životne sredine, gde novi ministar Šalja sa svojim kabinetom dao jako veliki doprinos u čemu se ovaj izveštaj dosta razlikuje od prethodnih godina, transparentniji je i očitava realnu sliku naše sredine, tako da ćemo ga podržati i glasati za. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për fjalë. Vazhdojmë me pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

17. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017 dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa e ka fjalën zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Fondi ka planifikuar të fillojë vitin 2017 me 1.416.000.000 euro kontribute në menaxhim.

Kthimi i investimeve pritët të jetë 3% përgjatë vitit.

Kontributet e arkëtuara do të jenë 134,4 milionë euro.

Ndërkaq, tërheqjet e kursimeve parashihet të arrijnë në 21 600 000 euro, ndërsa gjatë vitit 2017 është planifikuar që Fondi mesatarisht të menaxhojë gjithsej 1 494 600 000 euro.

Në pajtim me Ligjin për Fondin Pensional të Kosovës, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës i ka propozuar Kuvendit miratimin e taksës operationale prej 0,082% dhe miratimin e taksës investive prej 0,393%.

Dhe, mbështetur në këto propozime buxheti i Fondit për vitin 2016 ishte miratuar në shumën prej 7 233 675 euro.

Për aktivitetet operacionale janë planifikuar 1 364 100 euro dhe për aktivitetet investive 5 869 575 euro.

Taksa investive e propozuar 0,393% është për 0,05% më e ulët se sa e vitit 2016.

Shpenzimet investive janë të lidhura me koston që ngarkojnë menaxhuesit e fondeve investive apo aset-menaxherët, përmes të cilit fondet investive i investojnë mjetet pensionale.

Fondi ka planifikuar që mjetet t'i investojnë aset-menaxherët në vende të ndryshme me qëllim të diversifikimit të riskut dhe mbrojtjes sa më të madhe të mjeteve në rast të rënies së tregjeve financiare, ndërkaq shpenzimet operacionale janë të lidhura me aktivitetet e brendshme operacionale që zhvillon Fondi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 26.10. 2016 e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës vjetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë kërkesën e Fondit për caktimin e taksës investive prej 0.393% dhe taksës operacionale prej 0,081% për vitin 2017 që është për 0,001% më e vogël se kërkesa fillestare e Fondit, si rezultat i ndryshimit të buxhetit për disa kategori të shpenzimeve operative, sipas rekomandimeve të Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e taksës vjetore për vitin 2017.

Sipas nenit 2.1 të Ligjit nr. 04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Kuvendi i Kosovës e cakton taksën investive dhe operacionale në bazë të kërkesës së Fondit për çdo vit kalendarik.

Kërkesa duhet të jetë e specifikuar me të gjitha shpenzimet e përlogaritura për periudhën për të cilën paraqitet kërkesa.

Fondi i Kursimeve Pensionale e ka paraqitur para Komisionit për Buxhet dhe Financa taksën vjetore operacionale dhe investive dhe i ka paraqitur të gjitha shpenzimet në mënyrë të detajuar se kah do t'i orientojë shpenzimet për vitin 2017.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar këtë taksë dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet për miratimin e kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operationale prej 0,081% të taksës investive prej 0,393% për vitin 2017.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për fjalë. Edhe pika 17 shkon në votim.

Sipas vendimit të mëhershëm, vazhdojmë me pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditë, që është:

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe kryesuesit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOST sh. a.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe kryesuesit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOST sha dhe Kuvendit i rekomandon për miratim Propozim-vendimin.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa fjalën e ka kryetari i komisionit, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Me miratimin e Ligjit 05/L-085 për energjinë elektrike për ndërmarrjet publike KOST-it i është ndryshuar pronësia nga Qeveria në Kuvend.

Po ashtu, në bazë të nenit 14, paragrafi 16 të këtij ligji është përcaktuar që pagat e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit dhe kryeshefit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOST përcaktohet nga Kuvendi deri në nxjerrjen e ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

Mbi këtë bazë, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën për përcaktimin e pagës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit të KOST-it dhe i ka propozuar Kuvendit që deri në miratimin e ligjit që rregullon pagat e funksionarëve publikë, të jetë si në vijim:

1. Kryesuesit të Bordit i caktohet paga prej 1 550 euro bruto në muaj;
2. Anëtarëve të Bordit u caktohen paga në shumën prej 1 350 euro bruto në muaj;

3. Kryesuesit të Komisionit të Auditimit i caktohet paga në shumën prej 120 euro bruto për pjesëmarrje në një mbledhje;
4. Anëtarëve të Komisionit të Auditimit u caktohet paga në shumën prej 100 euro bruto për pjesëmarrje në një mbledhje;
5. Pagat për kryesuesit dhe anëtarët e Komisionit të Auditimit sipas pikave 3 dhe 4 të këtij Propozim-vendimi paguhen më së shumti për pjesëmarrje në 6 mbledhje brenda 1 viti.
6. Niveli i pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit, sipas pikës 1 deri 5 të këtij Propozim-vendimi bëhet nga buxheti i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOST sha dhe zbatohet deri në miratimin e ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

Në pikën 6 kërkoj që të bëhet një ndryshim teknik. Pra, në vend të fjalës “bën” në vendim të shkruhet fjala “paguhen”.

Do të thotë, e kemi, sekretar, një përmirësim që propozojmë të bëhet, për të mos pasur më vonë moskuptime.

Përndryshe, komisioni kërkon nga deputetët që ky propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa të aprovohet sipas rekomandimit të bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar edhe këtë propozim-vendim dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, por ajo që unë dua të ngre si shqetësim këtu është mungesa e ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

I nderuar nënkryetar,

Unë disa herë e kam ngritur në këtë Parlament problemin që po na e shkakton mosmiratimi i këtij ligji.

Unë nuk e kuptoj për çfarë arsye Qeveria nuk e sjell ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

Dhe, meqenëse Qeveria nuk po e sjell këtu ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publikë, atëherë pse ne si Kuvend nuk po marrim iniciativën për hartimin e këtij ligji.

Ne, për çdo vit, përballemi me kërkesat e bordeve menaxhuese, të bordeve ekzekutive, të bordeve mbikëqyrëse për rritjen e pagave të tyre.

Sa herë që e miratojmë buxhetin për vitin vijues, ne përballemi me kërkesa nga më të llojllojshme nga këto borde për të bërë lëvizshmërinë e pagave të tyre. Kemi presion të madh që të bëhet harmonizim i pagave dhe çështjeve të tjera.

Disa prej këtyre bordeve i kanë pagat e njëjta që nga koha e UNMIK-ut. Atëherë janë caktuar pagat për këto borde dhe të njëjtën mënyrë vazhdojnë t'u paguhen.

Disa të tjerave, kemi marrë kësi vendimi, ua kemi miratuar në Kuvend, që është jo në rregull për të bërë një gjë të tillë.

Prandaj e kisha ngritur këtë çështje që sa më shpejt ose ne si Kuvend të marrim iniciativën e të hartojmë ligjin për pagat e funksionarëve të lartë publikë, ose të insistojmë që Qeveria sa më shpejt ta bjerë këtë ligj dhe të miratojmë, sepse nuk mund të vazhdojmë më tutje në këtë mënyrë që me propozim-vendime të tilla të detyrohemi të marrim ne vendim si deputetë në Kuvend. Të njëjtën gjë e kemi bërë edhe për Avokatin e Popullit dhe plotë institucione të tjera, që nuk është në rregull.

Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim-vendim të Komisionit për Buxhet dhe do të votojmë pro në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Vërtet është e patolerueshme dhe e pakuptueshme që Kuvendi i Kosovës të vazhdojë me këtë formë dhe në këtë mënyrë të caktimit të pagave të disa institucioneve. Kjo besoj, edhe herën e fundit kur është biseduar për caktimin e pagave në një institucion apo në një agjenci, është theksuar me zë të qartë nga Kuvendi i Kosovës që duhet të jetë ligj dhe kjo diskrepancë, ky mosharmonizim njëherë e përgjithmonë duhet të rregullohet.

Andaj unë shpresoj që bashkëngjitur me aprovimin që po theksohet këtu se duhet të merret miratimi nga ana e Kuvendit të Kosovës, të jetë edhe një rekomandim i qartë dhe, mbi të gjitha, ose i Kuvendit ose tash që brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore të vijë ligji për nivelimin e pagave.

Çdo ditë, apo të themi sa herë që bisedojmë për tema të tilla, asnjë parametër vlerësues, as matës, në mes të një institucioni apo institucioni tjetër nuk ekziston.

Edhe vetë puna që e ka bërë komisioni këtu, dhe nga raporti që u paraqit nga kolegët tanë, nuk theksohet edhe baza dhe në bazë të cilit kriter është caktuar kjo pagë e do të caktohet edhe për institucione të tjera.

Prandaj, besoj se Kuvendi nuk duhet të vazhdojë një tolerim të tillë dhe mbi të gjitha duke krijuar edhe moskënaqësi në mes të institucioneve të ndryshme, duke marrë parasysh edhe peshën që e kanë apo edhe impaktin në zhvillimin shoqëror të vendit në përgjithësi.

Ne pak më parë patëm edhe një problem tjetër, që po përcillet vazhdimisht, janë edhe objektet që janë me qira, sidomos ato institucionale. E miratua një normë për Trustin Pensional, ndërsa aty shihet se 50 mijë euro në vit paguajnë për një objekt me qira. Dhe kjo do të ishte mesazh i keq për vetë institucioneve tona, duke marrë parasysh sa e sa institucione çdo ditë lirohen, që kanë qenë të zëna dhe nuk risistemohen dhe se cilin funksion e kryen Ministria e Administratës Publike.

Unë besoj se këto dy shqetësime Kuvendi duhet t'i trajtojë në mënyrë serioze.

Ne edhe në pikën e ardhshme do të përballemi me një kërkesë të tillë, dhe nuk di se cili parametër matës është për caktimin e këtyre pagave dhe deri kur Kuvendi i Kosovës do të vazhdojë me këtë tolerim.

Personalisht nuk do ta jap votën për këtë vendim, duke marrë parasysh se edhe herën e fundit e kemi theksuar se duhet të vijë ligji për nivelimin e pagave sa më shpejt.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqi e ka kërkuar fjalën, le të përgatitet zoti Baftiu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk pata ndërmend të marr fjalën, por Armendi më provokoi. Po mendoj se mënyra si e ka caktuar komisioni pagën për anëtarë të Këshillit për Trashëgimi Kulturore është një mënyrë e mirë dhe do të thotë se është mënyrë që përafron...

(Ndërprerje - ndërhyrje)

Jo. Është një mënyrë, sepse s'ka pasur asnjë krahasim tjetër normal, kështu që kanë bërë krahasim me anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media...

(Ndërhyrje)

Kërkoj falje, mendova se është për pagat e zyrtarëve...

Atëherë unë po e jap mendimin, sepse, Armend, më ngatërrove. Faleminderit, kryesues, për mundësinë!

Pra, çështja e caktimit të pagave, u përmend edhe ligji për pagat e zyrtarëve të lartë, do të jap edhe një sqarim.

Në mandatin e kaluar, nëse s'keni harruar, anëtarët e Komisionit përkatës FunkSIONAL e kemi pasur ligjin, mirëpo e kemi kthyer si një ligj i cili nuk ka qenë i mirë nga ministria dhe ia kemi kthyer ministrisë, sepse kategorizimi s'ka qenë në nivel. Pra, ka qenë jo i mirë kategorizimi i zyrtarëve për pagat, të cilat janë caktuar me nivel të koeficientit jo të barabartë, duke filluar prej ministrave, zëvendësministrave e deri te kategoria 7 që kanë qenë deputetët.

E dyta, ligji ka shkuar edhe një herë në agjendë të Kuvendit, por për këtë vit nuk ka qenë e mundur të vijë dhe shpresoj se vitin tjetër, nëse jemi këtu ende si koalicion, do ta çojmë përpara.

Ndërsa, për çështjen e anëtarëve të trashëgimisë kulturore, mendoj se është nivel i mirë dhe mendoj që ajo pagë duhet t'u shkojë. Përndryshe, s'kemi arsyetim të kërkojmë punë kualitative prej tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Baftiu e ka fjalën.

NEHAT BAFTIU: Përshëndetje, deputetë të nderuar,

Unë s'pata ndërmend të marr fjalën, por vërtet kjo më provokoj. Komisionin për Buxhet dhe Financa, nuk mund ta kuptoj sinqerisht si është e mundur që bordet të kenë rrogë 1.555 euro deri në 4.800 Trusti, ndërsa kirurgu - anesteziologu atje të jetë me 600 euro.

Si është e mundshme që 120 euro t'i kenë për pjesëmarrje në mbledhje ata, ndërsa në operacione asnjë cent s'e fitojnë.

Këtë unë s'mund ta kuptoj. Kërkoj falje dhe faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur dhe vazhdojmë me pikën e nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës:

19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit për Trashëgimi Kulturore

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Fjalën e ka zoti Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9. 11. 2016 e ka shqyrtuar kërkesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore lidhur me pagat e anëtarëve të këtij këshilli dhe duke ditur rëndësinë e këtij institucioni dhe me qëllim të krahasimit me institucionet e tjera të pavarura në çështjen e kompensimeve deri në miratimin e ligjit që rregullon pagat dhe kompensimet e funksionarëve të lartë publikë, i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit për caktimin e kompensimeve si në vijim:

1. Kryetarit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore i caktohet kompensimi në shumën prej 800 euro bruto në muaj;
2. Nënkryetarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore u caktohen kompensimet në shumën prej 700 euro bruto në muaj;
3. Anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore u caktohen kompensimet në shumën prej 600 euro bruto në muaj.

Zoti nënkryetar, një sqarim. Deputetët kanë të drejtë kur e kërkojnë ligjin që i përcakton pagat jo vetëm të zyrtarëve të lartë publikë, por të gjithë atyre që marrin pagën prej buxhetit të Kosovës.

Në takimin e fundit që është bërë me kryeministrin dhe ministrin e Administratës Publike, që është përgjegjës ta procedojë ligjin, ne shpresojmë se ligji do të arrijë në Kuvend shumë shpejt, ndoshta brenda dy javëve, por derisa ligji nuk është në fuqi, Komisioni për Buxhet e Financa dhe deputetët e këtij Kuvendi kanë obligim ligjor ta përcaktojnë pagën e të gjitha institucioneve të pavarura.

Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk punon në mënyrën çfarë dëgjova këtu nga disa deputetë, për arsye se bën krahasimin që mund të vijë deri te një propozim para këtij institucioni, për KOST-in që financohet nga mjetet e veta, por jo nga buxheti i Kosovës, dhe kemi barazuar me pagën që e ka Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të Kosovës, për arsye se konsiderojmë

njera ka të bëjë me të njëjtën natyrë për energjetikë dhe tjetra ka të bëjë me operatorët e telekomunikacionit dhe mendojmë se është një krahasim i duhur.

Këtë që e tha deputetja Izmaqi, absolutisht ka të drejtë. Komisionin për Trashëgimi Kulturorë e kemi krahasuar me Komisionin për Media dhe kështu e kemi bërë këtë nivelim, por disa institucione të pavarura e kanë të precizuar me ligj çështjen e pagës.

Ne kur i kemi caktuar pagat e institucioneve të pavarura i kemi barazuar me pagën e deputetëve, prandaj deputetët nuk kanë të drejtë të thonë është e lartë a e ulët, sepse atë e marrin pagën vetë, ndërsa të mos bëhen këto krahasime me institucione të tjera, sepse në mjekësi asnjë mjek, asnjë kirurg nuk e ka pagën më pak se 1 000 euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Propozim-vendimin për caktimin e kompensimit për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë. Ne e përkrahim rekomandimin që e ka dhënë Komisioni për Buxhet e Financa dhe do të votojmë për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur dhe konsideroj se për sot e mbylлим mbledhjen dhe vazhdojmë nesër. Doni të diskutoni prapë? Në rregull, e ke fjalën!

NEHAT BAFITU: Kërkoj falje! Dua të replikoj me kryetarin e komisionit, sepse s'është e vërtetë që punëtorët shëndetësorë e kanë rrogën 1 000 euro, por e vërtetë është se në shërbimet primare rroga është 480 euro, ndërsa në shërbimet sekondare kirurgët dhe anesteziologët e kanë 609 euro rrogën, prandaj s'është e vërtetë ajo për 1 000 që e ka ndokush në shëndetësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Unë kisha lutur edhe për një precizim. Te pika 4, në vend të fjalës "pagë" të zëvendësohet me fjalën "kompensim". Edhe këtu është lëshuar i njëjti gabim, sikur edhe më herët që e përmenda. Pra, të bëhet ky përmirësim. Nuk është fjala për pagë, por është fjala për kompensim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nesër e vazhdojmë punën me votimet.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 30 nëntor 2016
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj,

Vazhdojmë me seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 30 nëntor 2016.

Diskutimet kanë përfunduar në seancën e djeshme, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, votimi është shtyrë për sot. Ju lutem që të deklaroheni në qoftë se dikush është pa kartelë në sallë.

Sipas numërimit të sekretarisë, në sallë janë 63 deputetë. Votojmë pikën e pestë të rendit të ditës, që është:

5. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

E përsëris votimin edhe një herë për pikën e pestë të rendit të ditës: Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale. Votojmë tani!

A ka dikush pa kartelë? A je për a kundër?

Atëherë kemi në sallë 67 deputetë. Sipas informimit që ma bën, në seancën e fundit është deklaruar kryetari, a Sabriu, që ata që nuk votojnë nuk marrin mëditje. Besoj që është e drejtë edhe një herë, 67 veta jemi.

Zonja Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Nënkyetar, ju kisha lutur, ne pasi i kemi diskutuar krejt pikat edhe ndodh që teknika s'po punon, ose ndodh që dikush nuk është kthjellur ende, kisha lutur që të shkojmë me dorë të votojmë secili, le ta shohë edhe opinionin se kush është e kush s'është, kush po voton, se s'kemi nevojë, tash i kemi diskutuar të gjitha pikat.

KRYESUESI: Ne po provojmë, pra, edhe një herë kështu me elektronikë, pastaj vërtet ta shohim.

Edhe një herë shkojmë në votim me elektronikë, pastaj në qoftë se jeni kthjellur, votojmë me dorë.

Atëherë edhe një herë, votojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit për Procedurë Penale. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Atëherë shkojmë me votim me dorë. Kush është për? Numëroni votat!
Për kanë votuar 52 vetë.

Kundër? Numërojini, ju lutem! Kundër janë 7 vota. Abstenim?
Atëherë, po e shtyjmë votimin për këtë pikë, konsultohuni edhe një herë se unë s'po e kuptoj Grupin Parlamentar të PDK-së.

Votojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të procedurës përmbartimore, që është pika e gjashtë e rendit të ditës.

6. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të procedurës përmbartimore

Votojmë tani! Me elektronikë. Faleminderit! 64 vota për, 1 abstenim. Miratohet.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

7. Votimi i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!
Faleminderit! Konstatohet që me 64 vota për, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

8. Votimi i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! 62 vota për. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.
Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e nëntë, ju i dini rregullat, pa qenë të komuniteteve 11 deputetë nuk e fusim në votim.

10. Votimi i Projektligjit për tregtinë dhe produktet e naftës dhe karburantet e ripërtërishme në Kosovë

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

63 deputetë kanë votuar. 53 vota janë për, 4 kundër, 6 abstenime.

Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për tregtinë dhe produktet e naftës dhe karburantet e ripërtërishme në Kosovë.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Balje, nuk qenka. A ka zëvendësues? Nuk ka, për ta paraqitur dhe për ta arsyetuar raportin me rekomandime.

Po i votojmë amendamentet, atëherë. Kemi 11 amendamente. Votojmë amendamentet veç e veç.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Atëherë, 62 deputetë kanë votuar. 62 vota janë për.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për performansën energjetike në ndërtesa.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditim

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Muhamet Mustafa, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Atëherë, zoti Blerim.

BLERIM GRAINCA: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të Rregullores së Kuvendit në disa mbledhje ka shqyrtuar Projektligjin për akreditim, propozuar nga Qeveria dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime.

Ky projektligj përcakton parimet e akreditimit dhe rregullat për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit dhe konfirmimit në Republikën e Kosovës. Me këtë projektligj bëhet një përputhje e plotë e legjislacionit të vendit tonë me legjislacionin e BE-së. Bëhet eliminimi i parregullsive dhe i mangësive që kanë qenë në ligjet ekzistuese dhe me këtë projektligj në kuadër të rregullimit të fushave të akreditimit futen edhe fusha të reja, bazuar në nevojat dhe përvojat që kanë edhe palët e interesit. Andaj, Komisioni për Zhvillim Ekonomik rekomandon që ta votojmë në parim këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani votojmë amendamentet veç e veç.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Atëherë, konstatoj që 64 deputetë kanë votuar dhe 64 vota janë për.
Kuvendi e miratoi Ligjin për akreditim.

14. Votimi i rekomandimeve të Komisionit FunkSIONAL lidhur me raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 65 deputetë. Për janë 64 deputetë, 1 ka abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015.

16. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 61 deputetë. 59 janë për, 2 kanë abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi miratoi raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

17. Votimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Kanë votuar 64 deputetë. 56 vota janë për, 3 vota kundër, 5 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksave operacionale prej 0,081% dhe taksës investive prej 0,393% për vitin 2017.

18. Votimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet e Financa për caktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarit të Bordit të drejtorëve dhe të kryesuesit të anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh. a.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, diskutimet janë shteruar. Votojmë tani!

Kanë votuar 64 deputetë. 46 vota janë për, 9 vota kundër dhe 9 vota kanë abstenuar.

Konstatoj se Kuvendi vendosi përcaktimin e pagës së kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të drejtorëve dhe të kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit të Operatorit të Sistemit, të Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh. a. sipas propozimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

19. Votimi i Propozim-vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit për Trashëgimi Kulturor

Diskutimet janë shteruar, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Kanë votuar 63 deputetë. 54 janë për, 2 kundër, 7 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi vendosi përcaktimin e kompensimeve për kryetarin, nënkryetarët dhe anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë, sipas propozimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Ka ngelur pa u votuar Projektligji për ndryshim-plotësimin e Kodit Penal. Unë nëse doni po e fus edhe një herë në votim, nëse jo...

Mirë, atëherë vendos Kryesia për këtë çështje.

Tani jemi te pika kryesore, që është e vërteta për sot:

4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Për ta votuar duhen 80 vota, ne në sallë akoma s'i kemi 80 vota. Po presim edhe Fikrim Damka më tha që janë duke ardhur. Po, zotit Beqiri fjalën, regjia.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë paraprakisht, meqenëse deputetët e Aleancës dhe të "Nismës" do të vijnë, unë do të doja ta them para opinionit që kjo pikë dhe kjo marrëveshje është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe dje kemi biseduar për këtë.

Unë po dua ta them në emër të grupit t'i falënderoj për zemërsisht që po vijnë në seancë, ndërkaq po dua ta përsëris ose ta them një gjë që deputetët të cilët sot s'janë në sallë e që janë deputetë të Lëvizjes "Vetëvendosje", le ta dinë qytetarët që, mes tjerash, në këtë pako të ndihmës që e marrim nga Bashkimi Evropian janë edhe 33 milionë euro për energji dhe prej tyre janë 21 milionë euro që kanë të bëjnë me "Termokosin", ose me ngrohjen në Prishtinë dhe në Gjakovë.

Dhe, kur flasim për Prishtinën le ta dinë qytetarët e Prishtinës që këta zotërinjtë që e udhëheqin Prishtinën më së pakti mendojnë për Prishtinën, sot ia humbin 21 milionë euro ose i rrezikojnë që t'i humbin. Prandaj, unë po e përmend me qëllim që niveli i përgjegjësisë së deputetëve, në këtë rast, e thashë të dy subjekteve opozitare për projekte të tilla tregon nivelin e përgjegjësisë institucionale. Ndërkaq, deputetët e Lëvizjes "Vetëvendosje" le të dalin dhe të sqarojnë pse ata

sot për motive thjesht politike, çdo gjë dëshirojnë ta politizojnë, dhe ia humbin ose e rrezikojnë t'ia humbin vendit, e në këtë rast Prishtinës, meqenëse thirren shumë për Prishtinën, ia humbin këta milionë euro.

Unë shpresoj që ky projektligj, gjegjësisht kjo marrëveshje sot të kalojë dhe të dëshmojmë nivelin e përgjegjësisë sonë institucionale karshi nevojave të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqenëse e more ti fjalën, tash e ka kërkuar edhe Pali dhe Dauti fjalën. E ka fjalën Pal Lekaj, të sqarojë diçka.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Si çdoherë që e kemi dëshmuar, atëherë kur është një e mirë për vendin, për zhvillimin e Kosovës ne do të jemi përkrahës i të gjitha proceseve. Këtë jo vetëm sot që po e bëjmë, por e kemi bërë edhe në të kaluarën. Ju e dini Ligjin për “Trepçën” e shumë gjëra të tjera që janë pozitive. Prandaj Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të jetë mbështetëse e fuqishme e të gjitha proceseve pozitive për qytetarët e vendit. Por, çdoherë do të kundërshtojmë të keqen e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Valdete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ashtu siç u potencua edhe nga kolegu Lekaj, edhe “Nisma” në këtë rast çdoherë ka qenë pjesë e vendimmarrjes dhe çdoherë i ka përkrahur të gjitha projektet dhe rrugën drejt BE-së, të cilën po synojmë.

Mirëpo, duhet ta ketë parasysh edhe pozita në këtë rast që jo çdoherë kryejnë punë numrat e tyre, prandaj ne jemi për këtë marrëveshje dhe do të jemi çdoherë për marrëveshje, të cilat janë në të mirën e qytetarëve dhe në të mirën e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli e ka kërkuar fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk e di pse duhet të shihen gjërat krejt kështu, pushteti dhe opozita kanë obligime për qytetarët e Kosovës. Pse duhet të duartrokitet dhe pse duhet të falënderohet opozita pse po bën një veprim për qytetarët e Kosovës, sinjerisht këto janë sjellje shumë joserioze të pozitës, sjellje shumë joserioze.

Ju lutem, bëhuni një grimë seriozë dhe një grimë përgjegjësi! Faleminderit!

KRYESUESI: Janë paraqitur edhe Daut Haradinaj, edhe Teuta Haxhiu. Regjia, zotit Haradinaj fjalën.

DAUT HARADINAJ: Kryesues, për besë tash po i bie kjo që ne nuk e pranojmë falënderimin e Ismetit se s'po dimë çka të themi, s'ke nevojë të na falënderosh, Ismet, hiq, se e kemi për obligim, duhet ta dëgjosh kolegen.

Sido që të jetë, shpresoj që pushteti do të ketë konsiderata dhe në seanca të tjera, jo vetëm kur i konvenon. Ne jemi këtu për një arsye shumë të thjeshtë, se është shumë e vërtetë që ne edhe si deputetë e kemi për obligim ta japim votën "për" kur ka interesa të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Megjithatë, kryesues, më shumë e kërkova fjalën për të kritikuar ty, por meqenëse prapë e kalove, atëherë s'po të kritikoj. Jepi vetit kritikë, por sidoqoftë ti je deputet si unë, bile edhe me vota jam më i madh se ti.

KRYESUESI: Veç e kam kryesuar seancën, dallon pak. Zonja Haxhiu, e dëshironi edhe ju fjalën?

TEUTA HAXHIU: Pasi që pak më parë e theksuat që nuk ju kam vërejtur dje që kemi qenë në seancë, atëherë herën tjetër shiko mirë, nënkryetar i Kuvendit, se edhe ne jemi prezentë, dhe mbi të gjitha kisha dashur që dje në kohën e pyetjeve parlamentare minutazhi kur ju e keni marrë, na e keni marrë të drejtën për të folur dhe për të ngritur shqetësimet tona, të cilat ka 2-3 javë që kemi bërë pyetje parlamentare për ministrat, të cilët nuk po gjejnë kohë të vijnë, siç është rasti i rrugës prej Smolicës deri në Nivokaz. Ka qenë shqetësim i të gjithë banorëve dhe unë e kam pasur përgjegjësinë ta ngre atë pyetje, por gjithashtu edhe për marrëveshjen që është mes Ministrisë së Infrastrukturës, Transportit dhe Komunës së Gjakovës për rrugën në Has, pra e cila i ka lënë ata qytetarë në baltë dhe nxënësit e katër shkollave fillore atje, sot pra u është keqësuar edhe më shumë gjendja se para se të fillonte ajo rrugë.

Prandaj, duhet të jeni përgjegjës në momentin kur jeni ulur në atë ulësë.

KRYESUESI: S'po flas hiq, unë jam kryesues i seancës, unë i interpretoj qysh vendos, jo ti. Kështu që në rregull jemi. Nuk kam dashur t'ia marr fjalën kurrkujt, por vërtet është keqpërdorur pika e rendit të ditës në vazhdimësi dhe ne nuk e lejuam ose nuk u votua ideja e debatit. U vazhdua me të njëjtin avaz si të ishte debat, erdhi një moment që u desh të ndërpritet. Bile edhe Arsimi, ministri, ka pritur këtu, më kishte shkruar sms që t'ia jap fjalën, po unë s'e kam parë.

Po Dautin e juve ju kam parë, por këtu që jeni në listë, nuk ju kam parë. Po s'ka lidhje, edhe po t'u kisha parë e të mos u kisha lënë të diskutoni s'u bë kiameti, shpresoj që herën tjetër s'e përsëris.

Atëherë, ju lutem, thirrni deputetët, sepse mendoj që kemi kuorumin e duhur për të votuar.

Atëherë, të nderuar deputetë, zonja Shinik, uluni, ju lutem, sepse kemi votim. Ju lus që të uleni, kemi votimin!

Në sallë kemi 81 deputetë, para se të hyj në votim, ju kisha lutur që të deklarohet ndonjëri në qoftë se dikush ka kundër, më mirë se të votojmë e të mos na dalin numrat.

A ka dikush që nuk do të votojë ose është kundër kësaj çështjeje? Nuk është! Po konsideroj që të gjithë e mbështesin, atëherë në sallë janë të pranishëm 81 deputetë që është numër i mjaftueshëm për procedim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Atëherë, kemi 78 vota me kartelë. 4 vota pa kartelë. S'ka nevojë, këta po deklarohen, nëse doni, unë i përmend me emra që kemi mundësi verifikimi, janë një nga "Nisma" dhe tre nga PDK-ja.

Konstatoj që me 81 vota për Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Më falni, prej AAK-së ka qenë Timja pa kartelë.

Atëherë kalojmë në pikën e 20-të:

20. Zgjedhja e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Të nderuar deputetë,

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehur kërkohet krijimi i një komisioni votues në përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar në mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar të komisionit votues.

Atëherë nga PDK-ja, meqenëse tri grupe parlamentare mungojnë në sallë, mendoj që duhet të propozohen nga të pavarurit në komision me qëllim që të numërohet, të konsiderohet votimi i ligjshëm. Meqenëse Rregullorja thotë që duhet të jenë nga një anëtar i grupeve parlamentare, s'e ka paraparë këtë çështje Rregullorja. Shpresoj që e miratojmë ligjin ndonjëherë dhe me ligj rregullohet kjo punë.

Nga PDK-ja?

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!
Zonja Xhevahire Izmaku.

KRYESUESI: Zonja Izmaku nga PDK-ja. LDK-ja?

ISMET BEQIRI: Zoti Salih Morina.

KRYESUESI: Zoti Morina. “Vetëvendosje” nuk është. AAK nuk është. “6+”?
DUDA BALJE: Mi predlažimo gospodina Ćerim Bajrami.

KRYESUESI: Qerim Bajrami nga “6+”. Nga të pavarurit, Margarita, dhe kush tjetër?

Unë ju ftoj që t’i zini vendet si komision, me qëllim që të votojmë.

A jemi gati si komision? Atëherë, fillojmë me votimin:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Qaushi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Fadil Beka, Nehat Baftiu, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kimete Bytyqi, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmmolli, Mexhide Topalli-Mjaku, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emmini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Fatmir Shurdhaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Srgjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Të nderuar deputetë,

Kemi një lapsus, një gabim teknik a çka është ai, nuk e di. Komisioni ka konstatuar që duhet të përsëritet votimi, kryetarja e Komisionit e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Veç është një mospajtueshmëri në mes të anëtarëve, të cilët Komisioni i ka propozuar, dhe letrës që janë propozuar, pra është një emër gabim këtu, deri sa të përmirësohet teknikisht, ju lutem pritni dhe fillojmë prapë votimin, kaq. Prej fillimit.

KRYESUESI: Atëherë po fillojmë për të dytën herë votimin. Lus komisionin që ta zërë vendin. Ftoj deputetët që të votojnë:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Qausi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Fadil Beka, Nehat Baftiu, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kimete Bytyqi, Kujtim Paçaku, Labintë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmeti, Mexhide Mjaku, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emiri, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Fatmir Shurdhaj, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simiq, Slobodan Petroviq, Srgjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

A ka mbetur dikush pa votuar, nëse ka mbetur e s'e ka dëgjuar emrin, le të dalë të votojë.

Pas votimit

KRYESUESI: Regjia, fjalën kryetares së komisionit për numërim të votave.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Fillojmë me numërimin e votimit.

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Ganimet Klajiqi,

Hazbije Qeriqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri,

Naile Demiri

Ganimet Klaiqi,

Afërdita Maliqi,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri

Afërdita Maliqi,

E pavlefshme,

Afërdita Maliqi,

Naile Demiri

E pavlefshme,

Afërdita Maliqi,

Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Naile Demiri,
Ganimet Klaiqi,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri,
Afërdita Maliqi dhe
Afërdita Maliqi,
Naile Demiri.

Pas pak do të dalim me rezultate. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetarja e komisionit, regjia.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, në seancën plenare të mbajtur më 1 dhjetor 2016:

K o n s t a t o n

Në votim kanë marrë pjesë 62 deputetë, të pavlefshme janë 4 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

Afërdita Maliqi i ka fituar 50 vota,
Naile Demiri i ka fituar 44 vota,
Ganimet Klaiqi i ka fituar 4 vota dhe
Hazbije Qeriqi i ka fituar 3 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet si në vijim:

Afërdita Maliqi dhe Naile Demiri janë zgjedhur anëtare të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar me mandat trevjeçar. Urime, punë të mbarë. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit! Me kaq i mbyll punimet e seancës, seancën e ardhshme Kryesia e thërret prapë në përputhje me Rregulloren, edhe për disa çështje që kanë mbetur akoma pezull.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*